

Maj 2018
Numri: 122
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro

NJË JETË në besim



revistaetika



progresibotime

*Shtëpia botuese Progresi
vjen me 6 libra të rinj, të cilët
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë
individuale dhe shoqërore.*

TË
RINJ

Një këshillë
1001 mësimë
350 Lekë
3 Euro



Si edukonte
Ai (s.a.v.s.)
150 Lekë
1 Euro



101 Parime
në shërbim
200 Lekë
1.5 Euro



Shoqetësimi
për brezat
200 Lekë
1.5 Euro



Udhëtimi
drejt Zotit
200 Lekë
1.5 Euro



Shërbimi
200 Lekë
1.5 Euro

Maj 2018

VITI: XII

NUMRI: 122

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7042 8245

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VIJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Po, Allahu na krijoj dhe ne tani ekzistojmë. Ne nuk mund të zgjidhnim dot mosekzistencën. Nuk do të mundemi të mos shkojmë, kur Ai të na ftojë "Ejani!"... Atëherë, do të thotë se gjithmonë duhet t'i mbajmë sytë nga Ai. Por si specie njerëzore, mund edhe të mos shohim... syri dhe fytyra jonë ndonjëherë kthehet në drejtime të tjera. Kibla jonë mund të çorientohet!..

Për këtë arsye, me qëllim që kibla e tij të jetë gjithmonë në rregull dhe të mos devijojë nga devotshmëria, Krijuesi Dhulxhelal e ka futur njeriun në një shkollë devotshmërie të atillë, e cila përfshin pothuajse të gjitha kohërat.


Nëse njeriu, pikësëpari e kupton se ka ardhur prej Tij dhe do të kthehet përsëri tek Ai, -gjë që është elementi i domosdoshëm i të qenit njeri -, menjëherë pas kësaj, duhet të pyes: "Çfarë kërkon Krijuesi prej meje?". Pastaj, do të shohë mesazhet e Tij dhe do t'i vërë veshin thirrjes së prijësit që Ai ka dërguar për njerëzimin!..

Nëse Allahu kërkon "devotshmëri" prej nesh, ne duhet të mësojmë se çfarë është devotshmëria dhe se si duhet të zbatohet ajo në fusha të ndryshme të jetës. Namazi, agjërimi, haxhi, zekati...

Këto janë shembujt e devotshmërisë me kohë të caktuara. Shembuj devotshmërie të cilat do të pranohen dhe do të barten në jetë pa pyetur se për çfarë janë kërkuar dhe pse në atë formë. Në sajë të këtyre adhurimeve, Krijuesi Dhulxhelal na mëson ta jetojmë jetën tonë me qendër në devotshmëri. Kur e falim namazin me identitetin e tij të vërtetë, nuk do të kemi mundësi të jetojmë duke harruar Allahun.

Kjo do të thotë se ekziston një Fuqi para të Cilit do të qëndrosh me intervale kohore që prej orëve të para të ditës, e deri në fund të saj dhe i Cili të ka dhuruar mirësinë për ta jetuar atë ditë dhe, që po të mos e dhuronte atë, nuk do të merrje dot as frymë. Do të qëndrosh para Tij dhe do të thuash: "Ti je më i Madhi, Ti je Zoti im, vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë. Ti je sunduesi i jetës së përjetshme dhe Ti je Ai që do të më gjykosësh në botën tjetër. Qëndrimi im para Teje, përkulja dhe sexhdja ime janë shenjë e besnikërisë sime ndaj Teje. Unë pranoj që je Zoti im dhe unë jam robi yt!.."

Kur agjërimitin e mbajmë me cilësinë e tij të vërtetë, pra, kur heqim dorë nga nevojat më të natyrshme njerëzore vetëm sepse këtë e kërkon Allahu... Kur zekatin e japim duke perceptuar kuptimin e tij të vërtetë... Pra, kur mendojmë se pronari i vërtetë i mallit dhe pasurisë, në të cilën përqendrohen pasionet tona njerëzore, që e dëshirojmë dhe që na bën të lumtur kur e kujtojmë, është Allahu dhe se unë jam një qenie që e përdor atë pasuri në rrugën që Ai ka caktuar!.. Kur edhe në haxh, edhe në Arafat ta shohim gjendjen tonë sikur jemi në Mahsher përpara Krijuesit, gati për të dhënë llogari duke thënë "Lebejke", me kokë të rruar, këmbë zbathur dhe të huaj, larg prej të gjitha krijesave dhe çdo statusi të kësaj bote... Pra, kur t'i përjetojmë me të vërtetë këto, deri në cepin më të thellë të zemrës sonë, a do të jetë e mundur të dalim nga namazi, e të humbasim kibllën... apo të përplasemi në kibla të tjera... të agjerojmë ditën e të përlyhemi me gjynahe natën... të japim zekatin dhe ta përziejmë pasurinë tonë me haram... të përjetojmë arafatin dhe t'i ndotim zemrat në kthim?..



Islami është një maratonë, jo një sprint

Merve Abdalla

21

Përmbajtja




Mirësi në Dynja
Mirësi në Ahiret
Doç. dr. Durak Pasmaz

10



Një Ramazan sa për të gjithë jetën
Osman Nuri Topbash

34



27



Fleta letrare e revistës
"Kultura Islame"
Gëzim Puka

14

- 5 I gjallë në çdo çast
Ahmet Tashgetiren
- 8 Zakon apo adhurim?
Prof. dr. Sulejman Derin
- 12 Rrëshqitja nga përparësitë
e adhurimit
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan
- 18 Të shesësh Ahiretin për këtë botë
Ali Riza Temel
- 24 Gedik Ahmet Pasha
Dr. Ardian Muhaj
- 26 Përfundimi i atyre
që nuk japin zekatin
M. Sami Ramazanollu
- 27 Sinqeriteti dhe qëllimi i mirë
Sadik Dana
- 28 Duhet menduar thellë
Idris Arpat



56

- Në një vend ku nuk ju sheh dot askush 29
Urtësi
- Kun: Fati, kultura, trashëgimia 30
Xhihan Tashtan
- "Vëllal" i madh i tokës, Jupiteri 31
Muaz Erdem
- Një Ajet-Një Hadith 32
- Allahu Alim 40
Ilir Hoxha
- Refleksione -3 42
Nuredin Nazarko
- Abdullah ibn Xhubejr 46
Mustafa Erish
- Zhvillimi i aftësisë së perceptimit
të rrezikut tek fëmijët 52
As. doç. dr. Engin Eker
- A duhet të punojë gruaja? 54
Fatma Nur Xhihan



44

Mbi mendimin filozofik
të Rene Guenon
Murat M. Aliu



Ndërgjegjia dhe besimi
Ferit Piku

48



I gjalbë në çelo çast

— Ahmet Tashgetiren —

A do të jetë e mundur të dalim nga namazi, e të humbasim kiblën... apo të përplasemi në kibla të tjera... të agjërojmë ditën e të përlyhemi me gjynahe natën... të japim zekatin dhe ta përziejmë pasurinë tonë me haram... të përjetojmë arafatin dhe t'i ndotim zemrat në kthim?..

Vetëdija e devotshmërisë në çdo fushë të jetës...

Në çdo fushë të jetës... Domethënë, në të gjitha fushat që mund të cilësohen “jetë”...

Me devotshmëri kuptojmë cilësinë e marrëdhënies sonë me Allahun e Madhëruar...

Vetëdija është gjendja e perceptimit të thellë. Domethënë, të mos jesh në gaflet/indiferencë, të mos harrosh, të jesh i vetëdijshëm...

Vetëdija është një gjendje e thellësisë mendore që fitohet. Devotshmëria fitohet gjithashtu duke u përpjekur.

Devotshmëria nuk ka një fushë të kufizuar, një gjendje apo një kohë të përcaktuar, si për shembull një ambient namazi, një gjendje lutjeje, një rast ndalese... Ajo shpreh një gjendje të thellësisë mendore, që kërkon një përpjekje shumë më tepër serioze për të mos e humbur lidhjen me Krijuesin Dhulxhelal në të gjitha fushat e jetës, që prej frymëmarrjes, marrëdhënieve familjare dhe ato ndërnjerëzore, në të gjitha baticat dhe zbaticat e jetës, përfshi edhe kohët e traumave kur ndjenjat turbullohen.


Domethënë, në të gjitha fushat e jetës... Domethënë, në çdo kohë që marrim dhe japim frymë... Por, kjo vetëdije nuk është e lehtë

Vetëdija e devotshmërisë në çdo fushë të jetës...

Në çdo fushë të jetës... Domethënë, në të gjitha fushat që mund të cilësohen "jetë"...

Devotshmeri, pra, cilësia e marrëdhënies sonë me Allahun e Madhëruar...

Vetëdije, pra, gjendja e perceptimit të thellë. Domethënë, të mos jesh në gaflet/indiferencë, të mos harrosh, të jesh i vetë-dijshëm...



as të formohet dhe as të vazhdohet. Kjo, sepse njeriu harron dhe humbet vetëdijen.

Njeriu është krijuar i dobët!..

Për këtë arsye vazhdimisht kanë ardhur mesazhe prej Krijuesit, gjithashtu kanë ardhur e do të vijjnë prijës që do ta brumosin përsëri njerëzimin në kuadrin e "vetëdijes së devotshmërisë".

Të gjitha adhurimet, si namazi, agjërimi, haxhi, zekati, duatë, përgjërimet, etj., janë bërë obligim për njeriun nga Vetë Krijuesi Dhulxhelal, për edukimin e devotshmërisë. Gjithmonë themi se, "Allahu nuk ka nevojë për namazin, për agjërimin, për haxhin apo për zekatin tonë!" Po, me të vërtetë ashtu është! E përse të ketë? Cilësia e Tij "Samed", që tregon se Ai është larg prej çdolloj nevoje, është domosdoshmëri e të qenit Zot.

Mirëpo, me qëllim që "botëkuptimin tonë të devotshmërisë" ta bartim në të gjitha fushat e

jetës sonë, është e nevojshme që ne të kalojmë nga një edukim intensiv.

Allahu i Madhëruar urdhëron: *"Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë Mua!"* (Dharijat, 56)

Po, Ai na krijoi dhe ne tani ekzistojmë. Ne nuk mund të zgjidhnim dot mosekzistencën. Nuk do të mundemi të mos shkojmë, kur Ai të na ftojë "Ejani!"... Atëherë, do të thotë se gjithmonë duhet t'i mbajmë sytë nga Ai. Por si specie njerëzore, mund edhe të mos shohim... syri dhe fytyra jonë ndonjëherë kthehet në drejtime të tjera. Kibla jonë mund të çorientohet!..

Për këtë arsye, me qëllim që kibla e tij të jetë gjithmonë në rregull dhe të mos devijojë nga devotshmëria, Krijuesi Dhulxhelal e ka futur njeriun në një shkollë devotshmërie të atillë, e cila përfshin pothuajse të gjitha kohërat.

Nëse njeriu, pikësëpari e kupton se ka ardhur prej Tij dhe do të kthehet përsëri tek Ai, -gjë që është elementi i domosdoshëm i të qenit njeri -, menjëherë pas kësaj, duhet të pyes: "Çfarë kërkon Krijuesi prej meje?". Pastaj, do të shohë mesazhet e Tij dhe do t'i vërë veshin thirrjes së prijësit që Ai ka dërguar për njerëzimin!..

Nëse Allahu kërkon "devotshmeri" prej nesh, ne duhet të mësojmë se çfarë është devotshmëria dhe se si duhet të zbatohet ajo në fusha të ndryshme të jetës. Namazi, agjërimi, haxhi, zekati...

Këto janë shembujt e devotshmërisë me kohë të caktuara. Shembuj devotshmërie të cilat do të pranohen dhe do të barten në jetë pa pyetur se për çfarë janë kërkuar dhe pse në atë formë. Në sajë të këtyre adhurimeve, Krijuesi Dhulxhelal na mëson ta jetojmë jetën tonë me qendër në devotshmeri. Kur e falim namazin me identitetin e tij të vërtetë, nuk do të kemi mundësi të jetojmë duke harruar Allahun.

Kjo do të thotë se ekziston një Fuqi para të Cilit do të qëndrosh me intervale kohore që prej orëve të para të ditës, e deri në fund të saj dhe i Cili të ka dhuruar mirësinë për ta jetuar atë ditë dhe, që po të mos e dhuronte atë, nuk do të merrje dot as frymë. Do të qëndrosh para Tij dhe do të thuash: "Ti je më i Madhi, Ti je Zoti im, vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë. Ti je sunduesi i jetës së përjetshme dhe Ti je Ai që do të më gjykosësh në botën tjetër. Qëndrimi im para Teje, përkulja dhe sexhdja ime janë shenjë e

besnikërisë sime ndaj Teje. Unë pranoj që je Zoti im dhe unë jam robi yt!..”

Kur agjërimin e mbajmë me cilësinë e tij të vërtetë, pra, kur heqim dorë nga nevojat më të natyrshme njerëzore vetëm sepse këtë e kërkon Allahu... Kur zekatin e japim duke perceptuar kuptimin e tij të vërtetë... Pra, kur mendojmë se pronari i vërtetë i mallit dhe pasurisë, në të cilën përqendrohen pasionet tona njerëzore, që e dëshirojmë dhe që na bën të lumtur kur e kujtojmë, është Allahu dhe se unë jam një qenie që e përdor atë pasuri në rrugën që Ai ka caktuar!.. Kur edhe në haxh, edhe në Arafat ta shohim gjendjen tonë sikur jemi në Mahsher përpara Krijuesit, gati për të dhënë llogari duke thënë “Lebejke”, me kokë të rruar, këmbë zbatthur dhe të huaj, larg prej të gjitha krijesave dhe çdo statusi të kësaj bote... Pra, kur t’i përjetojmë me të vërtetë këto, deri në cepin më të thellë të zemrës sonë, a do të jetë e mundur të dalim nga namazi, e të humbasim kiblën... apo të përplasemi në kibla të tjera... të agjërojmë ditën e të përlyhemi me gjynahe natën... të japim zekatin dhe ta përziejmë pasurinë tonë me haram... të përjetojmë arafatin dhe t’i ndotim zemrat në kthim?..

Nëse ndodh kështu, atëherë është për shkak se ne nuk i kryejmë gjithë ato adhurime me tërë trupin dhe shpirtin/zemrën tonë. Për rrjedhojë, edhe brendësia e atyre adhurimeve është e zbrazët. Kjo ndodh për shkak se e kemi ndarë nga njëra-tjetra adhurimin dhe jetën. Ndodh për shkak se jemi shkëputur nga vetëdija se jemi përpara Krijuesit të Madhëruar dhe, në të njëjtën kohë, se Ai është Fuqia që ka dërguar Islamin, i cili është feja që ka përcaktuar rregullat e jetës sonë.

Vetëdija e devotshmërisë në çdo çast të jetës.

“Edhe jeta, edhe vdekja jonë janë për Atë!”
(shih. En’am, 162.)

“Ne jemi të Atij dhe tek Ai do të kthehemi!”
(shih. Bekare, 156.)

Për këtë arsye, Zoti ynë i Madhëruar na fton kështu:

“O besimtarë! Binduni Allahut dhe të Dërguarit kur ju thërret drejt asaj që ju jep jetë! Dhe ta dini se Allahu ndërhyt midis njeriut dhe zemrës së tij dhe se tek Ai do të mblidheni të gjithë!” (Enfal, 24)

Ato për ku na ftojnë Allahu dhe i Dërguari i Tij (a.s.), na japin jetë. Pra, janë gjëra që e bëjnë

jetën jetë dhe për rrjedhojë, kur shkëputesh prej tyre, jeta e humbet kuptimin e saj si e tillë.

Që jeta të marrë kuptimin e saj të vërtetë, ajo duhet të bëhet një me kriteret e Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Dhe kjo, është e mundur në sajë të përjetimit të gjallë të devotshmërisë në çdo fushë të jetës si një udhëzues, një ndjeshmëri kibleje dhe sexhdeje. Për këtë arsye, në botën e vetëdijes sonë duhet të realizohen dy gradë të larta:

Një: Vetëdija e të qenit me Allahun.

Dy: Vetëdija e mirësisë.

Vetëdija e parë, është grada e vetëdijes së përcaktuar në ajetin: **“..Ue hue meakum ejne ma kuntum / Ai është me ju kudo që të gjendeni!..”** (Hadid, 4) Pra, duhet të ndiejmë në çdo frymëmarrje dhe në çdo hap që hedhim se Zoti ynë ndodhet gjithmonë pranë nesh. Duhet të ndiejmë se në çdo punë që bëjmë, kemi pranë edhe një “vëzhgues të gatshëm”. Kjo është vetëdija se Allahu shikon dhe dëgjon.

Vetëdija e dytë, është ajo për të cilën Profeti ynë (a.s.), është shprehur: **“Të adhurosh Allahun dhe të jetosh sikur je duke e parë Atë. Edhe pse ne nuk e shohim, Ai na sheh ne!..”**

Arritja e këtyre dy gradëve të vetëdijes, e bën të domosdoshëm edukimin serioz të personalitetit. Pra, e kemi fjalën për një edukim të tillë nga ku duhet të kalojnë “zemrat” tona, që pranohen si qendra e personalitetit të njeriut. E kemi fjalën për “zemrën” e cila mund të rrotullohet e të kthehet siç e shpreh edhe i Dërguari i Allahut në lutjen e vet: **“Ja mukabbilel kulub thebbit kalbi ala dinike Islam / O Ti (Zoti im) që i rrotullon dhe i kthen zemrat! Bëje zemrën time të qëndrueshme në fenë Tënde, Islamin!..”** Me këtë dua, i Dërguari i Allahut (a.s.), na ka bërë të ditur se, me qëllim që zemra të mbetet e qëndrueshme në një vend, është e domosdoshme ndihma e Allahut të Madhëruar. Dhe, për të formuar në zemër botë-kuptimin e të qenit bashkë me Allahun, duhet t’i lutemi dhe t’i përgjërohemi po Atij...

Kjo është detyra jonë!

Lutja jonë e fundit le të jetë:

“O Zoti ynë! Mos i lejo zemrat tona të rrëshqasin pasi na ke udhëzuar njëherë!”

Amin!

Zakon apo adhurim?

— Prof. dr. Sulejman Derin —



Fjala arabe “shuur”, do të thotë, të ndjesh, të jesh i vetëdijshëm për veten dhe gjërat që të rrethojnë, të arrish t’i vëzhgosh lëvizjet e tua në mënyrë objektive dhe të zotërosh vullnet. Ndër krijesat e Allahut të Madhëruar, bashkë me njerëzit, edhe melekët, edhe xhinët zotërojnë cilësinë e të qenit të vetëdijshëm. Ndërsa vetëdija e gjallesave jashtë këtyre që përmendëm, është e kufizuar vetëm me nevojat e vazhdimësisë së species, ushqyerjes dhe mbrojtjes. Por kjo, më tepër se vetëdije, mund të quhet instinkt.

Instinktet e gjallesave janë dhunti prej Allahut, nuk janë të fituara me përpjekje. Ndërsa forca e vetëdijes njerëzore, ka nevojë për përpjekje që të zhvillohet. E thënë ndryshe, vetëdija është si një muskul shpirtëror, i cili mund të zhvillohet vetëm nëse përdoret. Njerëzit që nuk e përdorin vetëdijen e tyre në mënyrë të kontrolluar, e humbasin lehtë kontrollin mbi veten. Pra, ata nuk përipiqen të analizojnë ngjarjet, e harrojnë synimin e ardhjes në këtë botë dhe i reduktojnë qëllimet e tyre vetëm në aktivitetet e ngrënies, pirjes dhe argëtimit. Për një njeri që bie në këtë dërxhe, morali i lartë, feja, namusi dhe të tjera koncepte si këto, nuk kanë ndonjë kuptim kushedi se çfarë. Mirëpo, një nivel të tillë vetëdijeje, Allahu nuk e ka parashikuar për njerëzit, por për gjallesat e tjera. Për rrjedhojë, ata që nuk i përdorin aftësitë që u ka dhënë Allahu, pra ata që e lënë mënjane mendjen dhe vetëdijen, siç shprehet edhe Kurani, janë në një nivel edhe më të ulët se kafshët.

Kjo do të thotë se niveli i parë i vetëdijes, është që njeriu të kuptojë se është një krijesë ndryshe nga të tjerat në këtë botë, të besojë Zotin e tij që e Krijoi dhe ta organizojë jetën e vet në bazë të urdhrave hyjnorë. Një besimtar i tillë, në kohët e namazeve, në xhami dhe në muajin e Ramazanit do të jetë bashkë me Zotin e vet. Ndërsa në kohët e tjera, me shumë mundësi do të rendë në labirintet e ngatërruara të botës së tij të brendshme. Sipas sufive/mistikëve, ky nivel vetëdijeje, nuk është i mjaftueshëm. Kjo, sepse Profeti ynë (a.s.), në hadithin e “ihsanit”, është shprehur se “ihsani” është niveli më i lartë i fesë, gjë e cila në fakt është çështje vetëdijeje. Në dukje, namazi, agjërimi, haxhi dhe bamirësia që arrin gradën e “ihsanit”, nuk ndryshon shumë nga ato të myslimanëve të tjerë. Dallimi i vetëm prej atyre, është se ky njeri i bën veprat e tij në një dimension të veçantë vetëdijeje dhe e adhuron Allahun sikur është duke e shikuar. Një njeri që zotëron këtë vetëdije, e di shumë mirë se, edhe nëse ne nuk e shohim Zotin tonë, ne shihemi vazhdimisht prej Tij. Besimtarit që është në gradën e ihsanit, çdo gjë që sheh dhe çdo zë që dëgjon, i kujton Allahun.

Ndërsa gafletit/indiferenca, pra humbja e ndjenjave të vetëdijes nga njeriu, do të thotë të humbasësh perceptimin dhe të veprosh në mënyrë automatike. Sipas të urtëve, nëse njeriu e harron Zotin e tij duke u marrë me këtë botë, kjo është treguese e gafletit dhe pavetëdijes së tij. Po ashtu, sipas tyre, “në çdo frymëmarrje të krijesave ka një rrugë që të çon drejt Zotit”. Për këtë arsye, çdo frymëmarrje në të cilën nuk ka përmendje të Allahut, mendim dhe meditim, është një kohë e çuar dëm.

Mirë, po ku mbështeten rrënjët e gafletit dhe të kundërtës së saj, vetëdijes? Përgjigjet më të bukura në këtë çështje i kanë dhënë mistikët. Për shembull, sipas Imam Rabbanit, ai që e nxjerr në pah vetëdijen e njeriut, është shpirti. Nëse njeriu e nënshtron egon e vet dhe zhvillon botën e tij shpirtërore, ai bëhet edhe më i vetëdijshëm. Por për fat të keq, kjo nuk është edhe aq e lehtë, sepse me qëllim që shpirti në fillim të mësohet me trupin, Allahu i Madhëruar i ka dhënë shpirtit potencialin për të dashuruar me pa kufi. Për këtë arsye, shpirti është dashuruar me trupin/egon dhe duke harruar burimin e tij hyjnor, ka hyrë në robërinë e egos. Imam Rabbani, këtë çështje e shpjegon në këtë mënyrë:

“Ja shpirti, i cili për shkak të kësaj dashurie për egon/nefsin, e hodhi veten në botën e egos dhe shkoi gjurmëve të saj. Madje, ai e harroi veten dhe mori emrin “nefs-i emmare”¹. Për shkak se shpirti ka përbërje transparente, me çfarëdo gjëje që ai të bashkohet, merr gjendjen/formën e saj. Ja pra, për shkak se shpirti e harroi vetveten, ai e ka harruar edhe gjendjen e tij të mëparshme të vetëdijes dhe njohjes së Allahut, duke e zhytur veten plotësisht në indiferencë/gaflet dhe në errësirë... Nga ato që u thanë më lart, kuptohet se shpirti është bashkuar me egon. Madje, ai është shkrirë dhe është bërë një me egon, duke kërkuar përjetësinë me të. Për sa kohë të vazhdojë kjo shoqëri, indiferenca/gafleti i trupit, në të njëjtën kohë do të jetë edhe indiferenca e shpirtit.” (Letrat, V. I, 99.)

Në këtë rast, sipas Imamit, hapi i parë i kapërcimit të indiferencës, është të dimë se qenia jonë është e përbërë prej dy poleve të kundërta, egoja dhe shpirti. Kjo është edhe urtësia e shprehjes së famshme mistike, *“Kush njeh veten, njeh Zotin e tij!”*.

Zemra e besimtarit, i cili e zhvillon shpirtin e tij me përmendjen e Allahut, me mendim dhe meditim, lidhet vetëm pas Allahut. Siç shprehet edhe Imam Rabbani, ashtu si njerëzit e thjeshtë që e sforcjnë veten për të hyrë në botën shpirtërore dhe pas një kohe të shkurtër bien prapë në gaflet/indiferencë, në të njëjtën mënyrë edhe sufiu që e përfundon udhëtimin e tij shpirtëror, nuk mund të hyjë në ndikimin e kësaj bote, edhe nëse ai e sforcon veten e tij, sepse ai nuk mund ta harrojë Zotin e tij qoftë edhe një çast. Ashtu si njerëzit indiferentë që mendojnë vetëm për këtë botë, qoftë edhe kur janë në namaz, ashtu edhe robërit e devotshëm e mendojnë Allahun edhe nëse janë duke u marrë me punët e kësaj bote. Për mendimin tim, thënia që e përmbledh më së miri këtë gjendje vetëdijese, është ajo e Gazaliut: *“Ndërkohë që myslimani i shkujdesur i kthen në zakon edhe adhurimet, njeriu i vetëdijshëm i kthen në adhurim edhe punët që të gjithë i bëjnë në mënyrë të zakonshme.”*

Kur njeriu i vetëdijshëm pi një gotë ujë, ose ha një kafshatë bukë, ai i bën këto në emër të shpirtit, duke fituar shpërblim prej Zotit. Njeriu i vetëdijshëm, edhe punët më të thjeshta të kësaj bote i bën

1. Egoja që urdhëron gjithmonë për punë të këqija.

në mënyrën më të mirë, me ndjenjën se ndodhet vazhdimisht nën vëzhgimin e Allahut. Përkundër kësaj, një mysliman i pavetëdijshëm, nuk ka dobi as nga namazi që fal, e as nga agjërimi që mban. Ai e harron Allahun edhe kur është në namaz, duke hyrë në kategorinë e atyre të cilët janë paralajmëruar nga Allahut me fjalët: *“Mjerë për ata që falin namaz!”*. Nëse njeriu e bën për Allahun çdo punën, edhe veprimi i tij më i thjeshtë kthehet në adhurim. Por nëse përpigjet për egon dhe dëshirat e saj, edhe adhurimi i tij kthehet në syfaqësi dhe imitim të verbër. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *“Qëllimi i besimtarit, është më i dobishëm se puna e tij.”*² Kjo, sepse kur një njeri bën diçka, mund të harrojë se përse dhe për kë e bën atë, duke vepruar thjesht në bazë të imimitit të të tjerëve. I nderuari Mevlana, bërjen e një veprë në mënyrë të vetëdijshme apo të pavetëdijshme, e përngjan me qeshjen dy herë të një shurdhi kur kupton diçka komike. E qeshura e parë e shurdhit, është për shkak se sheh të tjerët duke qeshur, ndërsa e qeshura e dytë është pasi ai e mëson ndodhinë duke pyetur dikë tjetër.

Siç e ka shpjeguar edhe në temën e “teubes”, Imam Gazaliu mendon se, besimi dhe puna e bazuar në pavetëdijen dhe imitim të thatë, nuk do t'i bëjë dobi njeriut në botën tjetër. Madje, sipas Gazaliut, ata që i kthehen më me vështirësi Allahut me teube, janë ata që kanë lindur nga prindër myslimanë dhe e kanë jetuar Islamin me imitim. Kjo, sepse sjelljet e tyre kanë qenë thjesht të bazuara në imitim të verbër, gjendje për të cilën ata nuk janë aspak të vetëdijshëm. Këto fjalë të Imam Rabbanit në lidhje me veprat që shumica prej nesh i pandeh jash-të fesë, janë shumë kuptimplote dhe e mbështetin mendimin e Imam Gazaliut:

“O biri im! Kohën duhet ta kalojmë me dhikër ndaj Zotit tonë. Çdo gjë që bëhet në përputhje me ligjin e Allahut, pranohet si dhikër, edhe nëse ajo është thjeshtë një shitblerje. Çdo punë duhet ta bëjmë në përputhje me ligjin e Allahut, që të gjitha ato të konsiderohen dhikër, sepse dhikri e eliminon indiferencën/gafletin... Çdo gjë që bëhet për të zbatuar urdhrat e Allahut të Madhëruar dhe për t'u larguar prej ndalesave të Tij, përfshihet në dhikër. Edhe shitblerja që përputhet me parimet (Islame), është dhikër... Mirëpo, dhikri që bëhet drejtpërsëdrejti me emrin e Allahut të Madhëruar, ka efekt më të shpejtë dhe bëhet shkak i dashurisë së Tij.”

Sekreti për të shpëtuar prej indiferencës/gafletit dhe për t'u përshtatur sa më lehtë me ligjin e Allahut në çdo punë, është dhikri i Allahut. Sipas Imam Rabbanit, dhikri që bëhet me emrat e Allahut, ngjall tek njeriu një dashuri ndaj Zotit dhe kjo dashuri, e përshpejton vetëdijesimin e njeriut.

I lutemi Allahut të Madhëruar, të na shpëtojë prej gafletit, të na bëjë të vetëdijshëm në çdo fushë të jetës, që prej tregtisë, punës dhe adhurimeve dhe të na ruajë prej imimitit të verbër. Amin!..

2. Bejhaki, Shuabu'l-Iman

Mirësi në Dynja Mirësi në Ahiret

Doç. dr. Durak Puzmaz

Një prej sahabëve të Profetit (a.s.), ishte sëmure dhe ashtu siç e do zakoni, Profeti (a.s.), i vajti për vizitë. Sahabiu ishte dobësuar dhe këputur fare. Madje, siç shprehet edhe Enesi (r.a.), i cili e transmeton këtë ndodhi, *“ai ishte zvogëluar, e ishte bërë sa një zog”*.

I Dërguari i Allahut (a.s.), u çudit me gjendjen e të sëmurit dhe e pyeti, se si i lutej Allahut dhe çfarë kërkonte prej Tij. I sëmuri tha se i lutej me këto fjalë:

“O Allah! Ma jep menjëherë në këtë botë atë dënim me të cilin do të më dënosh në botën tjetër!” Pas këtyre fjalëve, Profeti (a.s.), tha:

“Subhanallah! Ti nuk ke fuqi për këtë. Më mirë të ishe lutur duke thënë: «O Allah! Na jep mirësi në këtë botë dhe në botën tjetër dhe na ruaj prej zjarrit të Xhehenemit!»”

Në vazhdim të tregimit, Enesi (r.a.), shton: *“Më pas i Dërguari i Allahut (a.s.), u lut për atë sahab dhe Allahu i dha shërim”* (Muslim, Dhikr, 23.)

Kjo lutje që i Dërguari i Allahut (a.s.), e këshilloi të sëmurin ta bënte, është një pjesë e ajetit 201 të sures Bekare. Nëse e analizojmë këtë hadith

fisnik së bashku me ajetet 200-201 të sures Bekare, lutjet dhe kërkesat e robërve ndaj Allahut, mund t'i ndajmë në tri pjesë:

1. Disa njerëz dëshirojnë që dënimin e gjynaheve dhe fajeve që kanë bërë t'i vuajnë në këtë botë, duke dëshiruar të jenë të lumtur në botën tjetër. Prandaj i luten Allahut në atë mënyrë. Siç kuptohet edhe nga hadithi i mësipërm, i Dërguari i Allahut (a.s.), nuk e ka aprovuar këtë mënyrë lutjeje dhe ka këshilluar që prej Allahut të kërkohej mirësi edhe për këtë botë, edhe për botën tjetër.

2. Ka edhe njerëz të tillë që, prej Allahut kërkojnë vetëm mirësitë e kësaj bote, duke thënë: *“O Zot na e jep në këtë botë atë që ke për të na dhënë!”* Ata nuk mendojnë për botën tjetër, sepse nuk besojnë në të dhe sepse puna dhe përpjekjet e tyre janë vetëm për këtë botë. Mirëpo, Allahu i Madhëruar, ka thënë se për ata që luten në këtë mënyrë, në botën tjetër nuk ka asnjë mirësi. Kjo çështje, është theksuar kështu në ajetin 200 të sures Bekare: *“...Disa njerëz thonë: “Zoti ynë, jepna të mira në këtë botë!” Por, për këta, s'ka asnjë të mirë në botën tjetër!”*

3. Por, ka edhe të atillë që në lutjet e tyre kërkojnë prej Allahut mirësi edhe për këtë botë, edhe për botën tjetër: *“Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë, na jep të mira në botën tjetër dhe na ruaj nga*

dënimi i Zjarrit (të Xhehenemit)” (Bekare, 201)

Allahu i Madhëruar e ka pëlqyer këtë mënyrë lutjeje dhe na e ka ofruar këtë si shembull në Kuran. Për rrjedhojë, në vazhdim Allahu urdhëron:

“Këtyre do t'u jepet shpërblim për atë që kanë bërë. Allahu është i shpejtë në llogari!” (Bekare, 202)

Siç e thekson edhe Enes b. Maliku (r.a.), i cili ka pasur nderin t'i shërbejë të Dërguarit të Allahut (a.s.), gjatë gjithë jetës së tij në Medinë, lutja që përmendet në ajetin fisnik, është një nga lutjet që Profeti (a.s.), e ka dashur dhe e ka bërë më shpesh:

“I Dërguari i Allahut (a.s.), shpesh

herë lutej në këtë mënyrë: «O Allah! Na jep të mira në këtë botë dhe në botën tjetër dhe na ruaj nga zjarri i Xhehenemit!» (Buhari, Deauat, 55; Muslim, Dhikr, 27.)

Pak fjalë, por me kuptim të madh!..

Ky ajet në formë lutje, të cilin i Dërguari i Allahut e ka kënduar shpesh dhe ia ka këshilluar edhe të gjithë umetit të tij, është i shkurtër, me pak fjalë, por kuptimi që përmban ai është shumë i gjerë. Kjo lutje përbëhet prej tre fjalish të shkurtra:

1- O Allah! Na jep të mira në këtë botë!..

2- Na jep të mira në botën tjetër!..

3- Dhe na ruaj nga zjarri i Xhehenemit!..

Siç tregon edhe nëna jonë Aishe (r.anha), i Dërguari i Allahut (a.s.), i kishte shumë përzemër këto lloj lutjesh me pak fjalë dhe kuptim të gjerë. (Ebu Daud, Salat 358, 1482.)

Kuptimi i fjalës “hasene/mirësi”.

Fjala “hasene/mirësi”, e cila përdoret në ajet dhe të cilën Profeti ynë (a.s.), e ka përmendur shpesh në lutjet e tij, është në gjininë femërore dhe ka kuptimet si, e bukur, mirësi, gjendje e mirë, vepër e mirë, punë e mirë, etj.

E kundërta e fjalës “hasene”, është “sejje”, që do të thotë, “e keqe, gjynah”, etj. Në Kuranin Fisnik, urdhërohet: **“Inne’l-hasenati judhhibne’s-sejjat / ...veprat e mira i shlyejnë veprat e këqija!”** (Hud, 114)

Për sa i përket çështjes se çfarë kërkohet të thuhet me fjalën “hasene” në ajetin e temës sonë, komentuesit e Kuranit kanë shprehur disa mendime të ndryshme. Siç shprehet rahmetliu Omer Nasuhi Bilmen, “*çdo mirësi në trupin, veten dhe pasurinë e njeriut që fitohet/arrihet dhe është e ligshme, konsiderohet hasene. Edhe adhurimi dhe bindja ndaj Allahut janë hasene.*” (Ömer Nasuhi Bilmen, Tefsir, I, 203.)

Hasan el-Basri (v. 110/728.), i cili është prej të mëdhenjve të tabiinëve, është shprehur se “hasene” në këtë botë, janë dija dhe adhurimi, ndërsa në botën tjetër, është Xheneti. (Shirbinî, es-Siraxhu’l-munir, I, 153.)

Po ashtu, Suddi (v. 127/745.), që ishte prej muftisive të parë të tabiinëve, është shprehur se, “hasene” në këtë botë është furnizimi/rrizku ha-

llall, ndërsa “hasene” në botën tjetër, është falja e gjynaheve dhe shpërblimi nga Allahu. (Shirbinî, es-Siraxhu’l-munir, I, 153.)

Ka prej atyre që mendojnë se në këtë botë, “hasene” është besimi, vepra e sinqertë, morali i bukur, dija e dobishme, fitimi hallall, gruaja e mirë dhe femija i mbarë etj. Ndërsa në botën tjetër, “hasene” është shpëtimi, Xheneti dhe mirësitë e tij. (shih.)

Sipas një transmetimi që vjen prej Aliut (r.a.), thuhet se “hasene” në këtë botë është gruaja e mirë, ndërsa në botën tjetër, është Xheneti. (Shirbinî, es-Siraxhu’l-munir, I, 153.)

Ndërsa Kasim Ibn Abdurrahmani e ka përkufizuar kështu “hasene”-n: “*Kujt i është dhënë një zemër që falënderon, një gjuhë që bën dhikër dhe një trup që duron, atij i është dhënë hasene/mirësi edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër dhe është ruajtur prej dënimit të Xhehenemit.*” (Tefsiru Ibn Ebi Hatim, II, 359.)

Siç thotë edhe Ibn Kethiri, në fakt, “hasene” e kësaj bote që përdoret në ajet, përfshin të gjitha bukuritë dhe mirësitë, duke i refuzuar dhe duke i lënë jashtë të gjitha të këqijat. Kjo, sepse bukuria dhe mirësia në këtë botë, përfshijnë të gjitha të mirat si shëndeti, rehatia, shtëpia e gjerë, bashkëshorti/ ja e mirë, furnizimi i bollshëm, dija e dobishme, vepra e mirë, një mjet i mirë udhëtimi, përmendja në mënyrë pozitive ndër njerëz, etj. E shprehur ndryshe, një njeri që lutet duke thënë: “*O Zot! Më jep të mira në këtë botë!*”, ka kërkuar prej Allahut të gjitha këto të mira.

Ndërmjet të gjitha mendimeve që komentuesit e Kuranit kanë dhënë në lidhje me kuptimin e fjalës “hasene”, nuk ka asnjë mospërputhje, sepse të gjitha këto që janë përmendur, janë prej mirësive të kësaj bote. Për sa i përket “hasene”-s në botën tjetër, grada më e lartë e kësaj, është hyrja në Xhenet. Bashkë me këtë, mund të përmenden edhe të qenit i sigurt prej tmerrit në Ditën e Gjykimit, llogaridhënia e lehtë dhe mirësi të tjera të ngjashme.

Ndërsa “ruajtja prej zjarrit të Xhehenemit”, që përmendet në fund të ajetit, arrihet duke kryer me përpikëri detyrimet/farzet në këtë botë, duke u larguar prej gjynaheve dhe duke zbatuar Sunetin e të Dërguarit të Allahut (a.s.). (Ibn Kethir, Tefsir, I, 243-244; Ibn Haxher, Fethu’l-Bari, XI; 192.)



Rrëshqitja nga përparësitë e adhurimit

— Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan —

Një jetë fetare cilësore dhe e vetëdijshme është e mundur duke jetuar sipas përparësive të përcaktuara nga parimet fetare, sipas kriterëve të cilësisë dhe brenda kuadrit të tyre. Për rrjedhojë, uniteti, gjallëria dhe rregulli në jetën e umetit varet nga përqindja e zbatimit të këtyre kriterëve. Kjo, sepse feja kërkon disiplinë dhe seriozitet. Në këtë mënyrë, edhe umeti arrin të ruajë ekzistencën dhe ndikimin e vet për aq sa arrin ta zbatojë këtë disiplinë.

Umeti me interesa dhe marrëdhënie të ngatërruara apo të përziera, nuk është asgjë tjetër përveçse një strukturë që ka humbur harmoninë e jetës. Për këtë arsye, vetëdija e përjetësimit të vendimeve në urdhrat dhe ndalesat fetare, në mënyrë cilësore dhe gjithëpërfshirëse sipas radhës së rëndësisë apo përparësisë që kanë, është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe përbën parimin e shëndetit dhe cilësisë në devotshmëri dhe në jetën e umetit.

Për fat të keq, ky parim për të cilin po flasim, anashkalohet -në nivele të ndryshme- pothuajse nga çdo individ dhe çdo pjesë e shoqërisë dhe, për këtë arsye, në devotshmëri, në shërbim dhe në veprimtari kulturore po vihet re një rrëshqitje prej përparësive dhe një humbje e cilësisë dhe përfshirjes.

Gjendja e hidhur dhe shokuese lidhur me këtë çështje, është analizuar në mënyrë të veçantë në veprat me titull “perceptimi i përparësive” (Fikhu’l-Euleuijjat).¹ Shembujt që janë dhënë në këto vepra, shfaqin para nesh “rrëmujën e përparësive” që po përjetohet edhe në aspektin parimor, por edhe në atë praktik. Nga këto shembuj, kuptohet shumë qartë

se në çfarë masë serioze të aspektit të mendimit dhe veprimit ka marrë plagë bashkimi dhe uniteti që duhet të kishte jeta e umetit Islam. Për shembull, Jusuf Kardaui, shkaqet e problemeve në të cilat ka rënë umeti, rrëmujën e përparësive në çdo fushë të jetës së myslimanëve, përfshi edhe devotshmërinë dhe shërbimet në davet, problemet e përfshirjes dhe mungesës së cilësisë, i ka trajtuar në këtë mënyrë:

1- Myslimanët i neglizhojnë në një masë të madhe çështjet që kanë të bëjnë me të gjithë umetin dhe që janë farz kifaje. Për shembull, fushat e dijes, luftës dhe industrisë.

2- Ka prej atyre që kanë neglizhuar farzin ajn, ose nuk kanë treguar kujdesin e duhur. Shembull i kësaj, është parimi “el-Emru bi’l-ma’ruf ue’n-nehju ani’l-munker / urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja”.

3- Disa prej farzeve dhe pikave të rëndësishme të fesë, u janë dhënë më tepër rëndësi se disa të tjerave. Për shembull, agjërimit i jepet rëndësi më tepër se namazit. Po ashtu, edhe namazit i jepet rëndësi më tepër se zekatit. Mirëpo, në Kuranin Fisnik, namazi dhe zekati janë përmendur së bashku njëzetetë herë. Po ashtu, edhe halifi i parë Ebu Bekri (r.a.), ka luftuar me ata që falnin namazin, por nuk donin të jepnin zekatin. Madje, ai ka deklaruar se këto të dyja nuk mund të ndahen. Në këtë mënyrë, halifati/shteti Islam, ka qenë i pari që ka luftuar për të drejtën e të varfërve.

4- Disa të tjerë i dhanë rëndësi nafileve më tepër se farzeve dhe vaxhibëve. Për shembull, ndërkohë që dhikrin, tespihet dhe evradet i bëjnë me shumicë, farzet në lidhje me fushat shoqërore, si për shembull, dalja kundër fenomeneve të këqija dhe të shëmtuara, padrejtësive sociale etj., nuk i jepet rëndësia që duhet.

5- Adhurimeve individuale, si namazit dhe dhikrit, i kanë dhënë më shumë rëndësi se sa adhurimeve

1. shih. Jusuf Karadaui, Fi fikhi’l-euleuijjât, Doha, 1994 dhe Fikhu’l-euleuijjât dirase fi’l-dauâbit.

që kanë dobi të përgjithshme shoqërore. Për shebull, ata nuk u japin të njëjtën rëndësi çështjeve si xhihadi, pajtimi i njerëzve, ndihmesa në mirësi dhe devotshmëri, këshillimi i durimit dhe mëshirës, respektimi i të drejtave të të dobëtëve dhe mbrojtja e tyre, etj.

6- Shumë persona i neglizhojnë çështjet në lidhje me parimet. Përkundër kësaj, ata i japin shumë rëndësi detajeve të punëve dhe çështjeve. Mirëpo, siç janë shprehur të hershmit, *“ai që nuk respekton parimin, nuk arrin synimin!”* Ata kanë rënë në gaflet/indiferencë për sa i përket parimeve të ndërtesës së fesë, siç janë Akidja, besimi, teuhidi dhe ihlasi/sinqueriteti.

7- Shumë të tjerë, në vend që të luftojnë kundër haramëve që janë përhapur, ose të ripërtërijnë farzet e humbura, preferojnë më mirë të merren me mekruhet apo gjërat e dyshimta. Për shebull, shumë prej tyre merren me tema, hallalli dhe harami i të cilave është i diskutueshëm, si fotografia, kënga, etj. Ndërkohë që tregohen të pavëmendshëm ndaj gjynaheve shkatërruese, ata kundërshtojnë me forcë gjynahet e vogla.

Për rezultat, umeti ka filluar të zvogëlojë të mëdhatë, të zmadhojë të voglat, t'i japë rëndësi të parëndësishmes, të thjeshtësojë të rëndësishmen, të bëjë në fund atë që duhet bërë në fillim, të bëjë në fillim atë që duhet bërë në fund, të neglizhojë farzet e të jepet fort pas nafileve dhe të grindet për çështje të diskutueshme!”

Padyshim se, të gjitha këto shembuj që i kemi dhënë të përmbledhura prej Kardaut dhe parregullsitë e tjera që mund t'i shtohen këtyre, tregojnë se umeti ka nevojë për një vetëdije ndaj përparësisë, cilësisë dhe përfshirjes së thellë në jetën e tij fetare.

E vërteta historike, që i Dërguari i Allahut (a.s.), nuk e lejoi shkrimin e thënieve të tij, haditheve, derisa koncepti i “ajetit”, zuri vend në zemrat e sahabëve, është një fakt i cili duhet të përmendet si shebull për vetëdijen e përparësisë. Një zbatim të tillë, i cili mund të konsiderohet si vazhdimi i këtij suneti, e shohim në këmbënguljen e Imam Buharihut në kujdesin që ai ka treguar në vendosjen e titujve të temave në veprën e tij “Sahih”. Në këtë mënyrë, Buhariu, titujt e temave i ka rregulluar me këmbëngulje duke vendosur në fillim, ajetet, pastaj hadithet merfu, pastaj hadithet meukuf (fjalët e sahabëve), pastaj fetuatë e tabiinëve dhe etbau'tabiiinëve, e në fund mendimet e dijetarëve. Kështu që, edhe mendja e myslimanëve në ditët tona, duhet t'i ketë parasysh të njëjtat metoda dhe përparësi kur bën vlerësimin ose prezanton çështje të ndryshme. Kështu është e drejtë të veprohet!

Një korigjim i Profetit (a.s.)

Kjo ndodhi interesante, e cila tregon se i Dërguari i Allahut (a.s.), nuk e ka lejuar rrëshqitjen prej përparësive jo vetëm në çështjet e fesë, por edhe në marrëdhëniet njerëzore, është shumë mësimdhënëse:

Aidh ibn Amr (r.a.), i cili ishte një mysliman që kishte marrë pjesë në Besatimin e Ridvanit, që u zhvillua në vitin e gjashtë të hixhretit, tregon një ndodhi që i ka ndodhur atij:

Një natë para çlirimit të Mekës, shkuam te Profeti (a.s.), së bashku me Ebu Sufjanin. Disa sahabë na prezantuan tek Profeti (a.s.), duke thënë:

- Këta janë, Ebu Sufjani dhe Aidh ibn Amr. Mirëpo, Profeti (a.s.), tha:

“Këta janë, Aidh ibn Amr dhe Ebu Sufjani. Islami (myslimani), është më i nderuar. Islami është i lartë dhe asgjë nuk vihet para tij!” (shih. Ibn Haxher, Fet'hu'l-bari, III, 261.)

Në kohën kur ndodhi kjo, Aidhi ishte mysliman, ndërsa Ebu Sufjani nuk e kishte pranuar ende Islamin. Mirëpo, sahabët që i panë të dy bashkë, duke marrë parasysh pozitën shoqërore që kishin, emrin e Ebu Sufjanit e përmendën të parin, edhe pse ai ishte ende një idhujtar. Kjo, e shtyu të Dërguarin e Allahut (a.s.), t'i përsëriste fjalët e prezantimit duke e vënë përpara emrin e Aidhit dhe, menjëherë pas kësaj, theksoi se cilësia e të qenit mysliman, ka më përparësi se sa pozita dhe rëndësia shoqërore e Ebu Sufjanit. Pra, duke theksuar se Islami dhe myslimani janë para gjithçkaje dhe kanë një pozitë të lartë dhe se kjo cilësi e Aidhit (r.a.), duhej marrë parasysh, Profeti (a.s.), tha: *“el-Islamu ja'lu u la ju'la / Islami është i lartë dhe asgjë nuk vihet para tij”*.

Në këtë hadith fisnik, tregohet qartë se, qoftë në prezantim, qoftë në preferencë, qoftë në protokoll, e në hierarki, Islami dhe myslimanët duhen mbajtur gjithmonë në plan të parë dhe se nuk duhet të bëhet gabimi i përmendjes së jomyslimanëve para myslimanëve.

Gjithashtu, edhe në veprimtaritë kulturore, Kuranit Fisnik dhe Sunetit të Profetit (a.s.), i duhet dhënë përparësi ndaj çdo gjëje tjetër. Përndryshe, për shkak të mos zbatimit të parimeve, munda i dhënë, shpenzimet e bëra dhe përpjekjet e treguara, do të mbeten pa rezultat, ose do të lindin përfundime të hidhura që siç shprehet populli, *“në vend të vëmë vetullat, do të nxjerrim sytë”*.

Padyshim se, mangësitë në cilësi dhe përfshirje në jetën fetare të umetit dhe shkarja prej përparësive, nuk është e kufizuar me kaq. Ne dëshiroam të tërheqim vëmendjen në mënyrë të përgjithshme rreth kësaj çështjeje.



Fleta letrare e revistës “KULTURA ISLAME”

— Gëzim Puka —

Revista “Kultura Islame” besojmë se ngjall kureshtje, por edhe kënaqësi për të gjithë ata që vështrojnë me interes zhvillimet e publicistikës shqiptare. Dihet botërisht së shtypi është i lidhur pazgjidhshmërisht me kulturën e një kombi. Kultura si sinonim i memories shqiptare duhet të na nxisë të kujtojmë hera-herës atë çka bënë paraardhësit tanë në dobi të përparimit. Besojmë se shtypi islam u përfaqësua denjësisht me revistat: “Zani i Naltë”, “Kultura

Islame” dhe “Njeriu”. Ky shtyp i ka kushtuar shumë hapësirë shkrimeve ku vlerësohen elementet e shtetit dhe kombit. Revista “Kultura Islame”, ishte një ndihmesë e shquar në skenën e periodikëve shqiptarë, që shpërthyen në një periudhë liberalizmi dhe rritjeje të inteligjencës shqiptare në mbarë vendin. Revista lindi në vitin 1939 dhe heshti në vitin 1945 duke parandjerë zhvillime që do i binin ndesh kulturës dhe qasjes liberale dhe demokratike që ajo

u përpoq të manifestojë. Kohët që po ndryshonin nuk do të kishin hapësira për një frymëmarrje të çlirët, për tematikat *fetare, ditunore, letrare*. Ato do të ngushtoheshin në njëmendësinë tragjike, që po afrohej në epokën komuniste. Lënda e pasur informative e studimore në fushën e mendimit fetar e filozofik, materiali letrar, historik e shkencor, përkthimet dhe studimet e sjella në shqip, ishin produkte në koherencë me zhvillimet e mendimit të kohës, si dhe zgjerimin horizontin e pritjes së lexuesit shqiptar në këto fusha.

Nëse ndërmendim një copëz nga përkufizimi që jepte ky periodik në numrin 6-7 të vitit 1939 për kulturën, do të dëshmojmë se sa e ruan edhe sot e gjithë ditën pritshmërinë dhe aktualitetin kjo kredo e revistës “Kultura Islame”. Citojmë: *“Me fjalën kulturë, po e themi qartas, ne kuptojmë gjendjet ditunore a shkencore, letrare dhe artistike të popujvet dhe asgjatjetër. Duhet dijtë se kultura ka në vetvete rëndësi të madhe. [...] Po të jetë se kultura dobësohet në ndonjë popull, konkluzioni i këtij dobësimi s’asht tjetër veçse të paksuemit e prodhimit letrar, ditunor e artistik, kështu tregu i dijes asht në krizë. Tue i u çelë, në këtë mënyrë, udha injorancës, mendjet mbeten të shtangëta e statike. Gjenia e mëshehun në breznië humbë. Në këtë rasë, perveç çka u tha, ndodh, shpeshherë, që besimet dhe mendimet e idetë false të përhapen dhe populli gjindet ma afër inspiacionit, sygzhestionit a frymëzimit se sa kërkesës, qarimit, shkoqitjes dhe shpikjes”¹*

“...të paksuemit e prodhimit letrar..”, e veçova këtë sintagmë për të theksuar rëndësinë që parashikohej se do të kishte prodhimi letrar dhe studimi letrar. Në fakt, që në fillimin e saj revista do të kishte hapësirën e saj edhe për letërsinë. Nëse do t’i bënim një përshkrim se si silllej ky periodik në kuadrin e sistemit letrar shqiptar të atyre viteve, mund të themi se brenda tij ishte triada e famshme: prodhim, traditë dhe import. Me fjalë të tjera revista do të kishte si qëllim të saj prodhimin e freskët letrar, botimin dhe studimin e letërsisë tradicionale, si dhe përkthimin.

Në shkrimin e titulluar “Jehu i poezisë”, në numrit e tretë të kësaj reviste, studenti i letërsisë në Universitetin e Padovas, Fadil Karakaçi ndër të tjera shkruan: *“Poeti, asht i popullit të vet. Ai gëdhenë apotheosë të pa-krahasueshme lavdiye. Dashurin e vashës e këndon në gojën e krejtë një populli, dhe ngjyrat e hijeshme me të cillat veshë vargje të zgjedhun, i shijon ndër dritat transparente prej kah nxjerrë edhe tingujt e njaj melodije hyjnore”*.

1. Kultura Islame, nr. 6-7 viti 1939, f.228-229

Kundrejt këtij synimi që duket edhe si qëllimshmëri e këtij organi nisnin të provojnë vetveten me vargjet e tyre: Ferit Vokopola, Shaban Demiraj, Refik Bezhani, Besim Lëvonja, Bardhyl Nizami, Jolanda Kodra, Eqrem Çano, Halit Haveriqi, Rom, Murat Labënishti, Shero Imami, Petrit Kokoshi, Memli Mano, Veli Hafizi etj. Le të përvijojmë diçka nga ky prodhim letrar, duke veçuar vargje të ndryshme. Në një krijim të titulluar “Sureja e agimit” e Ferit Vokopolës shkruar në tetërokëshin popullor vërehen elemente të përmbajtjes filozofike e morale:

*Kur Zoti njerinë veçon,
Me begati e nderonë,
Ky at-herë zë e thotë;
Më nderove Ti o Zot!
Por se kjo më t’u paksuarë,
Mbesimin për të provuarë,
Nukë druhet që të thotë,
Më tradhtove Ti, o, Zotë!
Jo! Unë kurrë nuk tradhëtonjë!
Por ju jetimin s’e nderuatë!
Të vobegtin (e shikonjë)
Që pa bujtur e dëbuarë!
Trashëgimin që zotronia,
Me hallall-harram trazoni
Kamjen tepër dashuron.*

Ndërsa një tjetër poezi do të vijojë në numrin 5 të vitit 1940 nga një autor që më vonë do të bëhej njëri nga gjuhëtarët më të shquar, prof. Shaban Demiraj. Poezia është e shkruar në varg 11 rrokësh dhe mban titullin: “Lindjes Profetike”.

Vend të spikatur në revistë nisi të zërë proza, madje edhe drama. Këtu mund të përmendim në prozën e shkurtër Mustafa Mustafaj me titujt: “Rruga e mërgimit” (nr. 1-2, viti 1942), “Tradhtija”, “Ku asht baba?” që autori i quan *novella*. Revista do të botojë në disa numra të saj edhe një dramë idilike të shkrodranit Asim Lohja me titull: “Agim pranveruer i jetës shqiptare”, një dramë kjo me katër akte. Nga Murat Labënishti do të veçoja disa vargje nga poezia “Gjuha amtare”:

*Po nuk rojte mbi çdo tjetër
Gjuhën tënde të bekuar,
Atë flakë aq të vjetër
Që me shekujt t’ka ndriçuar.²*

2. Kultura Islame, nr. 3-4, viti 1945, f.72

Artikujt studimorë dhe kritikë do të jenë një vlerë e shtuar e revistës. Ajo i lë vend edhe kritikës letrare, e cila hedh indiciet e para të teorisë, të historisë dhe të akseologjisë letrare, këto sinjalizime dëshmojnë për kohën dhe dëshmohen me kohën. Duke evidentuar disa studiues dhe kritikë të letërsisë të formuar në universitetet më të mira të kohës, revista “Kultura Islame” gjendet në “fushën e betejës” dhe përpqet të shpallë ngallënjimit e veprave të reja dhe autorëve të rinj, që fillojnë jetën e tyre në sistemin letrar të kohës. Së fundi, kritika e kësaj reviste përpqet të merret me vlerësimin dhe prezantimin e rezultateve, cilësive, si dhe me çështjet e mospjesëmërisë apo lapsusave të ndryshme letrare.

Emra që spikasin janë: Sadik Bega, Sherif Putra. Studiuesi Fadil Karakaçi do të sjellë shkrimin “Euritmia” dhe më vonë në numrin 10 të vitit 1940 do të shkruajë një artikull interesant mbi mendimin pozitivist dhe romantik në letërsi.

Nga Izet Bebeziqi do të dallonim artikullin e botuar në nr.3 të vitit 1939 me titull: “Shqiptarizmi jashta dhe brenda atdheut”, ku studiuesi vëren se: “Qëllimi i vërtet i këtij studimi asht kryesisht me paraqitë se qysh u zhvillue Ideja Kombëtare Shqiptare dhe pamvarsija e Shqipnis. Dhe këtu qëndron kuptimi ma i randësishëm i rrolit t’arbnorëvet në viset e shteteve të hueja”. Më tej ai vijon me formimin e kolonive arbëreshe dhe kontributin e tyre në krijimin e prodhimit letrar shqiptar. Ky shkrim vijon edhe në numrin 4, ku evidentohen shkrimtarët më të shquar arbëreshë dhe sublimohet Jeronim de Rada.

Në numrin 10 të vitit 1940 një artikull i botuar nën pseudonimin PLUS me titull: “Rreth prodhimit letrar shqiptar” vërehet: “Sot kemi nevojë për një brez letrar! Këtë e lypim pse nuk e kemi. E këtë e lypim se si çdo popull edhe shqiptari jonë ka nevojë të bajnë at ndërmysmje drejt virtyteve të nalta që arti letrar gatuen. Por para se të bajmë këtë kërkesë le të shofim shkurtas se ç’rrol lot penda në jetën tonë”.³ Ndërsa po ky autor në një shkrim tjetër në përkujtim të poetit kombëtar Naim Frashëri shkruan: “Poeti i “Bagëti Bujqësisë” nuk qe tjetër jo, veçse njaj kangëtar i pastoral, njaj vargënuesi i shllimeve të shpirtit, njaj endues i trilleve të zemrës, e ma shquemas, njaj artisti i vërtetë qi vuen, por nuk duron”.⁴ Kurse tek shkrimi: “Kritiku dhe kritika” ai vëren: “Me pasë një kritikë të mirë, me sundue kritika e bujarshme, në një botë ku arti asht në kryengritjen e vet eterne, asht një fat. Fat po, për ato kritikë që e ndiejnë dejsinë e

misionit të tyre, të veprës së tyre”.⁵

Në numrin 7-8 të vitit 1944, studiuesi H.Ali ka shkrimin: “I ndjeri Hasa Zyko Kamberi 200 vjet përpara” ku thekson: “Hasani veç q’ ishte një alim i përmendur me një famë të madhe, por ishte edhe një poet i naturçim. Vjershëronte pa mundim dhe vjershat prej gojës së tij rrrithnin porsi ujë që rjeth prej çurkës, pa penguar e pa pushuar.”⁶

Prof. Shefik Osmani, i cili do të bëhej një nga titullarët e studimit pedagogjik në Shqipëri, boton në këtë organ me pseudonimin SHETOS. Ai do të ketë një shkrim me titull: “Nezim Ibrahim Frakulla nga Berati” dhe sjell një fakt interesant për dialogun e parë dramatik në gjuhën shqipe. Citojmë: “Nezimi i nxitun e i keqkuptuem ankohet dhe trakton kangen- Ankimi nga njerzia- e shek. XVII. Fill pas kësaj pason kanga shum e bukur: Folun me rastin e Shenllekut (piknikut) ne Bilçë. Ka deri diku vlerë historike. Myllet me një dialog që ndahet në dy pjesë, në: - Gjuha i flet zemrës- dhe si gjegje- “zemra e bren-gosur i gjegjet gjuhës” Duket se s’asht e mbarueme krejt. Porse me këtë dialog na kemi Nezimin e tanë: me mjerime, dalldisje, dashni e ashk.”⁷

Muhamet Bala na befason me një shkrim të nr.5-6-7 të vitit 1942 me titull: “A kemi një dram modern shqiptar” ku na jep një fakt të ngjashëm që mund t’i vlejë historisë së letërsisë shqiptare, veçanërisht historisë së gjinisë dramatike kur konstaton: “Në lamën e hartit dramatik asht shkrue shumë pak. Nezim Berati shkruen një bashkëbisedim në vjetin 1650 “Zemra e Shpirti”. Dishka baritore shkruen De Martini. Dal nga dalë fillon e ngjallet dram i historik, zhvillohet pak nga pak gjithnji e ma tepër.”⁸

Jolanda Kodra ishte një italiane, e lindur me emrin Iolanda Guazzoni, në vitin 1912, në Romë. Ajo ishte mbesa e Enrico Guazzoni, një skenarist dhe regjisor filmi italian. Ajo po ndiqte studimet në një lice klasik, kur u takua me bashkëshortin e saj të ardhshëm, Malo Kodrën, me origjinë nga Gjirokastra, i cili ishte student në Romë. Pas ardhjes në Shqipëri, e pajisur me një kulturë të mirë letrare e filozofike, ajo merr pjesë gjallërisht në shtypin e kohës duke botuar në revista të tilla serioze kulturore e letrare si: “Shkëndija”, “Hylli i Dritës”, “Përpjekja”, “Njeriu”,

5. Kultura Islame, nr. 20-21. Viti 1941, f. 179

6. Kultura Islame, nr 7-8, viti 1944, f.201

7. Shetos: “Nezim Ibrahim Frakulla nga Berati”, Revista “Kultura isl - me”, Nr. 5, 6, 7, janar, shkurt, mars 1942, f. 159.

8. “Në lamën e hartit dramatik asht shkrue shumë pak. Nezim Berati shkruen një bashkëbisedim në vjetin 1650 “Zemra e Shpirti” Dishka baritore shkruen De Martini. Dal nga dalë fillon e ngjallet dram i historik, zhvillohet pak nga pak gjithnji e ma tepër.” Bala, Muhamet: “A kemi një dram modern shqiptar”, Revista “Kultura islame”, Nr. 5, 6, 7, janar, shkurt, mars 1942, f. 214.

3. Kultura Islame, nr.10, viti 1940, f.396

4. Kultura Islame, nr. 13-14, viti 1940 f. 28

“Kultura Islame”, “Fryma”, etj, studime e artikuj me vlerë për veprën e disa përfaqësuesve më të shquar të letërsisë sonë kombëtare si: Naim Frashëri, Gjergj Fisha, Migjeni, Ndre Mjeda. Jolanda Kodra ka punuar veçanërisht për Migjenin dhe Mjedën, të cilën më vonë do e përkthente në italisht. Ajo ishte një nga gratë e para që publikoi në Shqipëri, në shoqëri të Selfixhe Ciu dhe Musine Kokalari. Pas Luftës së Dytë Botërore punoi si përkthyes duke përkthyer ndër të tjera edhe shkrimtarë të tillë si: Petro Marko e Sterjo Spasse. Ajo nuk ishte e lejuar as të japë mësim në regjimin komunist, as të kthehet përsëri në vendin e saj deri në vitin 1962, një vit para vdekjes. Në numrin e shtatorit të 1941 tek revista “Kultura Islame”, Jolanda Kodra do të përkthejë në italisht krijimin poetik: “Fluturimet Shpirtit” duke eksportuar kështu drejt një kulture dhe gjuhe të madhe krijimet më të fundit të letërsisë shqipe. Përkrah këtij përkthimi Gjergj Komnino do të shprehej: *“Të lumtë, por vetëm me një kusht: vazhdoje punën pa e prerë dhe përpiku të gjëmtoç lulet më të bukura të kopshtit tonë. Rëndësinë e shërbimit e njeherë brezi i nesërm dhe dashuronjësit e artit”*.⁹ Në numrin 8-9 të viti 1942 është po kjo figurë e re e letrave shqipe që do të krijojë poezinë në italisht dhe shqip: All’Albania (Shqipnis). Po citojmë strofën e parë të kësaj poezie me 12 strofa 8 vargëshe:

*“Kjo tokë më të cilën një ditë shkëlxej arma
E pathyeshme e Skanderbeut të lumnueshmëm
E q’ e fortë si’i shkrep qindron gjatë shekujvet,
E denjë do t’ ishte për një kangë të Horacit
Qe tue jehue n’ ether, za-math
Emnin t’ja bante dhe shembujvet të naltë
Bujarije, fuqije, e trimniye
T’u na naltësonte një hymn që kurr nuk vdes”*

Një numër më vonë Jolanda Kodra sjell të përkthyer artikullin: “Vlera ideale dhe qëllimet praktike të filozofisë”.

Xhemalije Shkreli (me pseudonimin Postribësja) e lindur në Shkodër në vitin 1919 është ndër femrat e para që vazhdoi studimet e larta në Universitetin e Firences, në Fakultetin Letërsi-Filozofi duke u formuar si një intelektuale me ide patriotike, progresiste dhe emancipuese. Përmes publicistikës së saj ajo i dha një sinjal të fortë shoqërisë shqiptare se koha për mendimin, vendin dhe rolin e gruas në jetën e vendit kishte ardhur për të mos u ndalur kurrë më. Në këtë kontekst Postribësja në numrin 5-6-7, të vitit 1942 tek “Kultura Islame” ka një artikull me

9. Kultura Islame, nr. 5-6-7, viti 1942, f.151

titull: “Tek autori i “Sikur t’isha djalë” ku shpreh gjithë ngazëllimin e një takimi që ka me këtë autor, i cili kishte bërë aq shumë me romanin që shkroi në lëmin e emancipimit të gruas shqiptare.

Në numrin 12 gusht 1940 botohet një poezi e Gjergj Komninos me titull: “Jeronim de Rada” nga ku do të citonim vargjet: *“Aqë këndshëm rrieth vargu, sikur se nga bar’i i blerë/ Je mermer, jo prej rubini, po prej palcës gjuhësore”*

Ndërsa në fushën e përkthimit mund të vlerësohen Sadik Bega, Vexhi Buharaja, të cilët përkthyen në disa numra të revistës artikuj të studiuesit të njohur arab Taha Hysseinit mbi udhëheqësit klasikë të mendimit si: Homeri, Sokrati, etj. Në nr 9 dhe 10 të vitit 1942 vjen i përkthyer nga italishtja një studim gjuhësor i Dr. Vittorio Vallonica: “Për një transkriptim racional dhe uniform t’Arabishtes me anë t’alfabetit shqiptar”. Në numrin pasues botohet artikulli me titull: “Nji pjesë e qytetnimit mysliman në Spanjë dhe në Siqeli” i sjellë nga një tjetër përkthyes që më vonë do të shkëlqente në fushën e leksikologjisë të gjuhëve orientale, Tahir Dizdari.

Veprimtari e sotme përpiket që të bëjë një rrugëtim dhe t’u ofrojë lexuesve, e sidomos studiuesve të mendimit letrar shqiptar, mundësitë për të njohur më mirë zhvillimet letrare në një periudhë të veçantë historike të mbarsur me ngjarje të shumta, por edhe qëndrimet, mendimet, si dhe aktivitetin e intelektualëve shqiptarë që patën fate nga më të ndryshmet në vitet që pasuan.

Ky dixhitalizim i revistës në faqen zyrtare të Bibliotekës së Shkodrës “Marin Barleti” është një ndihmesë e vyer, e cila bën të mundur takimin e një materiali të gjerë arkivor me publikun, duke e afruar atë me të shkuarën. Në të njëjtën kohë është një homazh për përvujtninë intelektuale të një brezi që punoi me idealizëm më mjetet e kulturës dhe të dijës. Revista është një model që bën të mundur lehtësimin e lidhjeve të shoqërisë shqiptare dhe sidomos me trashëgiminë kulturore të elitave intelektuale paraardhëse. Mendoj se Biblioteka “Marin Barleti” e Shkodrës ka bërë një punë të mirë dhe duhet falënderuar, si një institucion i hapur ndaj vlerave të trashëguara, të cilat mund të ofrohen sot si modele të zhvillimit mediatic. Një tjetër falënderim shkon për shoqatën e re kulturore “Përpjekje” që e nxiti dhe organizoi këtë veprimtari. Të gjitha këto janë vlera të rëndësishme, për të cilat shoqëria shqiptare ka shumë nevojë.¹⁰

10. Kumtesë e mbajtur në aktivitetin “Revista ‘Kultura Islame’ (1939-1945) – ‘Kujtesë dhe model për kulturën e ditëve tona’ organizuar nga Shoqata ‘Përpjekje’ dhe Biblioteka ‘Marin Barleti’ me datë 16 shkurt 2018.



Të shesësh AHIRETIN

për këtë botë

— Ali Riza Temel —

më pak e çmuar, nuk është mençuri, por një dëm total.

Kështu është edhe shitja e ahiretit/botës së përjetshme për të fituar diçka prej kësaj bote. Të heqësh dorë nga milionat e së nesërme për tre qindarka të së sotshme, është një marrëzi. Në Kuran urdhërohet:

“Vërtet që jobesimtarët e duan jetën e këtushme dhe nuk e përfillin një Ditë të vështirë, që do t’u vijë.” (Insan, 27)

Për shkak se nuk i besojnë ahiretit/botës tjetër, mohuesit e shpenzojnë të gjithë kohën e jetës së tyre për të fituar pasuri të kësaj bote. Por, në këtë mënyrë, ata shkojnë duarbosh në tregun e Ahiretit, ekzistencën e të cilit nuk e besojnë. Kështu, ata privohen prej fitimit që sjell besimi dhe dënohen me dëmin që sjell mohimi. Allahu i Madhëruar, i paralajmëron në këtë mënyrë besimtarët, me qëllim që të përgatiten për të nesërmen:

“O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe çdo njeri le të shohë se ç’ka përgatitur për të nesërmen!..” (Hashr, 18)

Për shkak se dashuria për këtë botë dhe lakmia për pasuri u ka errur sytë, shumë njerëz e sakrifikojnë jetën e përjetshme për këtë jetë të përkohshme: **“Këta janë ata që jetën e kësaj bote e kanë blerë me jetën e ardhshme. Atyre nuk do t’u lehtësohet dënimi dhe askush nuk do t’u vijë në ndihmë.”** (Bekare, 86)

Të gjitha fitimet që nuk synojnë kënaqësinë e Allahut dhe jetën e përjetshme, bëhen shkak i pendesës dhe keqardhjes. Nëse pasuritë që fitohen me fuqinë dhe mundësitë që ka falur Allahu, shpenzohen në rrugën e mosbindjes dhe mohimit të Allahut, ato do

Tregtia bëhet për të siguruar fitime në rrugë halall. Kjo është një punë e pranuar edhe në fenë tonë. Madje, ky ka qenë edhe një nga profesionet e të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe të imamit të medh’hebit tonë, Ebu Hanifes.

Fitimi ndahet në dy pjesë, ai material dhe ai shpirtëror. Për shkak se ka të bëjë me fitimin e botës së përjetshme, fitimi shpirtëror është më i rëndësishëm. Nëse fitimet e përkohshme dhe kalimtare synojnë fitimin e të përherëshme dhe përjetshme, kjo konsiderohet një lëvizje shumë e mençur. Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“O besimtarë, a doni t’ju drejtoj në një tregti, e cila ju shpëton nga një dënim i dhembshëm?! Besoni në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij dhe luftoni në rrugën e Allahut me pasurinë dhe veten tuaj. Kjo, nëse do ta dini, është më mirë për ju. Ai do t’jua falë gabimet tuaja dhe do t’ju shpjerë në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe në banesa të mrekullueshme në Xhenetin e Adnit. Kjo është fitorja më e madhe.” (Saff, 10-12)

E përherëshmja, është më e çmuar se ajo e përkohshme. Njeriu i mençur, nuk mashtrohet me pasurinë, fundi i së cilës është asgjëja, por përipiqet që të përkohshmen ta kthejë në të përherëshme. Të japësh më të çmuarën dhe të marrësh atë që është

të kthehen në një dënim absolut: **“...Ata që grumbullojnë ar dhe argjend dhe nuk e shpenzojnë për hir të Allahut, paralajmëroji me dënim të dhembshëm. Do të vijë dita, kur (thesaret e mbledhura) do të digjen në zjarrin e Xhehenemit dhe me to do të damkoset balli, anët dhe shpina e tyre e do t’u thuhet: «Kjo është ajo që keni grumbulluar për veten; pra, shijoni atë që grumbulluat!»**” (Teube, 34-35)

“...Kështu, Allahu do t’ua tregojë veprat e tyre si burim hidhërimi për ta...” (Bekare, 167)

Nëse lakmia dhe epshi për këtë botë t’i verbon sytë, nuk e bën më dallimin midis dobisë dhe dëmit, fitimit dhe humbjes. **“Sa për ata që nuk besojnë, veprat e tyre janë si mirazhi në shkretëtirë e të cilin i etshmi e kujton për ujë, por, kur arrin tek ai vend, nuk gjen asgjë...”** (Nur, 39)

Fëmija, me mendjen e tij mund ta ndërrojë një monedhë floriri me një mollë sheqeri. Pra, e gjithë çështja, është të arrish të perceptosh se çfarë është më e vlefshme dhe çfarë është më e pavlefshme.

Ata që shesin Ahiretin për këtë botë, nuk janë vetëm të pafetë. Ahiretin e shesin edhe ata që hiqen si fetarë dhe e përdorin fenë si një mall tregtie për interesat e tyre. **“Padyshim, ata që fshehin çfarë ka shpallur Allahu në Libër dhe e këmbëjnë atë me diçka tjetër të pavlerë, do të gëlltisnin në barkun e tyre vetëm zjarr. Në Ditën e Kiametit, Allahu nuk do t’u flasë atyre, nuk do t’i pastrojë (nga gjynahet) dhe do t’u japë dënim të dhembshëm. Ata e kanë këmbyer rrugën e drejtë me humbjen dhe faljen e Zotit me dënimin e Tij. Po sa të durueshëm do të jenë në zjarr?!”** (Bekare, 174-175)

Të sakrifikosh Ahiretin për interesa të kësaj bote, në vend që ta bësh fitimin e kësaj bote mjet për fitimin e botës tjetër, është një pakujdesi dhe gaflet i tmerrshëm. Fitimi më i pistë, është ai që arrihet duke përdorur Allahun, Profetin (a.s.), Kuranin dhe parimet e shenjta të fesë. Mirëpo, Zoti ynë i Madhëruar na ndalon rreptësisht nga ky veprim duke na urdhëruar: **“...Mos i këmbeni shpalljet e Mia me një vlerë të vogël dhe ruhuni vetëm prej Meje!”** (Bekare, 41) Çështja, nuk është t’i shesësh lirë apo shtrenjtë, por në këtë ajet kërkohet të theksohet se çdo gjë është e lirë përballë shpalljes së Zotit, madje ato janë thjesht asgjë!


Një besimtar, nuk e shet as veten dhe as të shenjten e tij për interesa të kësaj bote, sepse as njeriu dhe as të shenjtat e tij nuk kanë një ekuivalente në këtë botë. Blerësi më i mirë i njeriut është Allahu, ndërsa pagesa bëhet me Xhenet. **“Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhenetit!...”** (Teube, 111) Siç shprehet Mevlana, **“Allahu na bleu, duke na shpëtuar prej shitjes, sepse një mall nuk shitet dy herë!”**

Myslimanët e parë sakrifikuan edhe pasurinë edhe jetët e tyre për të ngritur lart dhe për ta valëvitur në horizont flamurin e teuhidit/besimit në një Zot. Në këtë mënyrë, ata ngritën lart edhe kauzën, por edhe veten e tyre. Froni që ndërtoan ata në zemrat e tyre, është më i çmuar se sa fronet e rrënueshme të mbretërve, sepse sundimet shpirtërore nuk rrënohen me sundime materiale. Ku janë fronet e bëra prej druri, e ku janë fronet e ndërtoara prej besimit, dashurisë dhe sakrificës!? A mund të jetë i barabartë sundimi i shpirtit me sundimin e trupit?

Le të japim këtu një shembull të bukur në lidhje me ata që e sakrifikojnë jetën e kësaj bote pa iu dridhur as qerpiku, për të shpëtuar Ahiretin e vet dhe atë të të tjerëve:

Në një transmetim të shënuar në Sahihun e Muslimit, i Dërguari i Allahut (a.s.), tregon për një mbret, një magjistar dhe një djalë të ri. Shkurtimisht, ndodhia është kështu:

“Para shumë kohësh ka jetuar një mbret, i cili kishte një magjistar. Kur magjistari e ndjeu se po i vinte vdekja, kërkoi nga mbreti një djalë të ri që t’i mësonte magjinë. Atij iu dërgua një djalë i ri siç e kërkoi vet. Gjatë rrugës për tek magjistari, djali takoi një murg pas të cilit u lidh dhe mësoi shumë. Njëherë, kur djali i tregoi murgut një ngjarje të jashtëzakonshme, ai i tha se tashmë kishte arritur një gradë të lartë shpirtërore dhe se ishte më i virtytshëm edhe se vet ai. Mirëpo, murgu i tha edhe se ai do të sprovohej me disa vështirësi. Djali i ri shëronte të verbrit, lebrsët dhe sëmundje të tjera. Kur mbreti e dëgjoji këtë, e pyeti djalin se si i shëronte të verbrit. Ndërsa djali i ri i tha se shërimi është prej Allahut. Mirëpo, mbreti, i cili pretendonte se ishte vet zot, i thotë djalit, “a ka zot tjetër përveç meje!?” dhe më pas i bëri presion që të kthehej nga feja e vet. Mirëpo, djali rezistoi



Fitimi ndahet në dy pjesë, ai material dhe ai shpirtëror. Për shkak se ka të bëjë me fitimin e botës së përjetshme, fitimi i shpirtëror është më i rëndësishëm. Nëse fitimet e përkohshme dhe kalimtare synojnë fitimin e të përhershmes dhe përjetshmes, kjo konsiderohet një lëvizje shumë e mençur.

dhe, megjithëse ata i provuan të gjitha mënyrat për ta vrarë, duke e hedhur nga maja e malit, duke u munduar të mbytnin në det, etj., nuk ia arritën dot qëllimit të tyre.

Më në fund, djali i drejtohet mbretit, i cili nuk dinte ç'të bënte më dhe i thotë se, nëse doni të më vrisni, më lidhni në trugun e një peme, merr një shigjetë, vendose në hark dhe gjuaje atë duke thënë: "me emrin e Zotit të këtij djali!". Vetëm kështu mund të më vrasësh. Mbreti veprroi ashtu si i tha djali dhe më në fund ia arriti qëllimit. Mirëpo, populli që dëgjoji nga goja e mbretit shprehjen: "me emrin e Zotit të këtij djali", i besuan Zotit të vërtetë të gjithë përnjëherësh dhe ngritën krye ndaj mbretit. Më pas, me qëllim që të ndëshkonte popullin që besoi Zotin e vërtetë, mbreti urdhëroi të hapen hendeqe në të cilët u ndezën zjarre ku hidheshin ata që besonin Zotin."

Mesazhi që kërkohet të jepet në këtë ndodhi, është ky:

Përballë mbretit që pretendonte se ishte Zot, siç bënte Faraoni, qëndronte palëkundur një djalë i ri si Musai (a.s.), i cili sakrifikoi veten e tij që populli të besonte Zotin e vërtetë. Ky djalë, ishte një monument durimi dhe besimi. Me këtë veprim fisnik, ai e ktheu dhimbjen kalimtare në lumturi të përjetshme.

Po ashtu, edhe As'hab-i Kehf / Shokët e Shpellës, të cilët ishin të gjithë të rinj, e braktisën jetën e tyre luksoze dhe u strehuan në shpellë për hir të besimit në Zotin e vërtetë. Në sytë e tyre, jeta që bëhej në pallatet e bukura por pa besim, ishte si në shpellë, ndërsa jeta që bënë në shpellë, por me besim, ishte si jetë pallati. Po kështu, edhe gruaja e Faraonit i besoi Zotit të gjithësisë dhe i doli kundër burrit të vet. Për rrjedhojë, ajo iu nënshtrua vuajtjeve të kësaj bote. Mirëpo, ajo kishte zgjedhur pallatet e bukura

e të përjetshme të Xhenetit në vend të pallateve të përkohshme të faraonit.

Njerëzit e mençur, mendojnë në mënyrë afatgjate dhe zgjedhin ato të përhershmet në vend të atyre të përkohshmeve. Ky është fitimi dhe triumfi i vërtetë. Ndërsa injorantët dhe mendjeshkurtrit, tundohen prej lakmisë së kësaj bote dhe dëshirave të përkohshme, duke e çuar dëm jetën e botës tjetër për hir të jetës së kësaj bote.

Le t'i vëmë veshin këtyre fjalëve të Mevlanës së nderuar: "Ky sy do të mbushet nga dheu në varr. A ke dritë të ndriçosh atë varr? Ke mësuar një art prej mirësisë së trupit, jepi një dorë edhe artit të fesë! Në këtë botë ke rroba, u pasurove!.. Por si do të bësh kur të shkosh nga kjo botë? Edhe ajo botë është një vend i mbushur me tregje dhe fitime. Pra, mos kujto se vetëm në këtë botë të duhet të fitosh dhe se ky fitim është i mjaftueshëm. Kujto fëmijët kur luajnë dyqanesh! Përveç kalimit të kohës, ata nuk fitojnë asgjë. Vjen nata dhe fëmija kthehet i uritur në shtëpinë e vet. Fëmijët e tjerë ikin dhe ai mbetet fillikat. Kjo botë, është vend loje, ndërsa vdekja është nata. Ti kthehesh, por e ke qesen bosh, ndërkohë që je i lodhur dhe i rraskapitur!"

"**Ta dini, se jeta në këtë botë, nuk është tjetër veçse lojë, dëfrim e zbulurim, si dhe mburrje ndër-mjet jush e rivalitet për më shumë pasuri dhe fëmijë! Ajo i shëmbëllen bimës, e cila pas shiut rritet dhe i gëzon bujqit, por më vonë zverdhet, thahet dhe mbetet pa vlerë. Në botën tjetër ju presin vuajtje të mëdha ose falja e Allahut dhe kënaqësia e Tij; jeta në këtë botë është vetëm kënaqësi e rreme.**" (Hadid, 20)

"**Por ka dhe të tjerë që thonë: «Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë, na jep të mira në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i Zjarrit (të Xhehenemit)»"** (Bekare, 201)

TË SAKRIFIKOSH AHIRETIN PËR INTERESA TË KËSAJ BOTE, NË VEND QË TA BËSH FITIMIN E KËSAJ BOTE MJET PËR FITIMIN E BOTËS TJETËR, ËSHTË NJË PAKUJDESI DHE GAFLET I TMERRSHËM. FITIMI MË I PISTË, ËSHTË AI QË ARRIHET DUKE PËRDORUR ALLAHUN, PROFETIN (A.S.), KURANIN DHE PARIMET E SHENJTA TË FESË.

ISLAMI

është një maratonë, jo një sprint

— Merve Abdalla —

“Vetëm vër një këmbë para tjetrës,” kërkova nga vetja.

Po rendja së përpjetës, pas një pike furnizimi me ujë, dhe ndjeva sikur nuk po ia dilja në krye.

Ishte maratona e parë në të cilën kisha vrapuar, 26.2 milje, pak më tepër se 40 kilometra. Njerëzit më kishin treguar para maratonës për goditjen “e murit”, për pikën ku lëvizja përpara bëhej tepër e vështirë. Sjell në mendje se kisha rreth gjashtë milje të tjera për të vrapuar para se të godisja “murin” tim.

Kujtoj vetëm dëshirën për të ndaluar. Gjashtë milje të tjera, një orë tjetër vrapim, ngjanin goxha rrugë.

Hapi im u ngadalësua. Vrapues të tjerë më kaluan në të djathtë dhe në të majtë. U ndjeva e shkurajuar. Sa kohë më duhej ende për të mbërritur?

Mbërritje.

Po, u kujtova. Ky ishte objektivi im, të mbërrija në finish.

Diçka lëvizi brenda meje. Duhet të vazhdoja. Ritmi im ishte më i ulët, por ende po bëja përpara. Po ia dilja të arrija në finish, me lejen e Allahut...

Qindra mijëra njerëz anekënd botës bëjnë çdo vit maratona, gara 26.2 milje të gjata.



Pjesa më e madhe e tyre nuk janë vrapues profesionistë. Ata vijnë nga profesione të ndryshme, e me të shkuar të ndryshme, flasin gjuhë të ndryshme e kanë arsye të ndryshme për vrapimin. Por të tërë kanë diçka të përbashkët: duhet të stërviten, të përgatiten.

Allahu i plotfuqishëm na thotë:

*Bëni garë për falje nga
Zoti juaj dhe një xhennet,
gjerësia e të cilit është si
gjerësia e qiejve dhe tokës,
i përgatitur për ata që
besuan në Allahun dhe
në të dërguarit e Tij. Kjo
është mirësia e Allahut,
që Ai ia jep kujt të dojë.
Allahu është posedues i
mirësisë së madhe.*

(Hadid, ajeti 21)

Askush nuk mund të ngrihet një mëngjes dhe të vendosë të vrapojë njëzet e gjashtë milje ngaqë ka dëgjuar një bisedë frymëzuese apo ka lexuar një artikull nxitës për të bërë kështu. Të vrapuarit në një maratonë merr muaj të tërë përgatitje, përgatitje fizike, por gjithashtu përgatitje psikologjike, për të forcuar durimin dhe ngulmimin e nevojshëm për ta mbaruar garën.

Përgatitja ime për maratonën pati filluar muaj përpara garës. Ndoqa një program të përpiktë. Në javën e parë do të vrapoja dy milje në ditë, për katër ditë me radhë. Në fund të javës do të bëja një vrapim të “gjatë”. Vrapimi im i gjatë ishte fillimisht tre apo katër milje, por çdo javë do ta shtoja largësinë, dhe ai u bë gjithnjë e më i gjatë.

Unë vrapoja thujse njëzet e gjashtë milje pas gjashtë muajsh. Isha gati të bëja maratonën time të parë.

E di se mund të vrisni mendjen se ç’lidhje ka Islami me përgatitjen për një maratonë? Pse e tregon tani këtë histori?

Mirë, përgatitja për maratonën dhe vrapimi në të më mësuan shumë gjëra, mes të tjerash, sa të rëndësishëm janë durimi dhe këmbëngulja kur duam të bëjmë diçka, apo të shkojmë diku. Ky mësim gjen zbatim në shumë fusha të jetës, por në mënyrë të veçantë teksa përpiqemi të rritemi në besimin tonë.

ZBULIMI I SË VËRTETËS

Allahu na tregon se ka marrë një betim nga të gjitha qeniet njerëzore që Ai krijoi kur ne ishim në botën e ekzistencës që i parapriu kësaj bote fizike. Kur’ani i referohet kësaj:

Kur Zoti yt nxori nga kurrizi i bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri të dëshmojnë kundër vetes, u tha, “A nuk jam Unë Zoti juaj?” Ata u përgjigjën: “Po, dëshmojmë se je!” (Surja el-Ar’af, ajeti 172)

Kështu, në çdonjë nga ne është kjo e vërtetë, se Allahu është Zoti ynë, dhe se ne u krijuam për adhurimin e Tij.

Kur kjo e vërtetë nuk ushqehet, ajo mbulohet nga pluhuri shpirtëror që ne mbledhim në jetë. Ne mbërthehem në këtë mënyrë në rutinat tona të zakonshme, të hutuar kështu nga shkëlqimi i shfaqur rreth nesh, sa harrojmë se e vërteta është dhe aty.

Nganjëherë, me vullnetin e Allahut, një pjesëz e asaj të vërtete na shfaqet nga poshtë pluhurit.

Mbase është në përgjigje të një përvoje që kemi që na kujton për Allahun, për shkak të një leksioni që dëgjojmë, a të një artikulli që lexojmë.

Kur kjo ngjet, ne ndiejmë një shpërthim energjie të na shtyjë përpara, e ndihemi sikur jemi në fillimin e një gare, gati për të nisur sprintin në një pistë flakë të re. Ne duam të vrapojmë me tërë shpejtësinë drejt Allahut, larg unit që aq shumë duhet ta përmirësojmë.

Por pasi kemi lëvizur me të shpejtë përpara për pak hapa, nisim të humbim vrullin. Shuhemi pak nga pak. Ndiejmë sikur është një largësi e madhe për t'u bërë e tëra me sprint. Madje mund të ndalojmë fare, duke vrarë mendjen se ku kemi gabuar. A nuk ishte i sinqertë kthimi ynë te Allahu?

Pse nuk mund të bëjmë përpara me të njëjtin ritëm?

PROBLEMI YNË

Jo! Nuk kemi gabuar askund.

Jo! Nuk mungon asgjë në sinqeritetin e kthimit tonë. Ne thjesht e nisëm garën me premisën e gabuar, me hamendjen e gabuar.

Ju e shihni, Islami nuk është një sprint. Është një maratonë.

Thuajse çdokush mund të vrapojë shpejt për një distancë të shkurtër, e pastaj të ndalojë. Por një maratonë është ndryshe. Edhe vrapuesit më të mirë në botë nuk mund të vrapojnë me sprint për 26.2 milje. Ata duhet të vrapojnë me hap më të ngadaltë për ta çuar në fund garën.

Kështu, problemi ynë nuk është gjatësia e garës. Është ideja se duhet ta bëjmë garën me tërë shpejtësinë, menjëherë.

ISLAMI ËSHTË SI NJË MARATONË

Ashtu si një maratonë, Islami është një garë e distancave të gjata. Është një përpjekje që zgjat tërë jetën, që kërkon stërvitjen e vetes.

Kërkon gjithashtu durim dhe ngulmim. Durim për të bërë atë që Allahu ka kërkuar nga ne dhe për të qëndruar larg nga ajo që Ai ka ndaluar; ngulmim për të vazhduar në ndjekje të dritës së Islamit edhe kur gjithçka rreth nesh ngjan e errët.

Dhe ashtu si vrapuesi i maratonës, ne të gjithë nganjëherë i godasim “muret” shpirtërore, kur duket e vështirë thjesht të vësh një rënë këmbë para tjetrës. Në kohë të tilla, veç durimit dhe ngulmimit, na nevojitet diçka tjetër, diçka më madhe.

“...Gjashtë milje të mbetura, pastaj pesë, katër. Nuk ishte e lehtë. Ca momente ishin torturuese. U përpoqa ta sjell në mendje Allahun, ta lartësoj Atë me çdo hap, dhe të kujtoj se me çdo hap jam më pranë.

Shpejt u duk fundi. Mund ta shihja kronometrën e madh në anë të finishit. Kisha qenë duke vrapuar për katër orë; jo një rekord botëror, madje as afër tij. Por kisha bërë më të mirën, dhe të gjitha falënderimet i takonin Allahut.

Në një turbullirë njerëzish dhe zhurmash, kalova vijën e finishit. Maratona kishte mbaruar më në fund. Dola anash dhe rashë në gjunjë, thjesht duke u përpjekur të mbaj frymën. U ndjeva e dobët dhe e lodhur, por e gëzuar, si edhe shumë mirënjohëse ndaj Allahut. Ia kisha dalë më në fund ta përfundoj garën pas aq shumë muajsh stërvitjeje.”

Allahu i plotfuqishëm na thotë:

Bëni garë për falje nga Zoti juaj dhe një xhennet, gjerësia e të cilit është si gjerësia e qiejve dhe tokës, i përgatitur për ata që besuan në Allahun dhe në të dërguarit e Tij. Kjo është mirësia e Allahut, që Ai ia jep kujt të dojë. Allahu është posedues i mirësisë së madhe. (Surja el-Hadid, ajeti 21)

Po, për të garuar me sukses drejt Allahut na duhet durim dhe këmbëngulje. Por në të njëjtën kohë na nevojitet besim i patundur te Ai dhe te plani i Tij për ne. Ne duhet ta dimë se edhe pse jeta është plot me sprova, një mirësi e madhe na pret në vijën e finishit: falja e Allahut dhe xhenneti. Kjo është ajo çka na jep paqe, edhe përballë sfidave. Kjo është ajo çka lëviz diçka brenda nesh në kohë të vështira dhe na ndihmon të bëjmë përpara.

Çdokush që bën një maratonë do t'u tregojë sa sfiduese është; ata gjithashtu kanë për t'ju treguar se lumturia e tyre në vijën e finishit ka për të peshuar më shumë se dhimbja që ndjenë pa dyshim gjatë garës. Por arritja në vijën e finishit ka më rëndësi se një sprint në fillim. E njëjta gjë mund të thuhet kur ne flasim mbi Islamit.

Fitorja e vërtetë vjen nga ndjekja e udhëzimit të Allahut. Me durim, këmbëngulje, dhe me një bindje të palëkundur se premtimi i Tij për ne është i vërtetë. Gjersa, kur Allahu do, ne e përfundojmë garën.

Allahu na ndihmoftë të tërëve të bëjmë kështu!

GEDIK AHMED PASHA

SUNDIMTAR I DY ÇELËSAVE TË ADRIATIKUT

— Dr. Ardian Muhaj —

Megjithëse emri i këtij burrështetasi tradicionalisht është i lidhur me marrjen e Otrantos në 1480 veprimtaria e tij është shumë më e gjerë se ajo fushatë jetëshkurtër dhe e pafryt. Duhet theksuar se ishte i vetmi qeveritar osman që ia doli të shtrijë sundimin e tij mbi dy çelësat ose portat e Adriatikut, Vlorën në bregun shqiptar dhe Otranton në bregun italian. Lidhur me origjinën e tij etnike shumica dërrmuese e burimeve pohojnë se ishte shqiptar.¹ Ka qenë kryeministër në vitet 1473-1474 dhe 1476-1477, pikërisht në vitet e fundit të luftës mes venedikasve dhe osmanëve që zgjati 16 vjet, pra ndërmjet viteve 1463-1479.² Natyrisht që përpara se të bëhej kryeministër i ngjiti shkallët e karrierës politike në mënyrë graduale dhe duke dëshmuar aftësitë e duhura për ngritjen në shkallën më të lartë të pushtetit ekzekutiv osman. Që në vitin 1461 arriti të bëhej bejlerbe i Anadollit ndërsa vezir u bë në 1470 dhe vezir i dytë në 1472.

Shkëlqimi i karrierës së tij arriti kulmin në vitet 1470. Në këto vite ai ia doli t'i nënshtrojë përfundimisht bejlikët apo principatat e fundit që pengonin shtrirjen e sundimit osman në Anadoll, karamanidët. Këta për dy shekuj rresht kishin rivalizuar me osmanët për kontrollin e Anadollit, dhe shumë herë e kishin kërcënuar ekzistencën e vetë shtetit osman në filltet e tij. Fitorja përfundimtare mbi karamanidët në 1471 dhe marrja e zonave bregdetare të Egjeut në Anadoll si Ermenek, Menan and Silifke, patën një rëndësi të madhe për forcimin e shtetit osman në atë rajon. Pas këtyre fushatave të sukseshme në Anadoll dhe në Egje, në vitin 1475 iu drejtua Detit të Zi, për të ndihmuar emiratin e Krimesë në luftën e tyre kundër gjenovezëve në atë zonë. Me këtë rast sërish u shqua për aftësitë e tij ushtarake dhe organizative. Mori koloninë kryesore gjenoveze në Detin e Zi, Kafën si edhe kolonitë e tjera të tyre, duke i dhënë fund pranisë dyshekullore të gjenovezëve në Detin e Zi. Pas fushatës së Krimesë u rikthye në krye të flotës osmane në detin Mesdhe në operacione të sukseshme detare kundër flotës venedikase. Në rrethimin e dytë të Shkodrës të vitit 1478-1479, iu bashkua forcave rrethuese dhe pikërisht në këtë rast dalin për herë të parë kontradiktat me sulltanin Mehmeti II, të cilat do të rishfaqen edhe më pas me pasardhësin e tij Bajazitin II. Nga fundi i luftës mes osmanëve dhe venedikasve të viteve 1463-1479, u caktua sanxhabe i Vlorës. Në rrethimin e Shkodrës pati një mosmarrëveshje me shtabin e luftës me sa duket për shkak të pikëpamjeve të ndryshme mbi strategjinë e luftës mes tij dhe bejlerbejve kryesorë ose me vetë Sulltanin Mehmeti II dhe u transferua si sanxhakbe i Selanikut.

Marrdhëniet diplomatike mes Venedikut dhe Perandorisë Osmane

1. Heath W. Lowry, *The Nature of the Early Ottoman State*, SUNY Press, 2003, f. 116.

2. Halil Inalcik mendon se ai erdhi dy herë në postin e kryeministrit apo vezir'i azam, më 1473-1474 dhe 1476-1477. Halil Inalcik, recensë mbi librin e Franz Babinger, *Mehmed the Conqueror (1432-1281) and his time*, New Jersey: Princeton University Press, 1978, f. 415.

mbas nënshkrimit të paqes dhe deri në vdekjen e sulltanit Mehmeti II më 3 maj 1481, janë shumë të dendura dhe përcaktojnë në vija të përgjithshme marrdhëniet e dy shteteve deri në fundin e Republikës.³ Rivaliteti veneto-aragonez shtrihej edhe në Ballkan,⁴ dhe kjo e shpjegon edhe dyshimin se ishte vetë Venediku që në 1479 i sugjeroi Sulltanit Mehmeti II përmes bailiut në Stamboll se shteti osman ishte ligjërishi i justifikuar për të marrë qytetet aragoneze të Brindizit, Tarantos dhe Otrantos, pasi ato kishin qenë pjesë e shtetit bizantin.⁵ Në gusht 1479 në Venecia mbërrin një emisar i dërguar nga Ahmet Gedik Pasha, sanxhakbe i Vlorës që deklaroi miqësinë e tij me Venedikun dhe thekson faktin se vetëm Papa dhe Ferdinandi i Napolit ishin kundërshtarët e tij. Gjithashtu ai kërkoi që Sinjoria t'i dorëzojë fortesat e Sopotit dhe Himarës të cilat ai pohon që i përkisnin shtetit osman. Më 23 gusht Senati përgjigjet se nuk kishte arsye t'i konsideronte armiq Papatin dhe Napolin, ndërsa lidhur me fortesat e Himarës dhe Sopotit, Senati me takt ia lë në dorë negociatën direkt me Stambollin dhe jo me qeveritarin shqiptar. Përmes një letre të dërguar nga negociatori venedikas Trevisan më 23 shtator, Mehmeti II pohon respektimin e marrëveshjes së paqes dhe duke mbajtur anën e shqiptarit, kërkoi zyrtarisht dy fortesat. Në teutor Ahmed Gedik Pasha drejtohet me forcat e tij kundër ishullit të vogël të Bastias (Sajadhës) afër Korfuzit, të cilën e bastoi, me synimin për të krijuar një zonë sigurie në kufi. Më 23 nëntor 1479, Senati udhëzoi bailiun Gritti që të protestojë butësisht për veprimet e mbrapshta të Ahmed Gedik Pashës në Bastia, la Rilla, të zotëruara nga Venedikasit prej më se njëqind vitesh. Shqiptari i përgjigjet se aksioni i tij duhej marrë sikur veprimi i atij që hyn në bahçen e një miku, që dëmton diçka por pa të keq mbasi sundimtari i tij ishte mik i Venedikasve.⁶ Në këto kushte Mehmeti II ngarkoi Ahmed Gedik Pashën që të marrë zotërimet e Leonardo Tocco në bregdetin jonian dhe flota venedikase urdhërohet që të mos i sjellë asnjë pengesë operacioneve osmane. Në këtë fushatë Gedik Pasha mori ishujt e Shën Maurës, Qefalonisë dhe Zakintosit, që i përkisnin vasalit të Napolit Leonard Tokos.⁷

Veprimi më i guximshëm i tij ishte projekti për shtrirjen e sundimit në anën tjetër të bregut adriatik, në Pulja. Kjo fushatë i gjeti të papërgatitur edhe vetë napolitanët. Mbreti Ferdinandi i Napolit i interesuar më tepër me politikën italiane duket se mendonte që objektivat e Gedik Pashës ishin përmbushur me marrjen e zotëimeve të vasalit të tij Leonard Tokos.⁸ Kjo ndërmarrje e guximshme në fakt duket që në fillim

3. K. M. Setton, *The Papacy and the Levant (1204 - 1571)*, II, 1978, f. 328 ss.

4. Alessio Bombaci, "Venezia e l'impresa turca di Otranto", *Rivista Storica Italiana*, LXVI, 1954, f. 175-176.

5. Franz Babinger, *Mehmed the Conqueror and his Time*, Princeton 1978, f. 390.

6. Kontantinos N. Sathas, *Documents inédits relatifs à l'histoire de la Grèce au Moyen Age publiés sous les auspices de la Chambre des députés de Grèce*, vol. VI, Venezia, 1885, f. 217.

7. Zamputi I. (1967), doc. 36, 38, pp. 43, 44.

8. K. W. Treptow, "Albania and the Ottoman invasion of Italy, 1480-1481", *Studia Albanica*, v. 1, 1990, f. 81-105.

se ishte një projekt i tij dhe që synonte të përmbushte ambiciet e tij për pushtet sa më të madh. Mund të thuhet se burimet osmane dhe ato perëndimore përkohë në këtë aspekt. Haxhi Halifa shpëgon se mbasi që shkarkuar nga detyra e kryeministrit dhe burgosur për një periudhë të shkurtër, sulltan Mehmeti II e thirri në kohën kur po kthehej nga rrethimi i Shkodrës. Me këtë rast perandori me kënaqësi i ofroi postin e guvernatorit të sanxhakut të Vlorës. Në vitin 884 h. ai mbërriti në Stamboll dhe i paraqiti Mehmetit II planin e tij për marrjen e Puljes dhe lehtësinë me të cilën kjo ndërmarrje mund të kishte sukses. Qeveritari shqiptar kërkoi ndihmë në forca e mjete dhe sulltani nuk hezitoi të mbështeste projektin e tij, duke dhënë urdhër që të përgatitej një flotë e përshtatshme si edhe mjetet e furnizimit e duhura.⁹ Edhe këmbëngulja e tij për ta mbajtur me çdo kusht pjesën tejadriatike të sundimit të tij del e qartë në dokumentacionin e kohës. Madje arrin deri aty sa që të pengojë negociatat e paqes mes Stambollit dhe Napolit, duke nxitur incidente diplomatike në mënyrë që marrëveshja e paqes mos të arrihej. Të gjitha këto manovrimet kryeneçe dhe ambicie të shfrenuara do t'i kushtojnë më vonë, edhe përkundër faktit se ishte një komandant dhe admiral shumë i zoti. Pas marrjes së kështjellës së Otrantos ai u kthye në Vlorë pasi la një garnizon në mbrotje të qytetit të sapopushtuar. Pas kthimit në Vlorë ai po planifikonte të rikthehej sërish në Pulja për të vazhduar fushatën e tij për shtrirjen e sanxhakut të Vlorës mbi krejt zonën e Puljas. Mirëpo vdekja e Mehmetit II më 3 maj 1481 e ndryshoi situatën. Bajaziti II ndryshe nga paraardhësi i tij Mehmeti II nuk ishte për një angazhim të theksuar në perëndim. Vdekja e Mehmetit II do të pasohej me një luftë civile mes dy djemve të tij Bajazitit II dhe Xhemit. Otranto u rimor nga Duka i Kalabrisë Alfonso më 10 shtator 1481. Pra sundimi Osman në Otranto zgjati vetëm 13 muaj.

Gedik Pasha u kthye në Stamboll dhe mbështeti anën e Bajazitit në luftën për pushtet mes dy trashëgimtarëve të Mehmetit II. Në krye të forcave të Bajazitit, Gedik Pasha i mundi forcat e Xhemit në Jenishehir më 20 qershor 1481, duke i bërë të mundur Bajazitit II të marrë fronin. Nuk do vonojë shumë dhe për shkak të intrigave të oborrit sulltanor, admirali, gjenerali, sanxhakbeu dhe kryeministri i periudhës së Mehmetit II do të burgosej dhe ekzekutohej nga sulltani i ri Bajaziti II më 18 nëntor 1982 në Edirne. Arsyja e prishjes së tij me Bajazitin II kishte të bënte si duket me ndonjë manovër të tij për të lejuar largimin e Xhemit nga fushëbeteja në Jenishehir. Të dhënat që japin dokumentet e kohës dëshmojnë për një prirje të theksuar të tij për të ndërmarrë veprime të pakonsultuara ose madje edhe në kundërshtim me urdhrat sulltanorë. Kjo kryeneçësi e ndërthurur me ambicien e tij të dukshme dhe me aftësinë për të thurur intriga duket se sollën fundin e tij. Është kryeministri i parë shqiptar i ekzekutuar nga sulltanët.

9. *The History of the Maritime Wars of the Turks*. Translated from the Turkish of Haji Khalifeh by James Mitchell, London, 1831, f. 17.

PËRFUNDIMI I ATYRE QË NUK JAPIN ZEKATIN



— M. Sami Ramazanollu —

Ebu Hurejre (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Shembulli i koprracit dhe i bujarit që jep, është si këta dy persona: Trupi i këtyre është i mbështjellë me rrobe hekuri në shpinë dhe në gjoks deri në klavikulë. Atij që jep me bujari, sapo jep ndonjë sadaka, i zgjerohet ajo rrobë e hekurt në trup, zgjatet poshtë dhe ia mbulon gjithë trupin. Madje, ajo i mbulon edhe gishtat e tij të këmbëve. Përveç kësaj, majat e asaj rrobe zvarriten në tokë dhe mbulon gjurmët e këmbëve të atij që jep sadaka. Ndërsa koprracit, i cili nuk dëshiron të jap fare sadaka, i ngushtohet menjëherë ajo rrobë në trup duke ia shtrënguar fort gjithë trupin. Koprraci përpiqet ta zgjerojë këtë rrobë, por nuk ka fuqi.” (Buhari, Zekat, 712.)

Në këtë hadith fisnik, është dhënë një shembull që tregon gjendjet shpirtërore të bujarit dhe të koprracit. Kur bujari vrapon në ndihmë të një nevojtarit që ndodhet në vështirësi, shpirtin dhe zemrën e tij e pushton një qetësi dhe paqe e cila përhapet në të gjithë trupin. Ndërsa tek ai që është koprrac, për shkak se nuk i ndihmon nevojtarët, si pasojë e zemrës së tij të ngurtë, në zemrën e tij shfaqet një vuajtje dhe vështirësi e madhe. Dhe, kjo vuajtje e zemrës ia pushton gjithë trupin që prej kokës deri tek këmbët. Kështu që, ai nuk arrin t'i shkojë në ndihmë një të varfri dhe të shpëtojë zemrën dhe shpirtin e vet prej vuajtjes.

Ebu Mes'ud el-Ensari (r.a.), ka thënë: *“Kur zbriti ajeti i sadakasë, pra, **“Merr lëmoshë nga pasuria e tyre (të pasurve)!..”**¹ dhe i Dërguari i Allahut (a.s.), na urdhëroi me dhënien e sadakasë, ata prej nesh që nuk kishin mundësi për të dhënë, shkonin në treg dhe duke bartur ngarkesa me pagesë, fitonin dy grusht hurma dhe jepnin sadaka prej fitimit hallall. Ndërsa sot, disa prej tyre kanë pasuri me qindra mijëra.”*

Uakidi, thotë se ai që jepte sadaka më shumë me para, ishte Abdurrahman bin Aufi (r.a.). Kur i Dërguari i Allahut (a.s.), i nxiti sahabët e tij të japin sadaka dhe zekat, Abdurrahman bin Aufi (r.a.), dhuroi katër mijë derhem, që ishte gjysma e pasurisë së tij prej tetë mijë derhemësh. Më pas tha: *“O i Dërguar i Allahut! Ja ku e solla gjysmën e pasurisë dhe po ia jap borxh Allahut. Ndërsa gjysmën tjetër e ndava për familjen time.”*

I Dërguari i Allahut (a.s.), u lut duke thënë: *“Allahut të dhënë begati në pasurinë që dhurove dhe në atë që ndave (për familjen)!”* Në sajë të begatisë së kësaj lutje të Profetit (a.s.), pasuria e Abdurrahman bin Auf (r.a.), u shtua edhe më shumë. Madje, pas vdekjes së tij, familjes së tij i mbeti trashëgimi një pasuri që e kalonte milionin.

Ebu Hurejre (r.a.), tregon:

Njëherë tek i Dërguari i Allahut (a.s.), erdhi një person (Ebu Dherri) dhe e pyeti: *“O i Dërguari i Allahut! Cila sadaka është më e madhe në aspektin e shpërblimit?”* Profeti (a.s.), tha:

“Sadakaja me sevapin më të madh, është ajo që jep ndërkohë që je shumë koprrac, ke frikë nga varfëria dhe të pëlqen shumë pasuria. Mos e shty sadakanë tënde duke pritur të të vijë shpirti në fyt e pastaj të thuash, kjo pasuri është për filanin, e kjo për filanin, sepse më shumë se një e treta e pasurisë tënde është e trashëgimtarëve. Vetëm trashëgimia prej një të tretës së pasurisë është e pranueshme!”

“Ruajeni pasurinë tuaj duke dhënë zekatin, shëroni të sëmurët tuaj duke ju dhuruar të varfërve dhe zbrapseni fatkeqësinë dhe belanë me lutje dhe përgjërime!”

“Kush ia jep zekatin e pasurisë atij që nuk e meriton zekatin, konsiderohet se nuk e ka dhënë atë!”

1. Teube, 103.



Sinqeriteti dhe qëllimi i mirë

— Sadik Dana —

Allahu i Madhëruar urdhëron:

“...E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të sinqertë, duke qenë në fenë e pastër!..” (Bejjine, 5)

“Vetëm Allahut i takon adhurimi i vërtetë!..” (Zumer, 3)

Ndërsa i Dërguari bujar i Allahut, (a.s.), në një hadith kudsî ka thënë: *“Allahu i Madhëruar urdhëron: «Ihlasi/sinqeriteti është një prej sekreteve të Mia. Dhe Unë e vendos atë në zemrën e robit që e dua!»”*

Transmetohet se Ahmed ibn Hadrauejh ka parë një ëndërr në të cilën Allahu i Madhëruar thotë: *“Të gjithë njerëzit kërkojnë prej Meje, por vetëm Ebu Jezidi më kërkon Mua!”*

Dikush e pa në ëndërr imam Shibliin pasi vdiq dhe e pyeti: *“Çfarë bëri Allahu me ty?”* Ai u përgjigj: *“Ai u zemërua pak me mua, sepse njëherë kam thënë: «E çfarë humbjeje më të madhe mund të ketë, se humbja e Xhenetit!?»”* Më pas tha:

“Unë duhej të thosha: «E çfarë humbjeje më të madhe mund të ketë, se humbja e shikimit Tënd (Të Allahut)»”

Qëllimi është më i rëndësishëm se vepra.

Qëllimi është më i rëndësishëm se vepra. Qëllimi i dikujt në devotshmëri mund të jetë frika nga Xhehenemi ose arritja e mirësive të Xhenetit. Ata që e adhurojnë Allahun për mirësitë e Xhenetit, mund të bëhen lehtë robër të mirësive të kësaj bote. Ndërsa ata që bëjnë vepra të mira nga frika e Xhehenemit, janë si një skllav i keq, i cili punon vetëm nga frika. Të dy këta nuk konsiderohen se veprojnë për hir të Allahut. Rob i pëlqyer, është ai që nuk i bën punët për shkak të Xhenetit apo Xhehenemit, por për hir të Allahut. Kjo, i ngjan dikujt që i shërben njeriut të tij të dashur për shkak se e do, jo për shkak se pret ndonjë shpërblim prej tij. Ai që i shërben duke pritur shpërblim, ka për qëllim shpërblimin. Prandaj, ata që duan dhe janë të dashuruar pas bukurisë së Allahut të Madhëruar, nuk veprojnë me këtë qëllim. Adhurimi i një njeriu të tillë është meditim mbi bukurinë e Allahut të Madhëruar dhe përgjërëm ndaj Tij. Në të vërtetë këta janë miqtë e Allahut.

Detyrat e devotshmërisë sonë, duhet t'i bëjmë për hir të Allahut Dhulxhelal. Në punët që bëhen me qëllime të tjera, nuk ka mirësi. Nëse adhurimi bëhet për Allahun e Madhëruar, ka shumë vlerë. Por nëse bëhet për hatër të të tjerëve ose për të arritur një mirësi, kjo bëhet shkak i zemërimit të Allahut dhe, këto vepra, që në pamje të jashtme duken të përsosura, mund të bëhen edhe shkak që i zoti të shkojë në Xhehenem.

Me çfarëdo qëllimi të bëhen adhurimet, shpërblimi i tyre do të jetë në bazë të sinqeritetit dhe qëllimit. Ata që i kryejnë detyrat e tyre me qëllim të pastër, do të arrijnë edhe mirësitë e kësaj bote, edhe ato të botës tjetër. Ata që nuk janë të sinqertë në qëllimet e tyre, do të pësojnë disfatë për shkak të mungesës së sinqeritetit.

Allahu i Madhëruar, ashtu siç i shpërblen robërit e Tij për adhurimet e bëra në mënyrë të përsosur dhe me sinqeritet, ashtu i shpërblen edhe qëllimet e pastra që robërit e Tij ushqejnë në zemrat e tyre. Elhamdulillah!..

Sa lumturi e madhe është ta duash Allahun e Madhëruar, të ushqesh mendim të mirë për Të dhe t'i dorëzohesh Atij plotësisht! Po kështu, edhe dashuria dhe mendimi i mirë që ushqehet ndaj të Dërguarit të Tij bujar (a.s.) dhe sahabëve -radijallahu anhum-, është një mirësi e madhe e Zotit tonë. Gjithashtu, e tillë është edhe dashuria dhe respekti për miqtë e Allahut, dijetarët dhe njerëzit e mirë.

Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Unë jam në konsideratën e robit Tim!”

Një gjynahqar që shpreson faljen e Allahut dhe ka konsideratë të mirë për Të, është më i afërt me Zotin se sa i devotshmi që bie në pesimizëm dhe e humb shpresën prej Tij.

Një prej kurtheve të shejtanit, është edhe përpjekja e tij e vazhdueshme për ta bërë besimtarin të pashpresë duke i dhënë vesvese zemrës së tij. I Dërguari i Allahut (a.s.), thotë:

“Allahu i Madhëruar e ka ndarë mëshirën në njëqind pjesë. Nëntëdhjetenëntë pjesë i mbajti për Vete, ndërsa një pjesë e zbriti në tokë. Në sajë të kësaj mëshire, të gjitha krijesat në tokë e mëshirojnë njëra-tjetrën. Madje, edhe kur pela e ngre këmbën nga frika se mos e lëndon mëzin e saj, është për shkak të kësaj mëshire.” (Buhari, Kitabu'l-Edeb.)



Duhet menduar THELLË

— Idris Arpat —

Duhet menduar thellë dhe seriozisht!..

Mbase kjo çështje nuk është edhe aq e preferuar në këtë kohë kur sipërfaqësorja e ka pushtuar gjithë botën si një tumor, por nuk ka asnjë mënyrë tjetër për të zgjidhur problemet tona.

Duhet menduar thellë! Kjo është ajo që duhet të bëjmë, nëse nuk duam ta mashtrojmë veten, duke marrë masa thjesht për fashim, apo të hyjmë në gjynah duke mashtruar ata që na dëgjojnë.

“Çështjet që nuk zgjidhen në teori, nuk mund të zgjidhen as në praktikë”. Imagjinata është më e rëndësishme dhe më parësore se sa mendimi. Çdo gjë e bukur fillon në imagjinatë. Prandaj edhe është thënë: “Vazhdo të shohësh një ëndërr që do t’i shuajë të gjitha dhimbjet e kësaj bote!” Vazhdo, që nivelin ta mbash të lartë dhe horizontin të gjerë. Kur Krijuesi i Madhëruar ka thënë: **“U thuaj robërve të Mi të flasin atë që është me e bukura!”**¹, e ka mbajtur lart nivelin e synimit. Ai ka dashur që “myslimanët të shkruajnë veprat që do të ndikojnë në qiell dhe në tokë!”. Të shkruash diçka të pavlerë me pakëz lexim dhe pakëz mendim, nuk tregon arritje në aspektin kulturor të njeriut.

Duhet menduar se pse janë krijuar qiejt dhe toka dhe cili është qëllimi i krijimit të çdo krijese në gjithësi! *“Ndonjëherë hidhja sytë një gjëje që nuk është bërë nga dora e njeriut... një mali, një ylli, valëve të një lumi që rrjedh... Atëherë do të mësosh se çfarë është dija dhe durimi. Madje edhe më tepër... se nuk je vetëm në këtë botë!”* (Sidnej Lovett)

Kuptimi i të qenit njeri duhet të mendohet shumë thellë. Ky është misioni ynë kryesor si myslimanë. Duhet menduar thellë sekretin dhe hapësira që përfshin shprehja, “li ja’budun / për të adhuruar”. Pranë saj duhet vendosur edhe kuptimi i fjalës “ihsan”², e më pas të mendohet edhe njëherë më seriozisht. Përse Allahu i Madhëruar, i Cili nuk ka nevojë për asgjë, e pa të nevojshme të na krijojë? A mos mendoj vallë që ne “ta perceptojmë/kuptojmë dhe ta

madhërojmë”?

Jo jo, çështja nuk mbaron me marrjen e abdestit dhe faljen e namazit. Përkundrazi mendoj se sapo ka filluar. Ajo që “është dhe duhet të jetë”, duhet menduar shumë thellë. Ditën kur të kuptojmë dallimin ndërmjet “asaj që është dhe asaj që duhet të jetë”, do të jetë një ditë e madhe.

Duhet menduar thellë se çfarë kuptimi ka “të punosh për Allahun”. Duhet menduar thellë “bota e vërtetë”. Duhet menduar thellë gjendja për të ardhur keq e umetit të Muhammedit (a.s.). Duhet menduar seriozisht deklarata hyjnore, **“...Ju gjithsesi jeni më të lartët, nëse jeni besimtarë të vërtetët!”**³, duke parë edhe realitetin.

Duhet menduar, pse toka nuk di të ngopet me gjakun e myslimanëve. Produkt i cilit edukim dhe kurthi janë ata që pandehin se xhihad është të presësh koka duke thënë “Allahu Ekber”. Duhet menduar, pse nuk po arrihet të ndërtohet një botë me qendër drejtësinë. Ku kanë mbetur mbrojtësit e drejtësisë? Nuk duhen marrë parasysh fjalët e shumta dhe thëniet e ekzagjeruara.

Duhet menduar shumë thellë, se ku i kanë kokat dy miliardë myslimanë? Përse koka e tyre është tek këmbët dhe këmbët e tyre tek koka? Thonë se “kush s’ka mend, ka këmbë”.

Duhet menduar, përse mendja e myslimanit nuk prodhon dije, mendime dhe shkencë. Përse dy miliardë myslimanë nuk po i ofrojnë dot botës asgjë? Duhet menduar përsëri e përsëri dhe më seriozisht, përse Libri ynë Madhështor nuk po na bën neve madhështorë. Duhet menduar, mësuar dhe thënë me zë të lartë pikë-thyerjet e historisë, kush janë të thyerit dhe pse janë thyer.

Duhet menduar thellë vdekja dhe përtej saj.

*“Sot përsëri për vdekjen shumë mendova
Sikur në varr hyra dhe nën borë u ftoha”*

Kur vdekja flet, çdo gjë hesht. Duhet heshtur dhe duhet menduar për vdekjen. Nëse do të vdesim, përse vallë kemi lindur?

Nëse nuk do të mendojmë, atëherë do të vazhdojmë të vijmë vërdallë brenda një rrethi vicioz.

1. Isra, 53.

2. Ihsan: të bësh diçka (një adhurim apo mirësi), me vetëdijen se je para Allahut.

3. Al-i Imran, 139.



NJË VEND KU NUK JU SHEH DOT ASKUSH

Një mësues e donte dhe e vlerësonte më shumë se të tjerët njërin prej nxënësve ngaqë ishte shumë më punëtor, i zgjuar dhe i kuptueshëm. Kjo dashuri dhe vlerësim i mësuesit dihej edhe nga nxënësit. Për këtë arsye, xhelozonin së tepërmi. Ata thoshin me njëri-tjetrin: “Përse mësuesi do më shumë këtë shokun tonë? A vetëm ai është i zgjuar dhe punëtor ndërmjet nesh?” Edhe mësuesi ishte i vetëdijshëm për këto mendime të atyre. Një ditë kur mësuesi shkoi në mësim, solli me vete zogj aq sa numri i nxënësve. Çdo nxënësi i dha nga një dhe të gjithëve u tha: “Merrini këta zogj dhe therini në një vend ku nuk ju sheh askush! Edhe një herë kujdes! Në një vend ku nuk ju sheh askush.” Nisur nga kjo, nxënësit u shpërndanë sa majtas-djathtas. Pas pak kohe i therën zogjtë dhe filluan të ktheheshin.

Disa prej tyre lavdëroheshin: “Unë e thera në filan vend. Askush nuk më pa.” Edhe mësuesi u buzëqeshte atyre që lavdëroheshin në këtë mënyrë. Pas pak të gjithë nxënësit u kthyen me zogj të therur. Më në fund erdhi nxënësi që e donte mësuesi. Mbi të gjitha, edhe zogun nuk e kishte therur. Mësuesi e pyeti:

-Bir, përse nuk e there zogun? Shiko, të gjithë shokët e tu i kanë therur. Mos vallë nuk gjete ndonjë vend ku nuk të shihte dot askush?

-Një vend ku nuk mund të më shikonin njerëzit mund ta gjeja, por një vend ku nuk mund të më shihte Allahu nuk e gjeta dot. Për këtë arsye, u ktheva pa e therur zogun.

Kjo përgjigje ua solli mendtë në kokën nxënësve të tjerë. Të gjithë e dinin se nuk ka vend që nuk mund ta shohë Allahu, por e rëndësishme është të menduarit e kësaj. Pas kësaj ngjarjeje e kuptuan ndryshimin e shokut të tyre dhe i dhanë të drejtë mësuesit për interesimin që shfaqte ndaj tij.

NJË THËNIE

“Largohu nga injoranti që flet sa për dhjetë vetë! Kur të flasësh, fol një herë dhe me pjekuri si të diturit!”

(Sadi Shirazi)


NJË LUTJE

“O Zot! Na e begato muajin Rexhep e Shaban dhe na e mundëso ta arrijmë muajin e Ramazanit!”

(Taberani, el-Muxchemu'l-Evsat, IV, 189.)

FAKTE INTERESANTE

- Xhamia më me aromë në botë gjendet në qytetin Tebriz. Kur është ndërtuar xhamia, llaçit i është hedhur ujë me aromë misku. Edhe pse kanë kaluar 600 vjet, xhamia akoma mbanë aromë misku.
- Në alfabetin e Havait gjenden vetëm 12 shkronja.
- Njeriu gogësin për të marrë më shumë oksigjen dhe për të nxjerrë dioksidin e karbonit që ka në trup.



Kun

fati, kultura, trashëgimia

— Xhihan Tashtan —

Profesionet që kemi zgjedhur mund të na bëhen barrë. Mbase ne kemi mundësi që të jemi më të dobishëm për fenë dhe shoqërinë tonë, por ngecim në një qark të mbyllur. Për këto arsye, çdo njeri kalon nga një “Udhëtim kun (i plotësimit)”

Ekziston një fjalë e vjetër: “Isha i pabërë... U poqa... U dogja...” Kjo na tregon neve se njeriu duhet të jetë gjithmonë në proces kërkimi, ai duhet të mundohet që të gjejë veten. Përpara se të thotë: “U bëra!”, le të mendojë pak për natyrën e urdhrit: “Kun!/Bëhu!”... Në çdo moment të jetës sonë duhet t’i shtrojmë vetes një pyetje shumë esenciale: “Çfarë kërkon Allahu nga unë?”... Në këtë mënyrë do të kuptojmë talentet tona dhe do të kemi mundësi që të realizojmë kaderin më të bukur të jetës sonë.

Fillimi i rrugëtimit tonë le të jetë momenti i parë në mitrën e nënës. Në mesin e miliarda njerëzve, ata ishin dy individët që u bënë shkak për ardhjen tonë në jetë dhe si të tillë kanë rëndësi shumë të madhe në kaderin tonë. Pra, mund të themi se trashëgimia luan një rol shumë të rëndësishëm në përbërjen e brumit tonë. Le të pyesim veten: “Kush jam unë? Përse jam krijuar? Cilat veçori më janë dhënë?” Përgjigjet e këtyre pyetjeve do të na ndihmojnë të zbulojmë veten, në mënyrë që të japim më të mirën e mundshme.

Tani le të ndjekim “Udhëtimin e plotësimit” të Prof. Dr. Fuat Sezgin... Ai lindi në Bitlis të Turqisë. Studimet i kreu në Stamboll. Jeta e tij ndryshoi në kohën e grushtit të shtetit të vitit 1960, kur u detyrua të syrgjynosej. Zgjuarsia e trashëguar dhe vendosmëria e ndihmuan që të ecte përpara edhe pas kësaj goditjeje të fortë. Fuat Sezgini, që fitoi shumë çmime internacionale gjatë jetës së tij, punimet e jetës së tij 60- vjeçare i mblodhi në veprën me titull: “Shkenca dhe teknika në Islam”. Një libër që përbëhet prej 13 vëllimesh.

Prof. dr. Abdus Salam, i lindur në Pakistan, është një prej myslimanëve më të shquar në botën e shkencës moderne. Në vitin 1979 ai fitoi çmimin Nobel në Fizikë së bashku me Weinberg dhe Glashow me motivacionin e provimit matematikor të bashkimit të dy prej forcave përgjegjëse për krijimin e universit, asaj elektromagnetike dhe forcave (nukleare) të dobëta. “Udhëtimin e plotësimit” ai nuk e bëri vetëm me mendje, por edhe me besim. Në një prej fjalimeve të tij Dr. Abdus Salam tha: “Islami është feja e teuhidit/monoteizmit. Ashtu si në fe, edhe në aftësitë njerëzore ka teuhidi efal (të gjitha sjelljet dhe qetësia i takojnë Allahut), teuhidi sifat (jeta, dija, shikimi, dëgjimi, fuqia, arsyeja gjenden tek njeriu, por formën e përkryer të tyre e zotëron vetëm Allahu) dhe teuhidi Zat (ekzistenca është

e Allahut). Përse edhe të gjitha sendet të mos jenë një?” Me këtë ai dëshiron të bëjë lidhjen me njësinë e katër forcave bazë të natyrës.

Një njeri tjetër që ka pasur një “udhëtim të plotësimit” për t’u marrë shembull është edhe Prof. Dr. Oktaj Sinanollu, që quhet ndryshe si “Ajshtajni i Turqisë”. Kur ishte vetëm 28 vjeç ai mori titullin “Profesori më i ri” në universitetin e Jalës. Dr. Sinanollu ka qenë disa here kandidat për çmimin Nobel si pasojë e punimeve të tij në kiminë e kuantëve, në kiminë teorike dhe biologjinë molekulare. Një fjali e vetme e një prej fjalimeve të tij të fundit, na flet qartë për “udhëtimin e tij të plotësimit”: “Unë jam një kallam bosh. Allahu fryn, e prej meje del zë...”

Profesionet që i kemi zgjedhur si pasojë e kushteve të jetës ose të shtyrë nga njerëzit e tjerë, mund të jenë barrë për ne. Mbase ne kemi mundësi që të jemi më të dobishëm për fenë dhe shoqërinë tonë, por ngecim në një qark të mbyllur. Për këto arsye, çdo njeri duhet të kalojë nga “Udhëtimi kun (i plotësimit)”. Le të fokusohemi në trashëgiminë (cilësi që e kemi fituar nga lindja) dhe kulturën tonë (mundësitë dhe kufijtë që na servir realiteti ku jetojmë), të bëjmë planet e të ardhmes dhe të kapim shanset më të mira për t’i realizuar këto plane, në mënyrë që ta përsosin udhëtimin tonë të plotësimit. Mos të harrojmë se ne kemi në dorë zgjedhjen e fundit të udhëtimit tonë... Ne e vendosim se si do jetë gjendja jonë e fundit; e pabërë, e pjekur apo e djegur.



“VËLLAI” I MADH I TOKËS: JUPITERI

— Muaz Erdem —

Vëllai ynë i madh e mori emrin nga Mitologjia Greke dhe nga një prej perëndive të Romës së lashtë. Ai quhet Jupiter. Përmasat e tij gjigande e lejojnë që të shikohet me sy të lirë prandaj ai është vëzhguar që në kohët e lashta. Ndërkohë brezat dhe katër satelitët e tij u shikuan për herë të parë nga Galileo Galilei (1610).

Jupiteri që është një gjigand gazrash, është i pesti në renditjen e bazuar sipas largësisë prej Diellit ndërsa për nga madhësia ai është i pari. Përbërja e tij prej gazi e bën të pamundur shkeljen në sipërfaqen e tij. Jupiteri mund të përfshijë plot 1321 Toka dhe masa e tij është 318 herë më e madhe se masa e planetit tonë blu. Duke qenë planeti më i madh i Sistemit Tonë Diellor ai na mbron ndaj gurëve të rrezikshëm dhe tërheq drejt vetes të gjithë gurët e mëdhenj, duke i kryer më së miri detyrat e tij. Ndryshe prej planetit tonë që ka vetëm një satelit natyror (Hënën), vëllai i madh ka plot 63 të tillë. E di që është e vështirë për t’u besuar por ky planet gjigand lëviz me një shpejtësi prej 47.001 km/orë! Kjo është vetëm një shenjë tjetër e madhështisë së Allahut!

Nëse keni dëshirë që të shikoni Jupiterin, do ta keni shumë të lehtë. Mjafton një natë me qiell të pastër dhe pak pas perëndimit të diellit drejtoni sytë nga jugu. Nuk ka nevojë që ta kërkonit atë derisa ta ndjeni qafën e mpirë sepse Jupiteri me madhësinë e tij do ta nxjerrë veten në pah. Nëse keni një dylbi me zmadhim 15x do të mund të shikoni edhe 4 satelitët e tij më të mëdhenj. Vetëm duhet të keni parasysh se të gjitha këto janë të vlefshme deri nga mesi i janarit. Pas asaj periudhe Jupiteri qëndron në qiell gjatë ditës prandaj nuk shikohet dot.

*"Xhindët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm
që të Më adhurojnë."*

(Dharijat, 56)

Ky ajet, edhe pse shumë i shkurtër, përfshin një të vërtetë të madhe, pa të kuptuarit mirë të së cilës nuk mund të ndërtohet një jetë normale dhe e qëndrueshme në botë, në rrafshin individual apo social.

Kjo e vërtetë e madhe përfshin shumë dimensione, një prej tyre është se krijimi i xhindeve dhe njerëzve është për një qëllim të caktuar. Ky qëllim shfaqet si detyrë për krijesat e përmendura, të cilat, nëse e kryejnë, kanë realizuar qëllimin e krijimit të tyre. Kush nuk e kryen këtë detyrë, ka humbur qëllimin dhe kuptimin e vërtetë të jetës.

Kjo detyrë e caktuar që i jep kuptim ekzistencës së njeriut në tokë është ibadeti ndaj Allahut, në këtë mënyrë na shfaqet një Zot i vetëm ndaj të cilit bëhet ibadet dhe njeriu i cili bën ibadet. Vetëm nëse bazohet në këtë parim merr kuptim jeta e njeriut në tokë.

Këtu na shfaqet përmasa tjetër e kësaj të vërtete të madhe, që ibadeti nuk është thjesht kryerja e disa ritualeve të caktuara, por është shumë më gjithëpërfshirës. Sepse as njerëzit, as xhindët nuk e kalojnë gjithë kohën duke bërë rituale. Allahu i ka obliguar njerëzit dhe xhindet, përveç këtyre ritualeve, edhe me një sërë veprimtarish që përfshijnë pjesën më të madhe të jetës së tyre. Ne nuk e dimë se çfarë veprimtarish të tjera u ka ngarkuar Allahu xhindeve, por dimë kufirin dhe formën e veprimtarive që kërkohet prej nesh dhe këtë e mësojmë nga fjala e Allahut në Kuran, ku shprehet: **"Unë do të caktoj një përfaqësues në tokë."** (Bekare, 30)

Pra, ajo që kërkohet nga njeriu është përfaqësimi me dinjitet i vullnetit të Allahut në tokë. Kjo arrihet duke respektuar ligjet e vendosura nga ana e Allahut, duke mos prishur ekuilibrin e vendosur të sistemit. Nga gjithë kjo nxjerrim që ibadeti, i cili është qëllimi kryesor i krijimit të njeriut, nuk është thjesht kryerja e disa riteve, por përfshin edhe detyrën e përfaqësimit të vullnetit të Allahut. Kështu, esenca e ibadetit përbëhet nga dy komponentë kryesorë.

1- Ndërgjegjësimi i plotë i njeriut se e vetmja qenie që meriton të adhurohet është vetëm Allahu.

2- Ibadet është çdo vepër që buron nga ndërgjegjja, çdo lëvizje e organeve dhe çdo sjellje në jetën e njeriut që i kushtohet Allahut dhe që është në funksion të përmbushjes së detyrës së përfaqësimit të vullnetit të Allahut në tokë, në formën më të mirë si dhe zhveshja e plotë nga çdo ndjenjë që është jashtë motivit të kësaj.

Vetëm me këta dy komponentë, ibadeti merr kuptimin e vërtetë dhe çdo vepër fiton vlerën e ritit fetar. Me plotësimin e këtyre komponentëve realizohet edhe misioni për të cilin ai është krijuar. Në këtë mënyrë, njeriu jeton me ndjenjën se është krijuar për të kryer detyrën që i është ngarkuar. Një tjetër veçori e ibadetit është se nuk vlerësohet sipas përfundimeve, por sipas punës që kryen, sepse ai e kryen çdo vepër me qëllimin e ibadetit. Përderisa vepra kryhet me qëllim ibadeti, suksesi është i garantuar, sidoqoftë përfundimi i saj.

Resulullahi (sal-lallahu alejhi ve sel-lem) ka thënë:

*“Kije frikë Allahun kudo që të jesh!
Veprën e keqe pasoje me të mirë që të fshijë
të keqen dhe sillu mirë me njerëzit.”*

(Buhari)

NJOHJA ME TRANSMETUESIN

Ebu Dherr ibn Xhunade është nga fisi Gifari. I pesti që ka pranuar Islam. I njohur për asketizmin, thjesh-tësinë dhe devotshmërinë e tij. Profeti (alejhis- selam), e ka konsideruar si “mesihu i islamit”.

Ky hadith përfshin tre parime esen- ciale të çdo myslimani: marrëdhënien e tij në raport me Zotin, me vetveten dhe në raport me shoqërinë.

E para dhe më e rëndësishmja është marrëdhënia me Allahun. Vetëm në- përmjet saj mund të arrihen dy të tje- rat. Shprehja “Kije frikë Allahun kudo që të jesh”, do të thotë që ta ndjesh praninë e Allahut në çdo kohë dhe në çdo vend. Myslmani duhet ta ndjejë mbikëqyrjen e Allahut, jo vetëm në xhami gjatë kryerjes së ritualeve, por në çdo veprimtari të jetës së tij. “Ki frikë Allahun kudo që të jesh!” nën- kupton: Vepra të gjitha urdhrat dhe largohu nga të gjitha të ndaluarat. Bëje devotshmërinë, mënyrën tënde të jetesës. Vendose atë në zemër dhe praktikoje në çdo fushë të jetës. Alla- hu ua ka këshilluar devotshmërinë të gjithë popujve, kur shprehet në ajetin kuranor: “**Ne u patëm sugjeruar atyre të cilëve u qe dhënë libri para jush e, edhe juve, që të keni frikë nga Alla- hu.**” (Nisa, 131)

E dyta është marrëdhënia e njeriut me vetveten, ku Muhamedi (a.s.), na këshillon që veprimin e keq ta pa- sojmë me të mirë dhe të pendo-

hemi për veprën e keqe. Njeriu nuk është qenie e pagabueshme. Muhame- di (a.s.), duke qenë i vetëdijshëm për natyrën e njeriut, na ka treguar rrugën e përmirësimit, shërimit nga veset e këqija. Argument për këtë është edhe ajeti kuranor: “**Dhe kryeje namazin në mëngjes dhe mbrëmje dhe në një kohë të natës. Me të vërtetë veprat e mira i shlyejnë veprat e këqija. Kjo këshillë vlen për ata që i pranojnë këshillat.**”

E treta është sjellja e mirë me nje- rëzit në përgjithësi, pa dallim race, kombësie apo feje. Sjellja e mirë mund të shfaqet në forma të ndryshme, si fjala e butë, toleranca, falja, mirëkup- timi, bujaria, respekti ndaj të tjerëve etj. Është sjellja e mirë që na siguron krijimin e marrëdhënieve normale me njëri-tjetrin. Nëpërmjet kësaj mund të kultivohen dashuria dhe respekti për njëri-tjetrin. Sjellja e mirë është shtylla kryesore për të ndërtuar një shoqëri të shëndoshë.

MËSIMET QË NXJERRIM NGA HADITHI:

1. Veprat e mira i fshijnë veprat e këqija.
2. Është detyrë e çdo myslimani të sillat mirë me të gjithë njerëzit.
3. Devocioni është një mburojë që e mbron myslimanin nga çdo lloj vesi.
4. Allahu na shikon dhe na vëzhgon në çdo moment dhe në çdo situatë.

Një Hadith



NJË RAMAZAN SA PËR TË GJITHË JETËN



Falënderimet e pafundme i takojnë Allahut të Madhëruar, që na e zbukuroi përsëri kalendarin e jetës, neve robërve të Tij të dobët, me Ramazanin e Bekuar, në të cilin vërvon falja dhe mëshira hyjnore. Ai Ramazan i Bekuar brenda të cilit gjendet thesari shpirtëror i Natës së Kadrit, e cila ka vlerën e një jete të tërë...

Mirëpo, pjesën më të madhe të ditëve dhe netëve të këtij muaji të çmuar e lamë pas. Tashmë, na ka mbetur veçse pak kohë. Lum ata besimtarë që në këto ditë të bekuara përpiqen:

- Të falin namazet me xhemat, pra me një kujdes më të veçantë dhe me përkushtim të thellë.
- Të marrin pjesë në leximet e përbashkëta të Kuranit me frymëzim shpirtëror.
- Të ngrihen shpirtërisht me agjërim dhe të arrijnë devotshmërinë.
- Të fitojnë përshpirtjen e muzgut të mëngjesit me syfyr.

- Të afrohen me Allahun me anë të zekatit, sadakasë së fitrit dhe dhurimeve.

- Dhe në fund të dalin të pastruar shpirtërisht nga ky muaj i faljes.

Sado që të falënderojmë Zotin tonë, i Cili na fali këtë muaj të bekuar, është shumë pak!..

Allahu i Madhëruar urdhëron:

“...Nëse tregoheni mirënjohës, Unë do t’ju shtoj edhe më shumë begatitë e Mia!..” (Ibrahim, 7) Duke u nisur nga ky ajet fisnik, falënderimi/mirënjohja bëhet shkak i begatimit të mirësive. Për rrjedhojë, për të arritur edhe begatinë e mirësisë së Ramazanit, nuk duhet të neglizhojmë asnjë lloj falënderimi, qoftë me fjalë, e qoftë me vepra.

Për këtë arsye, vlerat shpirtërore që fitojmë në atmosferën frymëzuese të Ramazanit të bekuar dhe që na edukojnë shpirtat, nuk duhet t’i humbasim pas Ramazanit. Nëse arrijmë që ato që kemi fituar prej Ramazanit t’i shpërndajmë në jetën tonë për



gjatë gjithë vitit, kjo do të jetë shprehja më e bukur e falënderimit ndaj Zotit tonë.

DEVOTSHMËRI DERI NË FRYMËN E FUNDIT

Të mos harrojmë se, jeta Islame, fetaria dhe devotshmëria, nuk janë të posaçme vetëm për muajin e Ramazanit apo për një sezon të përkohshëm. Këto, janë vlera jashtëzakonisht jetike, të cilat një besimtar duhet t'i mbajë mbi krye gjatë gjithë jetës.

Allahu i Madhëruar, na urdhëron që ta adhurojmë Atë jo vetëm në Ramazan, por gjatë gjithë jetës. Në ajetin fisnik urdhërohet:

“Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!” (Hixhr, 99)

Vendimi hyjnor në lidhje me njeriun, merr për bazë frymën e fundit. Dhe, për ta dhënë frymën e fundit me besim, është e domosdoshme që gjithë jetën ta jetojmë me një pjekuri shpirtërore të tillë, që të jemi përherë midis frikës, që të mos meritojmë zemërimin hyjnor dhe shpresës për të fituar mëshirën hyjnore.

Zoti ynë urdhëron:

“O besimtarë! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!” (Al-i Imran, 102)

Për të arritur të japim frymën si mysliman, nuk ka zgjidhje tjetër përveçse të vazhdojmë adhurimin ndaj Allahut pa u kapluar për asnjë çast nga indiferenca dhe veset e egos. Lidhur me këtë, me qëllim që të na bëhet shembull, i Dërguari i Allahut (a.s.), e ka lutur Allahun e Madhëruar me këto fjalë:

“O Zot! Mos më lërë në dorë të vetes sime, qoftë edhe sa hap e mbyll sytë!” (Sujuti, Xhamiu's-Sag'ir, v. I, fq. 58.)

Allahu i Madhëruar, ashtu siç e ka fshehur Natën e Kadrit brenda një viti, ashtu e ka fshehur në kohë edhe se kur do ta shfaqë kënaqësinë apo zemërimin e Tij. Me këtë, Ai ka dashur që ne të përpiqemi gjithmonë për punë të mira dhe të ruhemi nga gjynahet. Kjo, sepse ka momente që mund të bëhen shkak i fitimeve të mëdha, por ka edhe momente që bëhen shkak për humbje të mëdha.

Për këtë arsye, Islami ka rregulluar çdo çast të jetës njerëzore. Respektimi i disa kohëve të caktuara të urdhrave fetarë dhe veprimi me indiferentizëm ndaj disa të tjerave, ose zbatimi i një pjese të urdhrave hyjnore dhe neglizhimi i disa të tjerave, e

dobëson besimin. Nisur nga kjo, ne duhet të jetojmë me kujdesin dhe përpjekjen për të mos e harruar Allahun në asnjë çast të jetës. Kjo, sepse Allahu i Madhëruar, në një ajet fisnik urdhëron:

“Mos u bëni si ata që e harruan Allahun, kështu që Ai i bëri të harronin vetveten! Pikërisht ata janë të pabindurit (ndaj Allahut).” (Hashr, 19)

Në të vërtetë, askush nuk mund t'i vërë shkopinj nën rrota vëllait duke bërë Bismilah. Një njeri, zemra e të cilit thotë “Allah”, nuk mund të ngulë gjemba në zemrat e të tjerëve. Ai nuk u hyn në hak atyre me vetëdije dhe nuk zhytet në gjynahe. Gjynahet kryhen atëherë kur je indiferent ndaj Allahut. Dhe, të veprosh në kundërshtim me urdhrat hyjnorë, në çfarëdo çështje qoftë, do të thotë se je indiferent ndaj Allahut.

Nisur nga kjo, besnikërinë tonë ndaj fesë së Allahut duhet ta mbajmë të gjallë në çdo kohë dhe në çdo vend deri në frymën e fundit. Duke u mbështetur në parimin profetik, ***“është mashtruar ai që i ka dy ditë njëllor!”***, ne duhet të përpiqemi të jetojmë çdo çast të jetës sonë të mbushur me dashurinë për besimin i cili shtohet çdo ditë e më tepër dhe nuk pakësohet. Në çdo çast duhet të bëjmë përpjekje në rrugën e fesë, t'i lutemi dhe t'i përgjerohe mi Allahut, me qëllim që të afrohem sa më shumë me Të.

ATMOSFERA E TAKIMIT

Sa bukur e shprehin horizontin e devotshmërisë së të dashuruarve me Allahun këto këshilla të Mevlanës së nderuar:

“Merr abdest në atë mënyrë, që të mos prishet kurrë! Fal një namaz të tillë, që të mos mbarojë kurrë! Të dashuruarit nuk i mjaftojnë pesë kohë namaz. Ai dëshiron pesëqind mijë kohë. A mund të dëshirojë i dashuruari i vërtetë mbarimin e takimit!?”

Adhurimet kryhen dhe plotësohen në kohë të caktuara. Mirëpo, devotshmëria është e përhershme. Besim, është lidhja e zemrës në mënyrë të përhershme me Allahun e Madhëruar. Për këtë arsye, edhe të dashuruarit me Allahun, të cilët e jetojnë besimin me dashuri/pasion, frymëzimin shpirtëror që marrin prej adhurimit, e vazhdojnë në çdo frymëmarrje. Ata nuk janë indiferentë ndaj Allahut në asnjë kohë dhe në asnjë vend. Dhe, për shkak se e ndjejnë veten gjithmonë në prezencën hyjnore, abdesti, namazi dhe e gjithë devotshmëria e tyre është e përhershme.

Treguesi i kënaqësive të egos, është shuarja e dëshirës për to kur i shijon. Ndërsa kënaqësitë shpirtërore dëshirohen edhe me më shumë pasion kur shijohen. Për shembull, një person që agjëron gjithë ditën, ngopet me pak ushqim në yftar. Edhe nëse ushqimi është i shijshëm, ai nuk ka oreks të hajë më shumë. Mirëpo, kënaqësitë shpirtërore nuk janë të tilla. Kur ato shijohen, ia shtojnë edhe më shumë oreksin shpirtëror besimtarit, sepse në kënaqësitë shpirtërore gjendet një ëmbëlsi që s'ka fund.

Për këtë arsye, Ibrahim bin Et'hemi, i cili e la mënjanë madhështinë e kësaj bote dhe u zhyt në oqeanin e dashurisë hyjnore, ka thënë:

“Nëse kënaqësia që ndjejmë në në dashurinë hyjnore do të ishte diçka konkrete/materiale, mbretërit do të sakrifikonin të gjitha thesaret dhe mbretërinë e tyre për ta marrë prej nesh.”

Në sytë e robërve të afërt me Zotin, për shkak se tashmë arrijnë të ndjejnë flladet e kënaqësive të përhershme, ka marrë fund vlera e kënaqësive të kësaj bote. Për këtë arsye, edhe nëse janë në gjendje nevojë, në vend që ta përdorin për vete çdo mirësi që arrijnë të gjejnë, ata ndjejnë një kënaqësi të madhe kur ia falin ato të tjerëve për hir të Allahut.

Kjo ishte edhe arsyeja që i Dërguari i Allahut (a.s.), nuk gjente qetësi dhe paqe pa ia ngopur barkun të uriturve të umetit dhe pa ua shuar vuajtjet atyre. Kënaqësia shpirtërore që i sillte mëshira dhe dhembshuria ndaj krijesave për hir të Krijuesit, e bënte të Dërguarin e Allahut (a.s.), të harronte urinë e vet. Allahu na bëftë të mundur kënaqësi të tilla të përhershme që do t'i nënshtrojnë kënaqësitë e mirësive të përkohshme të kësaj bote!

Kjo, do të thotë se, kënaqësia shpirtërore e adhurimeve që kryhen me përkushtim të thellë, pra në atmosferën e takimit me zemër me Allahun, nuk mund të krahasohet me asnjë kënaqësi të përkohshme të kësaj bote. Të dashuruarit pas Allahut, të cilët kanë arritur të shijojnë qetësinë shpirtërore të të qenit bashkë me Allahun, nuk lodhen asnjëherë nga



Aliu (r.a.), thotë:

“Rëndësinë që i jepni bërjes së veprave të mira, jepjani edhe më tepër pranimit dhe ruajtjes së tyre!”

Mevlana është shprehur:

“Treguesi i adhurimit të pranuar, është fillimi i një adhurimi tjetër menjëherë pas tij, ose të nxitosh në vepra të mira njëra pas tjetrës.”

adhurimet, bindja ndaj Allahut, sakrificat dhe shërbimet në rrugën e Tij. Përkundrazi, ato janë kthyer në një kënaqësi dhe dëshirë me të cilat është e pamundur të ngopesh. Për këtë arsye, ata kanë dëshiruar që gjendja e takimit me Allahun të mos përfundojë kurrë.

Në të njëjtën mënyrë, edhe besimtarët që arrijnë ta kuptojnë siç duhet vlerën e Ramazanit të Bekuar duke përfituar sa më shumë prej tij, dëshirojnë që kjo atmosferë mëshire dhe rrjedha e frymëzimit shpirtëror që gjendet në të, të mos ndërpritet kurrë. Lidhur me këtë në një hadith fisnik urdhërohet:

“Nëse robërit do t'i dinin mirësitë e Ramazanit, do të dëshironin që i gjithë viti të ishte Ramazan...” (Hejthemi, v. III, fq. 141.)

Ndërsa Mualla bin Fadl, (rahmetullahi alejh), manifestimin e kësaj të vërtete tek besimtarët, e ka shprehur me këto fjalë:

“Të parët tanë të mirë, i luteshin Allahut gjashtë muajt rresht që të arrinin Ramazanin. Ndërsa gjashtë muajt e tjerë, luteshin që Allahu t'u pranonte Ramazanin që ata përjetuan.” (Kiuamu's-Sunne, et-Tergib ue't-Terhib, II, 354.)

RAMAZANI, ZEMRA E VITIT

Ne nuk duhet të harrojmë se Ramazani i Bekuar, është si zemra e gjithë vitit. Prandaj, pjekuria e devotshmërisë që kemi fituar në Ramazan, nuk duhet të firojë. Përkundrazi, ne duhet të përpiqemi që Ramazani i shkuar, të na lidhë me një dashuri shpirtërore edhe më të madhe me Ramazanin e ardhshëm. Padyshim se besimtari që ia arrin kësaj, do ta kalojë gjithë vitin të mbushur me frymën shpirtërore të Ramazanit.

Mirë, por çfarë duhet të bëjmë dhe çfarë duhet të kemi kujdes, që ta përjetojmë gjatë gjithë vitit frymën shpirtërore të Ramazanit të Bekuar?

Në radhë të parë, durimin dhe edukimin e egos në agjërim, duhet ta bartim gjatë gjithë kohës. Nëse e

ruajmë egon/veten tonë prej grykësisë, shpërdorimit, lakmisë, zemërimit dhe të këqijave, do të arrijmë të vazhdojmë mirësitë e Ramazanit. Në fakt, edhe konsiderimi si i pëlqyeshëm i agjërimit të gjashtë ditëve të muajit Sheuual, menjëherë pas Bajramit të Ramazanit, nga një anë ndihmon në normalizimin e trupit shkallë- shkallë me rregullin e mëparshëm dhe nga ana tjetër, nxit vazhdimësinë e shpirtit të agjërimit të Ramazanit me anë të agjërimit vullnetar. Po ashtu, edhe agjërimi i ditëve në datat 13, 14 dhe 15 të çdo muaji hënor dhe ditëve të hëna dhe të enjte të çdo jave, kanë të njëjtën vlerë për ata që kanë mundësi.

Agjërimi është një trajnim durimi. Dhe durimi është i domosdoshëm për besimtarin në çdo kohë dhe në çdo vend. Durimi është i domosdoshëm për të qenë i vazhdueshëm në adhurim... Për të mos u treguar i pabindur ndaj Allahut... Për t'iu kundërvënë dëshirave të egos... Për të përballuar fatkeqësitë, duke mos cenuar falënderimin në zemër, mirënjohjen dhe gjendjen e kënaqësisë... Për të mos u zhytur në indiferencë dhe për të mos shkarë këmba atëherë kur je i kamur dhe kur mundësitë për të anuar nga dëshirat e egos janë të mëdha... Për të harruar ankesën, për të mos u lëkundur besimi dhe për të mos anuar nga haramet atëherë kur je në skamje dhe kur varfëria i afrohet mohimit... Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar urdhëron: **"...Përgëzoi të duruarit!"** (Bekare, 155)

Nga ana tjetër, dy janë gjërat që ndikojnë më shumë tek njeriu: Njëra nga këto është gjendja shpirtërore e atyre me të cilët shoqërohesh dhe tjetra është gjendja e ushqimit në aspektin e hallallit dhe haramit. Kështu që, nëse arrijmë që kujdesin të cilin e tregojmë në çështjen e ushqimit hallall në kohën e agjërimit të Ramazanit, ta tregojmë për të gjitha haramet, mekruhet dhe të dyshimtat në kohët e tjera, atëherë do të jetë e mundur të vazhdohet edhe shpirti i Ramazanit.

Ashtu siç e penguan veten prej ngrënies dhe pirjes gjatë agjërimit, edhe pas Ramazanit duhet të jemi agjërueshëm shpirtërisht ndaj të gjitha haramëve dhe gjynaheve. Ne duhet të bëjmë kujdes ndaj çdo kafshate që hynë në gojën tonë dhe çdo fjale që del prej saj. Duhet të ruajmë gjuhën tonë veçanërisht prej gënjeshtërisë, thashethemeve, përgojimit dhe

fjalëve të padobishme.

Në të njëjtën mënyrë, ashtu siç e mbyllim gojën tonë ndaj ushqimeve gjatë agjërimit, edhe zemrën tonë duhet ta mbajmë gjithmonë të mbyllur ndaj gjynahut, hipokrizisë, krekosjes, mendjemadhësisë, mosmirënjohjes, smirës dhe lakmisë. Sytë tanë duhet t'i mbajmë të mbyllur ndaj gjërave që Allahu i Madhëruar i ka caktuar si të ndaluara. Po ashtu, edhe veshët tanë duhet t'i mbajmë të mbyllura ndaj të gjitha zërave të shëmtuar dhe fjalëve të këqija të cilat dënohen nga Kurani dhe Suneti.

Nëse arrijmë ta zbatojmë në të gjitha mëngjeset zgjimin tonë në syfyr gjatë Ramazanit, pra, nëse e bëjmë zakon që ta zbukurojmë muzgun e agimit me namaz, dhikër dhe istigfar, do të arrijmë të ruajmë edhe frymën shpirtërore të Ramazanit.

Nëse do t'ia dinim vlerën çdo nate, ashtu siç e kërkojmë Natën e Kadrit në Ramazan, do të jetojmë gjatë gjithë vitit si në Ramazan.

Nëse arrijmë që vullnetin me të cilin nxitojmë për në namazet e teravive gjatë Ramazanit, ta kthejmë një traditë të vazhdueshme të faljes së namazeve me xhemat gjatë gjithë vitit, do të arrijmë ta mbajmë gjithmonë të freskët atmosferën shpirtërore të Ramazanit të Bekuar në zemrën tonë.

Nëse vazhdojmë të jetojmë në atmosferën e Kuranit Fisnik edhe në muajt e tjerë, ashtu siç e shtojmë afërsinë tonë me të kur e lexojmë gjatë gjithë Ramazanit, do të arrijmë ta bëjmë të vazhdueshme në zemrën tonë përbërjen shpirtërore të Ramazanit.

Sadakatë dhe dhurimet, janë gjithmonë një derë e hapur për të arritur kënaqësinë e Allahut të Madhëruar. Nëse entuziazmi i zekatit, sadakasë së fitrit dhe dhurimeve të tjera që bëhen në Ramazan shfaqet edhe gjatë muajve të tjerë, nëse ruhem i egoizmit dhe koprracisë, duke dhënë bujarisht dhe duke sakrifikuar në rrugën e Allahut dhe nëse nuk i harrojmë të varfrit, por përkundrazi i shohim ata sikur të jenë në përgjegjësinë tonë dhe e shtojmë mëshirën dhe dhembshurinë tonë ndaj tyre, do të arrijmë ta bëjmë të vazhdueshme edhe atmosferën e mëshirës së Ramazanit.

Lidhur me këtë çështje, i nderuari Musa Efendi (rahmetullahi alejh), ka thënë:

"Biri im! Jetoni patjetër duke edukuar veten

*"Nëse
Ramazani
i Bekuar kalohet
zgjuar duke bërë dhikër,
kjo gjendje do të vazhdojë
edhe në pjesën tjetër të vitit.
Nëse në këtë muaj vërehet
ndonjë mangësi ose dobësi,
gjurma e saj do të shihet
edhe gjatë gjithë
vitit."*



*“Të parët tanë të mirë,
i luteshin Allahut gjashtë muaj rresht që të arrinin Ramazanin.
Ndërsa gjashtë muajt e tjerë, luteshin që Allahu t’u pranonte
Ramazanin që ata përjetuan.”*



tuaj (shpirtërisht) dhe dhuroni prej atyre që ju ka dhënë Allahu, po për hir të Allahut! Edukimi juaj shpirtëror të mos jetë i kufizuar veç në tre muajt e shenjtë dhe në Ramazan! Por shpërndajeni atë në çdo pjesë të jetës suaj dhe tepricën dhurojeni në rrugë të Allahut!..”

Në Ramazan, shejtanët lidhen me zinxhirë dhe njeriu ngelet vetëm për vetëm me egon/veten e tij. Ndërsa pas Ramazanit, shejtanët që përpiqen ta largojnë robin nga Zoti i tij, zgjidhen përsëri. Mirëpo, nëse ne arrijmë të jemi gjithmonë vigjilent ndaj gjynaheve dhe nxitjeve të egos dhe shejtanit, atëherë do të jetë e mundur që të mos e humbasim butësinë e zemrës që kemi formuar gjatë Ramazanit. Lidhur me këtë, në një ajet fisnik urdhërohet:

“Nëse shejtani fillon të të joshë, kërko mbështetje te Allahu. Me të vërtetë, Ai i dëgjon të gjitha dhe i di të gjitha.” (Fussilet, 36)

Shkurtimisht, aq sa ne përpiqemi t’i bëjmë këto virtyte parime të jetës sonë, po aq do të arrijmë që ta mbajmë gjallë Ramazanin në jetën tonë në një nivel të kënaqshëm.

TREGUESI I VEPRËS SË PRANUAR

Në një hadith fisnik urdhërohet

“Vepra më e dashur tek Allahu i Madhëruar, është ajo që bëhet vazhdimisht, qoftë edhe e pakët.” (Muslim, Musafirin, 218; Ahmed, VI, 61.)

Ndërsa Allahu i Madhëruar, në një ajet fisnik urdhëron:

“Prandaj, kur të çlirohesh (nga një punë), përpiqu fort (në një punë tjetër) dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu!” (Inshirah, 7-8) Nga kjo, kuptojmë se Allahu na urdhëron që të vazhdojmë punët e mira e të dobishme, pa bërë pushim.

Në të njëjtin kuptim, Mevlana i nderuar është shprehur:

“Treguesi i adhurimit të pranuar, është fillimi i një adhurimi tjetër menjëherë pas tij, ose të nxitosh në vepra të mira njëra pas tjetrës.”

Ndërsa treguesi i një veprë të papranuar, është ndjekja e saj nga punë të kota dhe të padobishme. Kurse më e keqe se kjo, është ndjekja e veprës së mirë nga një vepër e keqe, e cila e fshin dhe e zhduk atë.

Siç njoftohemi edhe në Kuranin Fisnik, Allahu i Madhëruar na paralajmëron të mos bëhemi si ai që i fshin shpërblimet e mirësive të tij me gjynahe:

“Mos u bëni si ajo gruaja që e shprish dhe e bën fije-fije atë që e ka tjerë fort!..” (Nahl, 92)

Ja pra, ne duhet të bëjmë kujdes ndaj këtij paralajmërimi hyjnor veçanërisht në jetën tonë të adhurimeve dhe të ruhem nga çuarja dëm e veprave tona të mira. Të biesh përsëri në gabime, gjynahe dhe indiferencë pas Ramazanit, i ngjan braktisjes së thesit të mbushur pa e lidhur atë. Çfarëdo që kemi fituar dhe kemi mbledhur, do të derdhet dhe nuk do të na mbetet asgjë tjetër përveç hidhërimit.

Për këtë arsye, Aliu (r.a.), thotë:

“Rëndësinë që i jepni bërjes së veprave të mira, jepjani edhe më tepër pranimit dhe ruajtjes së tyre!”

Për shembull: Të krenohesh dhe të mburresh me adhurimet që kryen, duke thënë “unë bëra kështu e ashtu!”, duke ia atribuar vetes gjithçka, bëhet shkak i humbjes së vlerës së punëve të mira që janë bërë.

Gjithashtu, edhe kur një njeri që është ende gjallë, i vë emrin e vet një xhamie, një shkollë apo një institucioni bamirësie që ka ndërtuar, e përziën këtë mirësi me egon e vet. Mirëpo, besimi monoteist, nuk pranon ortakëri. Por, pasi ky person të ndërrojë jetë, trashëgimtarët mund t’ia vënë emrin e tij ndonjë

vepre mirësie. Kjo nuk përbën asnjë problem, sepse kjo synon që njerëzit e mirë që kanë shkuar, të kujtohen me mëshirë nga brezat e ardhshëm.

Pra, aq sa është e rëndësishme kryerja e adhurimeve dhe mirësive, aq është i rëndësishëm edhe kujdesi që duhet të tregohet në ruajtjen dhe pranimin e tyre.

Në përgjithësi, në Ramazan përpiqemi më shumë që të përparojmë në rrugën e afrimit me Zotin tonë duke agjëruar, duke falur namazet e teravive, duke lexuar shumë Kuran, duke dhënë zekat, fitre dhe duke bërë bamirësi. Ndërkohë që po përjetojmë këto ditë të fundit të këtij muaji të bekuar, pyetja më e rëndësishme në zemrën tonë duhet të jetë kjo:

“Vallë a janë pranuar tek Allahu përpjekjet tona për të gjallëruar Ramazanin?..”

Në lidhje me këtë çështje, Mirza Maz’har Khan-i Xhanan (rahmetullahi alejh), shprehet kështu duke dëshiruar të na japë këto kritere:

“Nëse Ramazani i Bekuar kalohet zgjuar duke bërë dhikër, kjo gjendje do të vazhdojë edhe në pjesën tjetër të vitit. Nëse në këtë muaj vërehet ndonjë mangësi ose dobësi, gjurma e saj do të shihet edhe gjatë gjithë vitit.”

Domethënë se, atmosfera e dendur e adhurimit dhe pjekuria e veçantë e devotshmërisë që përjetohet gjatë Ramazanit, është si një farë që mbillet. Se sa do zërë kjo farë, do të shihet në muajt e tjerë të vitit.

Shkurtimisht, gjendja dhe drejtimi ynë pas Ramazanit, janë një tregues i pranimit apo jo i adhurimeve tona gjatë Ramazanit. Ruajtja e pjekurisë së devotshmërisë që kemi fituar në Ramazan, është tregues i sasisë së përfitimit që kemi arritur në këtë muaj të bekuar.

KOHA E LLOGARISË

Pas Ramazanit të Bekuar, duhet të bëjmë një vetëllogari dhe vetëkontroll. Duhet të mendojmë se:

Kaloi edhe një Ramazan tjetër prej kalendarit të jetës sonë. Çfarë na lanë këto ditë të bekuara? A mundëm ta bënim Ramazanin shkak për të përmirësuar të metat dhe gabimet tona, për të shtuar virtytet tona dhe për të lartësuar moralet tona?

Për cilat gabime jemi penduar? Sa prej veseve të këqija kemi braktisur?

Me sa persona jemi hallalluar?

Sa të mërzitur kemi pajtuar?

Me sa prej vëllezërve tanë me të cilët jemi ftohur, jemi përqaftuar për hir të Allahut?

Sa zemra të thyera kemi ngushëlluar? Sa fytyra të vuajtura kemi bërë të buzëqeshin?



Sa prej të metave të adhurimeve tona kemi përmirësuar?

Sa shërbime dhe përpjekje kemi bërë të cilat do të na ndriçojnë errësitat e varrit, që do të na lehtësojnë llogarinë në Ditën e Gjykimit dhe që do të na bëjnë të fitojmë lumturinë e përjetshme?

Cilat prej mangësive tona në lidhje me përgjegjësitë ndaj familjes, fqinjëve, të afërmeve, shoqërisë dhe krijesave të tjera kemi përmirësuar? Çfarë vendimesh të dobishme kemi marrë në këtë drejtim?

Nëse jemi përmirësuar, a ka mbetur kjo vetëm në Ramazan, apo e kemi vazhduar këtë edhe pas tij?

Të mos harrojmë se mëshira hyjnore, do të realizohet për ata që i vazhdojnë virtytet e mira që kanë fituar në Ramazan, gjatë gjithë jetës së tyre. Mëshira hyjnore është në një manifestim të vazhdueshëm. E rëndësishme është që të kërkojmë mënyrat që do të na shpjen tek ajo mëshirë dhe t'i vlerësojmë siç duhet mundësitë që na jepen. Të tregohemi neglizhentë ndaj përfitimit prej ditëve dhe netëve të bekuara të Ramazanit, është një humbje e madhe.

Jemi duke përjetuar ditët e fundit të këtij Ramazani. Mirëpo, a do ta arrijmë Ramazanin tjetër!? Kjo nuk dihet! Sado e gjatë të duket, jeta kalimtare e kësaj bote është sa një muaj Ramazani në krahasim me jetën e përjetshme. Për këtë arsye, ne duhet të përpiqemi ta vlerësojmë atë në mënyrë që të arrijmë faljen hyjnore.

Ne duhet të shpërndajmë në të gjithë jetën tonë entuziazmin e adhurimeve, veprave të mira, dhurimeve dhe fitimit e zemrave që përpiqemi t'i bëjmë në Ramazan, me qëllim që në frymën tonë të fundit të zgjohemi në mëngjesin e një bajrami të përjetshëm.

Allahu i Madhëruar na bëftë prej robërve fatlumë që arrijnë të dalin prej Ramazanit të Bekuar me diplomën e një Bajrami të vërtetë. Allahu na bëftë që ta jetojmë çdo ditë tonën me frymëzimin shpirtëror të Ramazanit. Po ashtu e bëftë botën e përjetshme një lumturi bajrami të përhershme.

Amin!



ALLAHU ALIM

— Ilir Hoxha —

Sa herë që dëshirojmë të përforcojmë saktësinë e fjalës sonë, përdorim shprehjen “Allahu Alim”. Kjo do të thotë të marrësh si dëshmitar Dijen e Allahut të Madhëruar, i Cili di gjithçka. Pra, Allahu e di se ajo që themi është e saktë, ose që do ta bëjmë atë që themi. Tani le të përpiqemi ta kuptojmë më mirë këtë emër hyjnor.

Emri “Alim”, që vlen prej rrënjës “ilm”, shpreh atë që di gjithçka, të vogël e të madhe, të fshehtë e të hapur dhe pa qenë i kufizuar as në hapësirë, e as në kohë. Dhe fakti që dija e Allahut nuk është e kufizuar as në hapësirë, e as në kohë, ka një rëndësi jetike në aspektin e kuptimit të besimit në kader/caktim.

MARRËDHËNIA E EMRIT ALIM ME EMRAT E TJERË TË ALLAHUT

Është me rëndësi të madhe që, përveç përdorimit të shpeshtë të emrit Alim në Kuran, të shohim edhe se bashkë me cilin prej emrave të tjerë hyjnorë përmendet ai. Nisur nga kjo, vërejmë se emri Alim, përmendet më së shumti bashkë me emrin Halim (36 herë). Kjo tregon marrëdhënien e afërt që ka dija dhe urtësia hyjnore. Urtësi do të thotë saktësi në dije, në gjykim dhe në vepër. Dhe dihet qartë se çfarë marrëdhënie ka dija me saktësinë e gjykimeve dhe veprave. Falënderimi i pafundëm i takon Allahut të Madhëruar, që i ka falur dije dhe urtësi robërve që Ai ka dëshiruar, duke filluar prej profetëve. (shih. Jusuf, 22; Kehf, 65; Enbija, 74, 79; Ankebut, 49.)

Emri Alim është përdorur në Kuranin Fisnik edhe 32 herë të tjera së bashku me emrin hyjnor

Semi (ai që dëgjon çdo gjë). Në të gjitha vendet që është përdorur, ka ardhur pas emrit Semi (veçanërisht kur bëhet fjalë për dije fetare), gjë e cila tregon qartë rëndësinë që ka dëgjimi në arritjen e dijes dhe se burimi kryesor i dijes është transmetimi.

NJOHJA E ALLAHUT DHE E VETES

Sipas mistikëve, njohja e Allahut është dija më e lartë, sepse dinjiteti i dijes, varet nga nderi që ka ajo që njihet. Dhe më i nderuari i atyre që njihen, padyshim që është Allahu i Madhëruar. Madje, sipas tyre, nëse njohja e gjërave të tjera do ta afrojë robin me Zotin e tij, edhe ato konsiderohen të nderuara. Ndërsa çdo dije tjetër që është jashtë këtyre, nuk është kaq e nderuar sa ato... Mirëpo, sado i ditur të jetë njeriu, përsëri ato që nuk di ai, janë shumë herë më tepër se ato që di. Madje, edhe ato që mendon se ai i di, janë dije sipërfaqësore, e jo dije absolute. Përpjekja e njeriut për të njohur të vërtetën e materies në mënyrë absolute, gjithmonë do të përfundojë me paaftësi. Për këtë arsye, fundi i njohjes është mahnitja dhe shoku, sepse ai që e njeh më mirë Allahun, është ai që mahnitet më tepër. Nisur nga kjo, ajo që kërkohet prej robit në këtë pikë, është që me anë të kësaj dijeje të kufizuar, të perceptojë pronarin e përsosmërive absolute dhe të kërkojë rrugët që do ta shpien atë drejt kënaqësisë së Tij, pa e çuar dëm ndjenjën që Ai i ka falur për të mësuar dhe kërkuar urtësi.

Ndërsa në rrugën e dijes dhe urtësisë, gjithsecili mund të përparojë aq sa e lejon kapaciteti që i është caktuar. Për këtë arsye, është e domosdo-

shme të mos përpiqesh që gjithçka ta zgjidhësh i vetëm, por të përfitosh prej dijes së akumuluar nga i gjithë njerëzimi.

Njohja e vetvetes nga ana e njeriut, në të gjitha fetë pranohet si një prej domosdoshmërive më të rëndësishme për të arritur përsosmërinë. Mirëpo, sipas Prof. Nevzat Tarhan, procesi i zbulimit të vetvetes, në të njëjtën kohë do të thotë edhe zbulim i aftësive personale. E për këtë arsye, ndërkohë që nga një anë kjo i sjell gjallëri njeriut, nga ana tjetër i ngarkon atij përgjegjësi të reja, gjë e cila edhe e tremb shumë atë. Shkaku që qëndron në thellësi të frikës nga njohja, është ndjenja e fajësisë që të jep pamundësia për t'i kthyer në akte dijet e fituara.

REZULTATET E BESIMIT NË EMRIN HYJNOR EL-ALIM

Pafundësia e dijes, urtësisë dhe fuqisë së Zotit tonë, ka kuptime të ndryshme për të gjithë. Fakti që Allahu i Madhëruar di çdo gjë pa asnjë përjashtim, është një ngushëllim për ata që janë në rrugë të drejtë. Kurse për gjynahqarët, të padrejtët dhe të pabindurit, është një kërcënim. Madje, nëse vërehet me kujdes se me cilët prej emrave të tjerë hyjnorë është përmendur ky emër në Kuranin Fisnik, forca e këtij ngushëllimi dhe këtij kërcënimi do të shtohet edhe më tepër. (shih. Bekare, 137; Enfal, 61.)

Besimi se Allahu është i vetmi që di çdo gjë, është një nivel i rëndësishëm vetëdijeje që e ruan njeriun nga rënia në shirk dhe nga idhujtarizimi i krijesave, të cilave u atribuojnë aftësi të jashtëzakonshme. Shirku vjen si rezultat i mosnjohjes së mirë të Allahut dhe mendimeve të gabuara në lidhje me Të. (shih. En'am, 100; Kehf, 5; Haxh, 3; Lukman, 20; Zuhruf, 20; Nexhm, 28...)

Në fakt, ne mund ta detajojmë besimin monoteist në lidhje me njëshmërinë e Zotit tonë, duke vendosur çdonjërin prej emrave të bukur hyjnor në vend të emrin "ilah", që zë vend në Shprehjen e Teuhidit. Si për shembull, "Përveç Allahut s'ka askush tjetër që di gjithçka", "Përveç

Allahut s'ka askush tjetër që ka fuqi për gjithçka", "Përveç Allahut s'ka askush tjetër që hap çdo derë", etj.

Njeriu që i beson emrave hyjnorë Alim, Hakim dhe Kadir, në çfarëdolloj situatë të jetë, e di se ndodhet nën mbrojtjen e dikujt që e njeh shumë mirë atë, që është i urtë dhe i fuqishëm për çdo gjë. Por ndonjëherë, ne rrëshqasim në ekstremin tjetër në këtë çështje dhe për të rregulluar punët, ia delegojmë të gjitha përgjegjësitë tona Allahut të Madhëruar, duke thënë, "gjithsesi Allahu di çdo gjë" dhe presim sikur Ai duhet t'i bëjë të gjitha ato që duhet të bëjmë ne. Për këtë arsye, ne duhet të bëjmë çdo gjë që kemi mundësi pa rënë në këtë gabim, e më pas, çështjet të cilat i kapërcejnë mundësitë tona, duhet t'ia lëmë dijes dhe urtësisë së Allahut, duke besuar fort se Ai nuk na lë kurrë të poshtëruar e të humbur dhe se çdo gjë që bën Ai, e ka një urtësi.

Ai që e di se Allahu është Alim, e di edhe se prej Tij nuk mund të fshihet asgjë. Roli i këtij besimi në pjekjen morale të njeriut, është i paçmueshëm. Ne as që mund ta mendojmë se çfarë vetëkontrolli na siguron besimi se Allahu di dhe njeh çdo gjë brenda dhe jashtë nesh... Lidhur me këtë Russel W. Gough shprehet se, "*moralin tonë të vërtetë, e tregojnë sjelljet që ne shfaqim në një vend ku nuk ndodhet askush*". (shih. "Karakterit është fati juaj")

Si përfundim, mund të themi se njeriu i cili e di që Allahu njeh çdo gjë me të gjitha detajet e veta, nuk ia kthen shpinën dijes që vjen prej tij (shpalljes). E nëse ia kthen, ai është i dënueshëm të humbasë rrugën, të çojë dëm jetën e vet dhe të bjerë nga një gabim në tjetrin. E meqenëse Allahu di çdo gjë në mënyrën më të saktë, atëherë të jemi të sigurt se çdo fjalë e Tij, është më e saktë, më e çmuar dhe më e drejtë se dija, mendimi dhe dëshirat tonë. Për rrjedhojë nëse ne largohemi prej atyre që Ai thotë se janë të sakta, të jemi të sigurt se do t'i shkaktojmë vetes një dëm të pariparueshëm.

Refleksione

— Nuredin Nazarko —

87. Trimëria pa guxim nuk mund të kuptohet.
88. Nëse ke forcë dhe pushtet lufto të mbetesh i drejtë.
89. Besa është amanet i shenjtë. Lum kush e ruan. Mjerë kush e humb.
90. Veshja ngre njeriun. Veshja ul njeriun. I ulëti nuk lartësohet nga veshja. I lartësuar nuk ulet nga veshja.
91. Në jetë një nga gjërat që kemi nevojë më së shumti janë njerëzit besnikë. Sikur të mundnim të rrethoheshim prej tyre çdo çast.
92. Fytyra është pasqyrë e gjendjes shpirtërore. Në trishtim edhe fytyra më e bukur mrrolet. Në gëzim dhe fytyra jo e bukur çelet.
93. Nuk mund të hipësh mbi barkën e shpëtimit pa vuajtur. Nëse hipën pa vuajtje nuk do të qëndrosh dot në të.
94. Pabesia vret shumë më tepër sesa fatkeqësitë e tjera. Edhe më e rëndë është kur ndodh nga njerëz që u ke falur dhe shpirtin.
95. Përtej pamjes fizike qëndron shpirti. Dëgjoi fjalët e shpirtit dhe mos i refuzo apo prano vetëm prej pamjes fizike.
96. Shpirtrat prej ari ndriçojnë gjithë jetën. Shpirtrat prej katrani nxijnë gjithë jetën.
97. Vetëm ata që kanë vuajtur e sakrifikuar mund t'i kuptojnë të përvuajturit dhe t'u ofrojnë atyre ndihmë.
98. Duhet ruajtur gjuha nga kërkimi i gjërave jo në kohën e duhur. Mund të ndodhë të pikëllohesh nga ajo që vjen, por koha nuk kthehet pas.
99. Nuk ka flori që të peshojë dashurinë e prindërve për fëmijën.
100. Zemërkeqi dhe shpirtligu nuk mund të ujitin trëndafila.
101. Mençuria e të vjetërve s'ka të peshuar.
102. Lakminë për ar nuk e shuan as pushteti, as vetë ari.
103. Nëse ke njohuri për çështjet e mirësive parapriu njerëzve në të mira. Mos i humb frytet e mirësisë nga neglizhenca.
104. Pangopësia është porta e fatkeqësive.
105. Nëse të vijnë mirësitë rradhë-rradhë ruaju e mos të duket vetja Pronar. Do të humbësh gjithçka në çastin që do ta mendosh veten Zot të asaj që të është dhënë.
106. Nëse je i dobët mos kërkosh shumë gjëra. Do të të shtypin për shkak të dobësisë.
107. Mos u trego kryelartë me njerëzit. Mos i fyej, mos i nënçmo me llagape të ulëta. Jo vetëm ata, por edhe ti ke plot të meta e mangësi.
108. Kolltuku dhe hijeshia fizike të marrin mendtë. Mjerë kush bie në rrjetën e tyre.
109. Duhet të prekësh realitetin me dorën tënde. Duhet ta shikosh realitetin me sytë e tu. Nëse dora nuk gjakoset, nëse syri nuk loton nga vuajtjet, nëse trupi nuk drobitet për

- kafshatën e ditës, nuk ke njohur asgjë nga jeta reale.
110. Nuk duhet të kryelartësohemi nga energjia dhe bukuria e moshës rinore. Një ditë gjithçka do të vyshket dhe era e parë e vjeshtës do të luajë me peshën tënde të lehtë.
 111. Të mirat që zotëron mund të ngjallin lakminë e çakejve dhe hienave. Përgatitu një festë të denjë për sojin e tyre.
 112. Shkëlqimi përjashtësor i gjërave është kurthi më i ëmbël. Kujdes nga kjo ëmbëlsi. Nuk ia vlen të humbësh jetën për gjëra që zhduken në rrjedhën e kohës.
 113. Në rast se gjendesh ngushtë e kërkon të zgjidhësh hall, mos bëj premtime boshe. Me siguri nuk ke për t'i mbajtur të gjitha premtimet.
 114. Mos i përcmo ata që të zgjatin dorën në ditë të vështira edhe nëse ke pozitë apo status më të mirë se ta.
 115. Nëse shpirtligu të nderon e respekton dije se ka plane të errëta në zemër. Qëndro syçelur dhe lutu të shpëtosh nga e liga e tij.
 116. Në përballjen me të ligun nuk mjafton vetëm forca. Më shumë vlen zgjuarsia.
 117. Varfëria është sprovuesja e karakterit. Ajo djeg çdo lëvdatë burrërie dhe çdo mburrje bamirësie, duke lënë pas hirin e asaj çfarë jemi.
 118. I ligu nuk vdes, ai ngrohdh.
 119. Në do të shpëtosh nga ligësia duhet ta djegësh zjarrin e saj.
 120. Poshtë rrobave zhelane mund të mos fshihen lypës të varfër, por njerëz të djallëzuar.
 121. Zgjuarsia dhe durimi janë dy miq që nuk të lënë asnjëherë në baltë.
 122. Mosmirënjohësit janë dhe më të poshtërit. Nuk falenderojnë. Përçmojnë dhe tallen. Fyejnë dhe dëntojnë bamirësit e tyre. Në çdo gjendje që të gjendesh mos e vish këtë lëkurë.
 123. Mos shko përtej mundësive që të janë dhënë. Nëse tenton fund jo i mirë të pret.
 124. Kurrë mos i beso asaj që duket. Në i besofsh bëj gati sofrën për zhgënjimet.
 125. Fatit tënd nuk i ikën dot. Në t'u duktë se shpëtove në një situatë do ta takosh patjetër në një situatë tjetër.
 126. Urat për të kaluar zjarri nuk ndërtohen me kashtë.
 127. Kur të plakesh mos i flak tej shërbyesit e rinisë.
 128. Askush nga krijesat nuk mund të jetë i vetëmjaftueshëm për gjithçka.
 129. Nëse ke fuqi mbi të tjerët mos i shtyp të dobëtit dhe të pafuqishmit. Mos hiq dorë nga butësia dhe mëshira për përfitime momentale.
 130. Nëse kërkon të kryesh një punë dhe ta perfeksionosh mblidh rreth vetes mjeshtrat e asaj pune.
 131. Udhët e fatit janë të mistershme. Edhe ti je një mister.
 132. Miqësitë me të pabesët janë si zjarri.
 133. Mund të kesh të meta e gabime. Mos u trishto! Je njeri. Veç nga pabesia ruaju se bëhesh si djalli.
 134. Ruaju nga aleanca më të fuqishmit. Për aq sa u nevojitesh do të të trajtojnë mirë. Mos u deh nga kjo periudhë, por bëhu gati për fundin që të pret.
 135. Mos e shit lirë mjeshtërinë të lirë. Çmoje veten dhe do të jesh i çmuar. Veç bëj kujdes nga vetëpëlqimi.
 136. Ligësia e të pushtetshmit bën kërdrinë.
 137. Lufta për aq sa ke fuqi dhe kurrë mos u dorëzo. Mos harro të hedhësh në përdorim dhe diplomacinë.
 138. Shpirtrat e errët edhe vështrimin e kanë të zi.
 139. Secili do të paguajë haraçin e punëve të veta.
 140. Nderoju të vjetrit. Ki durim ndaj dobësive të tyre dhe falu dashuri. Një ditë mund të jesh prej tyre.



Mbi mendimin filozofik të RENE GUENON

(SHEJH ABDULVAHID YAHYA)

— Murat M. Aliu —

JETA

Rene-Jean-Marie-Joseph Guénon (Shejh Abdulvahid Yahya) u lind në 15 Nëntor të vitit 1886 në qytetin Blois të Francës. Fëmijërinë e kaloi në një familje katolike. Në vitin 1898 regjistrohet në shkollën Notre-Dame des Aydes ku spikat si një nxënës me aftësi të larta intelektuale dhe mendore. Në vitin 1902 pranohet në kolegjin Augustin-Thierry si student i retorikës, ndërsa një vit më pas, regjistrohet në Fakultetin e Filozofisë të cilin e mbaron me rezultate të shkëlqyera. Në vitin 1912 Rene Guénon konvertohet në musliman duke marrë emrin e ri, Shejh Abdulvahid Yahya. Në vitin 1917, Guénon u shpërngul në Algjeri, ku në qytetin Shetif ligjëroi lëndën e filozofisë, gjuhën frënge dhe atë latine. Në Tetor të vitit 1918 u kthye përsëri në Francë për të ligjëruar lëndën e filozofisë në kolegjin Augustin-Thierry, në qytetin e tij të lindjes në Bolis. Pas dy vjetësh, në vitin 1920 u shpërngul në Paris dhe aty punoi pranë bibliotekës së Universitetit të Parisit. Gjatë viteve 1925-1927 ka shkruar në revistën *Le Volie D'Isis*; revistë që ia dha mundësinë që idetë dhe mendimet e tij t'i shprehë në mënyrë absolute dhe lirshme. Në vitin 1930, Guénon, bashkë me bashkëshorten e tij Dian udhëtuan në Egjipt. Shkuarja e tij në Egjipt, në fillim ishte kryekëput për qëllime hulumtuese. Por edhe pse bashkëshortja e tij Dina, vetëm pas tri muajsh qëndrimi në Egjipt u kthye në Francë, Guénon, vazhdoi të jetojë aty deri në fund të jetës së tij. Pas një sëmundje të rëndë

ndërroi jetë duke pëshpëritur “Alla”, “Allah` më 7 Janarë të vitit 1950.

VEPRAT

Rene Guénon si një mendimtar dhe filozof me përmasa botërore pas vetës la një mori veprash të rëndësishme filozofike, të cilët sot e kësaj dite ruajnë aktualitetin filozofik e shkencor. Veprat e tij filozofike janë të shumta, por ne do të mjaftohemi duke përmendur veprën e tij kapitale “Kriza e Botës Moderne”, si njëri ndër veprat kryesore të tij. Guénon, në këtë vepër me një sens të filozofit “tradicional” dhe si themelues dhe pishtar i tradicionalizmit kritikon botën perëndimore, përkatësisht paradigmen moderne duke theksuar se, sot, perëndimi totalisht është shkëputur nga tradita dhe se sot materializmi përbën elementin ontologjik të individit perëndimorë. Sipas tij materializmi ka gjeneruar individualizmin, ndërsa individualizmi nga ana e tij ka sjellë shkëputjen epistemologjike me traditën. Në vija të trasha ai kritikon konceptet të prodhuara nga paradigma moderne siç janë Rilindja, Humanizmi, Demokracia etj. Ai në filozofinë e tij në mënyrë të veçantë kritikon instrumentalizimin e arsyes. Gjithashtu ai në veçanti kritikon konceptualizmin modern të shkencës, sepse sipas tij, sot shkenca është shndërruar në një instrument të industrializimit i cili përveç “makinizimit” të individit nuk kryen asnjë funksion tjetër. Kështu filozofia materialiste sot dominon botën perëndimore. Në fund, Guénon, kritikon edhe intelektualët dhe filo-

zofët perëndimore duke thënë se duke u mbështetur në filozofinë materialiste, ata, nuk janë të kufizuar vetëm me shpikjen dhe ndërtimin e makinave, por se në fund, të gjithë u makinizuan.¹

DEPRESION OSE KRIZË (CRISIS)

E gjithë paradigma e mendimit filozofik të Rene Guenon përbëhet nga kritika për “moralin” e botës moderne “Bota moderne është në krizë” thotë, Guenon, duke aluduar në një krizë të thellë shpirtërore dhe morale.² Me termin “krizë”, Guenon, ka parashikuar një periudhë të caktuar të historisë njerëzore, periudhë e cila individin-njeriun modern e ka ekspozuar para një gjendje kritike. Njeriu modern sot jeton në një krizë dhe depresion të përshkallëzuar, pasojat e të cilit mund të jenë fatale për gjithë njerëzimin. Sipas Guenonit ndoshta është vështirë të thuhet se ka ardhur “fundit i botës”, por lirisht mund të gjykojmë për “fundin e një bote”. Në fakt sipas tij, në një farë mënyre mund të thuhet edhe “fundit i botës”, sepse sot, kur përmendet shprehja civilizim, njerëzit automatikisht në subkoshiençë përfytyrojnë “Civilizimin Perëndimor”. Kështu sipas filozofit, njeriu modern për të “shpëtuar” nga kjo krizë ose depresion në asnjë mënyrë nuk duhet dorëzuar, por në vend të kësaj duhet luftuar kundër skllavërisë dhe prangave që ka prodhuar filozofia materialiste dhe paradigma moderne, ku e gjithë qenia e njeriut reduktohet në instrument.

TRADITA (TRADITUM)

Në literaturën e shkencave sociale, termi “traditë” ngërthen disa kuptime. Termi traditë rrjedh nga shprehja *traditum* që shpreh gjithçka që është trashëguar apo përcjellur nga e kaluara në ditët tona. Tradita ngërthen atë që trashëgohet, besimin në individët, institucionet dhe praktikët e ndryshme. Pra, tradita ngërthen e gjithë atë që është trashëguar nga e kaluara në ditët tona si në rrafshin teorik ashtu edhe në rrafshin material-praktik.³

Tradita është unike, por format e saj janë të shumta, thotë Guenon. Shumësia e formave të traditës, sipas Guenon, ka të bëjë me një sërë rrethanash kohore dhe hapësinore. Në këtë kontekst ithtarët e modernizmit shpesh herë pësojnë vështirësi për të bërë një dallim të qartë ndërmjet traditës dhe zakoneve. Sepse ata shpesh herë ngatërrojnë njërin me tjetrën. Madje sipas tij në erën e modernizmit gjithçka që është larg hyjnore dhe gjithçka që përbëhet prej zakoneve emërtohet si traditë. Dhe, si pasojë vendin e traditës e zënë “traditat e reme”,

1. Rene Guenon, **Modern Dünyanın Bunalımı**, Hece Yayınları, İstanbul, 2014, fq. 9.


2. Po aty, f. 9.

3. Edward Shils, “Gelenek” (Tradita), *Doğu Batı Dergisi*, Viti: 7, Nr: 25, fq. 110.

thotë Guenon. Guenon mendon që zakoni jo vetëm që shpërfaqet si negacion i traditës, por zakonet shpesh herë paraqiten si kundërshti të traditës. Kështu përdorja tradicionale ngërthen elemente mbinjerëzore, zakonet tërësisht janë produkt i një grup veprimesh njerëzore. Shkëputja e zakoneve nga tradita ka ndikuar që zakonet të konceptohen si laike kundrejt traditës. Kështu kjo gjendje ndikon në pasivizimin e individit, mendon Gueno. Sepse, individ duke qenë i privuar nga vlerat tradicionale, të cilat në mendimin e Guenonit ngërthejnë një dozë të fuqishme të hyjnore, lehtësisht ndikohet nga ndërhyrjet e jashtme. Pra, siç shihet këtu, Guenon, traditën nuk e koncepton si një produkt thjeshtë njerëzor, por atë e ndërlidhë me ligjërimet qiellore. Më fjalë tjera, pretendon se tradita në vetvete është simbiozë ndërmjet shekullares dhe hyjnore. Ndërsa, zakonet, duke qenë tërësisht prodhime njerëzore dhe shekullore, ata nuk luajnë rolin e një mbrojtësi të denjë dhe funksional të njeriut nga ndikimet e jashtme, përkatësisht nga ndikimet e (anti)vlerave të prodhuara nga paradigma moderne. Madje Guenon shpesh herë Traditën e sheh si burimi i të gjitha shkencave, në kuptimin se traditën e koncepton si ekuivalent të religjionit.

SHKENCA (DIJA) TRADICIONALE SHKENCA PORFANE

Guenon brenda kornizave të kritikës së botës moderne bën edhe dallimin ndërmjet shkencës tradicionale dhe shkencës profane. Shkencën tradicionale, Guenon, e konceptualizon si një mishërim ndërmjet religjionit dhe arsyes, ndërsa shkencën profane (kësaj mundë t’i themi edhe laike apo shekullore) e koncepton si prodhim i pastër të arsyes njerëzore. Në këtë kontekst shkenca tradicionale merr për bazë elementin më të lartë dhe gjithmonë mëton që elementin e poshtëm të harmonizojë me elementin e lartë. Ndërsa shkenca profane merr për bazë elementin e poshtëm dhe kështu duke ngelur e kufizuar me vetveten redukton të vërtetën në pozicion e saj momental. Pra, sipas Guenon, shkenca profane duke shprehur një shkëputje epistemologjike nga shkenca tradicionale (hakikati) ka pësuar një degjenerim ontologjik dhe kështu struktura shkencore profane përbehet nga “thërrimet”. Pra, është e metë, nuk përfaqëson një tërësi. Thënë ndryshe, sot bota moderne edhe pse “krenohet” me arritjet e shkencës profane në të gjitha fushat e mundshme, në fakt shkenca e laicizuar në mendimin e Guenon nuk paraqet gjë përveç se një strukturë të përbërë nga “thërrime” të degjeneruara. Atë që kritikon Guenon është se sot shkenca moderne dhe moderniteti gjithçka është duke e reduktuar në kuantitet. Sepse kjo shkencë realisht është e privuar nga esenca dhe dimensionin ontologjik i saj.



KOMANDANTI I SHIGJETARËVE NË UHUD

ABDULLAH IBN XHUBEJR رضي الله عنه

— Mustafa Erish —

Abdullah ibn Xhubejri (r.a.), ishte një besimtar i devotshëm, i cili u nderua me Islam menjëherë pas Besëlidhjes së Parë të Akabes... Po ashtu, ai ishte një prej fatlumëve që u takua me Profetin (a.s.) në Besëlidhjen e Dytë të Akabes, ku edhe i dha besën atij... Ndërsa në betejën e Uhudit, ai ishte komandanti që i Dërguari i Allahut (a.s.), vendosi në kodrën e Ajnejnit në krye të shigjetarëve...

Ai lindi dhe u rrit në Medinë. Aty dëgjoi për ardhjen e një feje të re dhe daljen e një Profeti. Pa humbur shumë kohë, ai u ndriçua me dritën e Islamit. Emri i tij i plotë, ishte Ebu'l-Mundhir Abdullah b. Xhubejr b. en-Nu'man el-Ensari.

Ai, së bashku me shtatëdhjetë myslimanë të Medinës, shkoi në Mekë për Besëlidhjen e Dytë të Akabes. Para Besëlidhjes ai dëshiroi të takohej personalisht me të Dërguarin e Allahut (a.s.). Për këtë arsye, bashkë me disa shokë të tij, ai pyeti se ku mund ta gjente Profetin (a.s.). Kur e mori vesh se ndodhej në shtëpinë e xhaxhait të tij, Abbasit (r.a.), shkoi drejt e atje.

Kur arriti, Abdullah ibn Xhubejri kërkoi të takohej me të Dërguarin e Allahut (a.s.). Mirëpo, Abbasi (r.a.), ishte i mendimit që i Dërguari i Allahut (a.s.), duhej ta mbante të fshehtë prej kurejshëve marrëdhënien e tij me medinasit. Për këtë arsye, ai i tha atyre se me Profetin do të mund të takoheshin vetëm në vendin e quajtur Akabe. Pas kësaj, ai së bashku me shokët e tij u larguan prej aty dhe ditën tjetër, u takuan me të Dërguarin e Allahut (a.s.), në Akabe, ku edhe u besatuan.

Abdullah ibn Xhubejri (r.a.), ka marrë pjesë në betejën e Bedrit dhe në atë të Uhudit. Në betejën e Uhudit, i Dërguari i Allahut (a.s.), e vendosi atë si komandant të shigjetarëve në vendin strategjik të quajtur kodra e Ajnejnit, ku nën urdhrat e tij la afërsisht pesëdhjetë shigjetarë, duke dashur të pengojë sulmin pas shpinës së ushtrisë Islame nga ana e armikut. Urdhri i tij ishte që askush të mos e lëshonte vendin e tij në atë pozicion, duke i dhënë këtë porosi të rëndësishme historike:

“O Abdullah!.. Mbaj larg prej nesh kalorësit e

armikut (duke i goditur) me shigjeta! Pengoji ata që të mos na sulmojnë! O Abdullah!.. Sido që të shkojë puna, qoftë në favorin tonë, qoftë kundra nesh, qëndro pa lëvizur në vendin tënd, me qëllim që kalorësit e armikut të mos na vijnë nga pas shpine prej vendit ku ndodhesh ti! O Abdullah!.. Edhe nëse sheh që ne po fitojmë dhe fillojmë të mbledhim plaçkën e luftës, bëni kujdes mos ejani pranë nesh (e të lëshoni vendin)! Madje, edhe nëse shihni se ne po na hanë zogjtë, mos u largoni prej vendit tuaj pa marr lajm nga unë!” (Buhari, V, 29; Musned IV, 293; Ebu Daud, Sunen III, 51.)

Në bazë të këtij urdhri, shigjetarët nuk do të lejonin askënd të sulmonte ushtrinë Islame pas shpine. Ata do të sulmonin me shigjeta këdo që do të provonte të kalonte prej aty. Pasi i Dërguari i Allahut (a.s.), u dha urdhrat dhe porositë shigjetarëve, tha:

“Kur kalorësit e armikut të vijnë drejt jush, gjuajini me shigjeta, sepse kuajt e kalorësve nuk mund të vijnë drejt shigjetave!” Më pas, vazhdoi duke thënë:

“O Allah! Ty të kam dëshmitar për këto që po u them!” (Ibni Sa’d, II, 47; Uakidi, Megazi I, 274; M. Asim Koksall, Islam Tarihi 4/133-134.)

Beteja e Uhudit ishte e vështirë dhe e ashpër. Një pjesë e madhe e shigjetarëve, të cilët panë se vëllezërit e tyre po triumfonin, kishin filluar të largoheshin prej vendit të tyre me qëllim që të mos mbeteshin pa plaçkë lufte.

Abdullah ibn Xhubejri (r.a.), si komandat që ishte, u kujtoi atyre urdhrin dhe porosinë e të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili tha: “Edhe nëse na shihni të pësojmë disfatë dhe kuajt tanë t’i hanë zogjtë, pa ju ardhur lajm nga unë mos u largoni prej vendit!”

A e harruat se çfarë ju tha i Dërguari i Allahut (a.s.)? Ai ju tha të mos e braktisni vendin tuaj! Mirëpo, pavarësisht të gjitha përpjekjeve të mëdha që bëri, nuk arriti t’i pengojë ata.

Bera Ibn Adhib (r.a.), i cili atë ditë ndodhej në të njëjtin vend, e tregon kështu gjithçka që ndodhi:

“Atë ditë, kur u përballëm me idhujtarët, Allahu i dërmoi dhe ata ikën. Madje, unë pashë që gratë të cilat ikën drejt kodrës me shpejtësi, përveshën fustanet e tyre, aq sa iu dukën edhe rrathët që kishin vendosur në kyçet e këmbëve. Atë moment, të tanët filluan të thoshin: “Plaçkë, plaçkë!..”

Abdullah ibn Xhubejri (r.a.), vazhdoi luftën bashkë

me dhjetë veta që qëndruan me të. Ai luftoi kundër kalorësve mekas që ishin nën komandën e Halid ibn Uelidit, i cili sapo pa që shigjetarët myslimanë lanë vendin e tyre, i rrethoi nga pas me kalorësinë e tij.

Abdullahu (r.a.), e filloi luftën me shigjeta dhe, kur i mbaruan ato filloi të luftonte me heshtën e tij. Por, edhe pasi iu thye ajo, ai vazhdoi të luftonte. Në fund të luftës së tij heroike, ai ra dëshmor prej dorës së Ikrime ibn Ebu Xhehlit dhe shokëve të tij. Mirëpo, idhujtarët nuk u mjaftuan me vrasjen e Abdullah ibn Xhubejrit (r.a.), por të gjithë urrejtjen, arrogancën, zullumin dhe egërsinë e tyre e shfaqën duke e bërë copa copa trupin e këtij dëshmori.

Allahu i Madhëruar, këtë ndodhi në betejën e Uhudit e tregon kështu në Kuranin Fisnik:

“Vërtet Allahu e plotësoi premtimin e Vet, kur ju me vullnetin e Tij e thyet armikun. Por, kur ju u frikësuat, u grindët midis jush dhe kundërshtuat (Profetin a.s.), pasi Ai ju tregoi atë që pëlqenit, (Allahu e tërhoqi ndihmën e Vet). Disa nga ju dëshirojnë këtë botë, ndërsa të tjerë nga ju dëshirojnë botën tjetër. Pastaj Ai, për t’ju provuar, bëri që të zmbropseni para armikut dhe pastaj, sigurisht që jua fali atë gabim. Allahu ka mirësi të madhe për besimtarët.” (Al-i Imran, 152)

Abdullah ibn Xhubejri (r.a.), e transmeton kështu një kujtim të vetin:

“Një ditë, kur i Dërguari i Allahut (a.s.), ishte duke ecur në rrugë me një grup prej sahabëve të tij, erdhi një prej tyre dhe desh i ta mbronte Profetin prej diellit me një mbulesë. Sapo i Dërguari i Allahut (a.s.), pa hijen e mbulesës ngriti kokën dhe vuri re se atij po i bëhej hije me një çarçaf. Atë moment, i Dërguari i Allahut (a.s.), i tha atij që mbante çarçafin që ta lëshonte atë. Më pas, ai e mori çarçafin, e vuri në tokë dhe tha: «Edhe unë jam njeri si ju!»” (Hejthemi, IX, 21.)

Allahu qoftë i kënaqur me Abdullah ibn Xhubejrin!..

Allahu na bëftë të gjithëve si Abdullah ibn Xhubejri (r.a.), që edhe nëse mbetemi të vetëm, ta zbatojmë urdhrin e Profetit (a.s.), të kapemi fort pas Sunetit të tij dhe të kemi forcën ta sakrifikojmë pasurinë, jetën dhe gjithçka që kemi në rrugën e Allahut të Madhëruar! Amin!



Ndërgjegjia dhe besimi

Ferit Piku

Shumë njerëz pyesin me të drejtë: “Ç’po ndodh me moralet, të cilat po rrënohen e po shkatërrohen përditë? Pse korrupsioni po përhapet me kaq shpejtësi? Pse po vjedhin njerëzit, madje ata që janë me kostum e kollare, që janë më të shkolluar se të tjerët, më të edukuarit? Pse nuk ka më besë e amanet, pse nuk ka më burrëri, pse nuk qetësohesh tek fjala e tjetrit, por gjithmonë rri me frikë se mund të ta hedhë tjetri?”

Ajo që po ndodh është, se po shkatërrohet njeriu. Dikush thotë: “Njeriu po ha aq sa s’po i nxë më barku, pra si u prishka njeriu?!” Njeriut nuk i prishet vetëm fiziku, por ajo që po ndodh sot është, se njeriut po i prishet e brendshmjia e tij, po i prishet ndërgjegjia. Nëse prishet ndërgjegjia e njeriut, dije se është prishur vetë njeriu dhe jo vetëm një person, por gjithë shoqëria. Në momentin kur ndërgjegjia fillon e ndotet, hapi derën së keqes. Prandaj do të flasim këtu për ndërgjegjen, për amanetin më të madh që Zoti i ka dhënë njeriut, që është xhevahir në shpirtin e çdo njeriu.

Ndërgjegjia është dhuratë nga Allahu (xh.sh.). Ajo është matësja e besimit, ajo lufton me njeriun dhe i thotë: “Kujdes se kjo është e gabuar”, ajo të mban gjithmonë në tension. Ndërgjegjia është aparatura, që jep alarmin, kur bie morali i njeriut.

Ndërgjegjia është si puna e gjilpërës së busullës, e cila gjithmonë merr drejtimin e veriut, ajo është si fjala e prindit, që gjithmonë e këshillon fëmijën e tij. Ndërgjegjia është si puna e mësuesit, që këshillon

nxënësin e tij. Kjo është ndërgjegjia, prandaj edhe Zoti e merr në llogari robin e Tij, atëherë kur punon ndërgjegjia e njeriut dhe ajo fillon në një kohë të caktuar.

Fëmija nuk ka ndërgjegje, por kur njeriu arrin një moshë të caktuar, fillon e kupton të bardhën dhe të zezën e gjërave, të drejtën dhe të gabuarën. Tamam në këtë moment fillon llogaria tek Allahu (xh.sh.), këtu fillon dhe bëhesh njeri tek Zoti i gjithësisë. Imagjino një fëmijë, i cili në momentet që fillon dhe i punon ndërgjegjia, i ka mësuar të gjithë të këqijat. Ç’pritet nga e ardhmja e këtij fëmije?! Ai do t’i verë në zbatim ato që ka mësuar, prandaj le t’ua mësojmë fëmijëve tanë të mirën sa janë të vegjël, se kur të rriten do të jetë e vështirë të ndryshojnë.

Njeriu është i habitshëm. Zoti i ka dhënë atij një zemër që rreh pa pushim dhe pa e pyetur vetë njeriun, se po pushoi ajo, njeriu vdes. Zoti i ka dhënë njeriut mushkërinë, filtrin më të madh që mund të ekzistojë në tokë, që të pastrojë ajrin brenda trupit, në mënyrë që njeriu të mos helmatiset. Zoti i ka dhënë njeriut mëlçinë, e cila punon çdo moment dhe e pastron gjakun e njeriut. Zoti i ka dhënë njeriut një lëkurë, që ripërtërihet vetvetiu. Gjithashtu Zoti i ka dhënë njeriut me miliona proteina, që krijohen në çdo sekondë në trupin e njeriut dhe e gjithë kjo vetëm që të mbajë njeriun gjallë. Allahu ia ka dhënë njeriut të gjitha këto organe, të cilat punojnë pa i kurdisur njeri, sepse ato punojnë me lejen e Allahut. Por Allahu të ka lajmëruar për diçka, që

duhet ta ruash e ajo është ndërgjegjja jote. Kujdesu për të, që të mos bëhet pis, që të mos njolloset, që të mos shkojë drejt vdekjes. Nëse ndërgjegjja është e shëndetshme dhe e fortë, ti do të ndjesh gjithmonë lumturi.


Kur e pyetën Profetin (a.s.), se ç'është puna e mirë dhe ç'është puna e keqe, ai (a.s.) tha: "Puna e mirë është ajo, me të cilën nefsi ndjehet rehat dhe shpirti është i qetë. Puna e keqe është ajo, me të cilën nefsi nuk ndihet rehat dhe shpirti nuk është i qetë".

Ç'probleme ndodhin kur priset ndërgjegjja?! Për Zotin është rreziku më i madh që mund të ekzistojë. Aty ku priset ndërgjegjja, aty fillon padrejtësia, aty fillon mashtrimi. Njeriu do të zgjidhë një problem tek gjykata, por nuk ndihet i qetë, sepse drejtësia nuk ndodhet në tekstin e ligjit, por në ndërgjegjen e gjykatësit, prandaj njerëzit sot nuk kanë besim tek shteti e tek drejtësia edhe pse dikush mund të jetë veshur me rrobën e drejtësisë. Ndërsa gjykatësi i drejtë dhe i ndërgjegjshëm mundohet të vendosë drejtësinë, edhe pse ligji mund të jetë i keq.

Kur priset ndërgjegjja, shkatërrohet familja. Burri nuk ka më turp të merret me marrëdhënie të jashtëligjshme dhe të harrojë familjen, gruan dhe fëmijët e tij. Nga ana tjetër edhe gruaja nuk ka turp dhe mundohet ta zbukurojë trupin e saj jo për burrin e saj, por për njerëzit e tjerë. Këtu fillon problemi. Kur priset ndërgjegjja e bashkëshortëve, nuk ka qetësi familjare. Gjithmonë ka dyshime, ka fanatizëm, secili akuzon tjetrin dhe kështu fillon shkatërrimi i familjes.

Kur priset ndërgjegjja, njeriu bie më poshtë se kafshët. Kjo krijesë kaq e nderuar bie poshtë kafshëve dhe kafshët janë të nderuara në krahasim me njeriun, që nuk ka ndërgjegje të pastër. Për çdo ditë po ndodhin mëkate dhe fenomene, prej të cilave habiten njerëzit e tjerë. Mëkati më i madh, të cilin e ka përmendur Kurani, ka qenë mëkati i popullit të Lutit (a.s.). Ai ishte popull homoseksual, ku kryheshin marrëdhënie burrë me burrë. Për këtë mëkat Zoti shkatërroi komplet një vend dhe e përmbysi atë. Po sot ç'ndodh vallë?! Sot kjo nuk përbën aspak problem për njerëzit, madje quhet modernizëm dhe tolerancë. Sot po ndodhin gjynahe dhe njeriu vetë nuk e di sesi ndodhin ato. Jam habitur kur dëgjova sesi 7000 burra dhe gra kishin hyrë në një konkurs për të pozuar nudo, siç i ka lindur nëna e tyre, vetëm për faktin se do të fotografoheshin nga fotografi më i njohur i botës. 7000 persona u futën në këtë garë, por vetëm 1200 vetë fitojnë. Çdokush që i shikon, i thotë vetes: "A janë njerëz këta apo çfarë janë"? Vallahi janë njerëz

*Njeriu është i habitshëm.
Zoti i ka dhënë atij një
zemër që rreh pa pushim
dhe pa e pyetur vetë njeriun,
se po pushoi ajo, njeriu
vdes. Zoti i ka dhënë njeriut
mushkërinë, filtrin më të
madh që mund të ekzistojë
në tokë, që të pastrojë ajrin
brenda trupit, në mënyrë që
njeriu të mos helmatiset.*



dhe nuk është puna se nuk kanë se çfarë të veshin, pasi garderobat e tyre po çahen nga volumi i madh i rrobave, por janë të zhveshur nga turpi dhe nga ndërgjegjja. Ata janë shumë të arsimuar. Ka mes tyre intelektualë, mjekë, inxhinierë e avokatë, por çështja nuk ka të bëjë me arsimimin, por me moralin dhe ndërgjegjen e tyre. Atëherë a nuk e kanë ulur veten këta njerëz më poshtë se kafshët?! Kafsha ka turp ta bëjë diçka të tillë, sepse Zoti i ka dhënë instinktin për ta mbrojtur veten, madje të gjitha kafshët kanë një bisht, me të cilin mbulojnë vendet e tyre të turpshme. Ndërsa kur njeriu, kjo krijesë kaq e bukur bie në këtë pikë, ky është tregues se është prishur ndërgjegjja dhe njeriu verbohët. Kur ti verbohesh, atëherë nuk je ti që e kontrollon veten, por dije se po të drejton shejtani i mallkuar, tamam si kalaja pa ushtarë në të cilën hyn e del dhe askush nuk të thotë se ku po shkon. Ky është njeriu me ndërgjegje të prishur.

Kur prishet ndërgjegjja, nuk ka më besim e siguri. Del nga shtëpia dhe rri e mendon se mos vjen dikush e të vjedh shtëpinë, ikën nga puna e të shkon mendja se mos ta vjedh dikush dyqanin, hyn në autobus dhe i mban duart në xhepa, nga frika se mos të vjedhin portofolin. Njeriu nuk ndihet i qetë, në një kohë që qetësia është baza e gjërave. Nëse nuk ka qetësi, njeriu nuk e zë gjumi natën, nuk i hahet bukë e nuk i pihet ujë. Prandaj si dënim për ata që kanë vendosur ta shkelin me këmbë ndërgjegjen, Zoti ua merr qetësinë dhe ata asnjëherë nuk ndihen rahat.

Nëse sot ka sëmundje që kanosin njerëzimin, më e madhja prej tyre është shkatërrimi i ndërgjegjes. Prandaj besimtari le ta ketë frikë Zotin në ndërgjegjen e tij dhe le të kontribuojmë për të ndërgjegjësuar të tjerët, sepse kur vjen e keqja, i përfshin të gjithë me radhë.

Po çfarë mund ta rregullojë ndërgjegjen e njerëzve, e cila qenka baza e zhvillimit?! Atë mund ta rregullojë vetëm besimi tek Zoti i gjithësisë. Besimi është si gjeneratori, që i jep dritë ndërgjegjes dhe ku ka ndërgjegjshmëri, aty jeta është më e ëmbël, më e bukur, më e qetë. Si mund të mos ketë ndërgjegje të pastër ai njeri, që ka frikë Allahun (xh.sh.). Ai e di se në çdo moment është nën mbikëqyrjen e Zotit të gjithësisë edhe sikur të jetë i vetëm në mes të natës. Ky njeri është nën kontrollin e Zotit kudo që të jetë.

Ai njeri që beson se një ditë do të japë llogari për çdo punë, ai nuk mund ta prishë kurrë ndërgjegjen e tij. Prandaj Umer Ibn Hattabi (r.a.) thoshte: “Pasha Zotin, sikur të mos ishte dita e Fundit, do të shikonit një Umer tjetër nga ky që shihni sot”. Një person ishte 60 vjeç dhe ai po llogariste veten e tij duke thënë: “60 vite janë më shumë se 21.600 ditë. Imagjino sikur të kem bërë vetëm një gabim për çdo ditë. Do shkoj tek Zoti me 21.600 gabime. Ndërsa unë bëj me dhjetëra e me qindra gabime në ditë. Atëherë si do të dal përpara Allahut (xh.sh.)”? Ky është besimi në ditën e Fundit, prandaj besimtari e kontrollon veten dhe ndërgjegjen e tij.

Nuk ka më mirë sesa kur ndërgjegjja fillon të funksionojë. Njeriu e fal namazin pa dajak. Kush i sjell myslimanët në xhami? A mos vallë kërcënimi i ndonjë njeriu?! Myslimanët i sjell në xhami vetëm ndërgjegjësimi për detyrimet që kanë ndaj Zotit dhe frika ndaj Tij. Çfarë e shtyn besimtarin të japë zekatin fshehurazi? Dijeni se është shumë e rëndë për njeriun ta bëjë një punë të mirë e të mos e marrin vesh të tjerët. Ndërsa besimtari mundohet ta fshehë zekatin e tij, sepse është ndërgjegjja e tij e fuqishme që e shtyn ta bëjë atë veprim. Vetëm ndërgjegjja e pastër është ajo, që e shtyn njeriun të bëjë punë të mira, ajo që i jep njeriut jetë.

Thonë se në vitin e urisë, kur njerëzit nuk kishin bukë për të ngrënë, Umeri (r.a.) hante vetëm bukë me vaj, saqë lëkura iu nxi. Njerëzit i thanë: “Kij mëshirë

për veten tënde o prijësi i besimtarëve, ndërroje ushqimin”. Ndërsa ai tha: “E si të mos kem frikë Allahun (xh.sh.), si mund ta ndryshoj ushqimin, kur popullim im ha më keq se unë?”

Kur Aliu (r.a.) ishte halife, i humbi mburoja dhe akuzon një të krishterë që ia kishte marrë atë. Aliu (r.a.) shkon tek gjykatësi, të cilin e kishte vendosur vetë në atë post dhe i ankohet se i krishteri i kishte vjedhur mburojën. Mirëpo i krishteri tha, se mburojën nuk e kishte vjedhur, pasi ishte mburoja e tij. Atëherë gjykatësi i thotë imam Aliut (r.a.): “A ke argument për këtë që thua”? Aliu (r.a.) tha: “Jo vallahi nuk kam argument”. Kështu që mburoja i mbetet të krishterit, i cili largohet me kokën ulur, por pas pak kthehet dhe thotë: “Vallahi këto nuk janë ligjet e njerëzve, por janë ligjet e Zotit. Mburoja



*Nëse sot
ka sëmundje që
kanosin njerëzimin,
më e madhja prej tyre
është shkatërrimi i
ndërgjegjes. Prandaj
besimtari le ta ketë frikë
Zotin në ndërgjegjen e tij
dhe le të kontribuojmë
për të ndërgjegjësuar të
tjerët, sepse kur vjen e
keqja, i përfshin të gjithë
me radhë.*

është e imam Aliut. Unë ia mora kur i ra përtokë, ndërsa po shkante në luftë. Unë sot e pranoj fenë islame”. Atëherë Aliu (r.a.) i tha: “Mbaje pra se ta kam falur mburojën”.

Umer Ibn Abdulazizi ishte pasanik i madh, por gjithë pasurinë e tij dhe të bashkëshortes së tij ia ktheu myslimanëve. Thonë se ky njeri që dikur nuk i matej pasuria, rrinte me një rrobë, madje shpeshherë nuk dilte nga shtëpia duke pritur që t'i thahej rroba e tij e vetme, që pastaj ta vishte. Puna arrinte deri aty, sa që kur dikush i vinte për të zgjidhur ndonjë hall, ai i thoshte: “A ke ardhur për hallin tënd e të ndez qiriun tim, apo ke ardhur për ndonjë punë shteti e të ndez qiriun e shtetit”. Aq shumë punoi ky njeri për fenë e Zotit, sa që dikush i tha: “Zoti ta shpërbleftë për atë që ke bërë për Islamin”. Por ai ia ktheu: “Mos thuaj kështu, por thuaj: “Zoti ia shpërbleftë Islamit, se çfarë ka bërë për mua”.

Këta njerëz kishin besim tek Zoti dhe e pastruan veten e tyre. Ata kishin ndërgjegje shumë të fortë.

Një figurë shumë e shquar, Volteri, u thoshte njerëzve: “Ju që nuk besoni tek Zoti, po bëni një krim. A e dini se po e mësoni gruan time të më tradhtojë mua e po mësoni shërbëtorin tim të më mashtrijë. Po të mos kishte Zot, mua do të më tradhtonte gruaja e do të më mashtronte shërbëtori. Por shqyr ka Zot, ka edhe fe, prandaj ka frikë gruaja ime, ka frikë shërbëtori im, kam frikë edhe unë”.

Ata njerëz që urrejnë fenë e Zotit, ata prindër që nuk duan që fëmija i tyre të mësojë fenë, le ta dinë se i bëjnë gropën vetes së tyre, sepse do të vijë koha kur do ta ndjejnë shijen e hidhur të veprës së tyre, pasi vetëm besimi tek Allahu (xh. sh.) e mban njeriun në këtë jetë.

Fëmija është gjëja më e shtrenjtë që ka njeriu, i pasur apo i varfër, i mirë apo i keq qoftë ai. Ai njeri nuk do, që femja i tij të jetë i keq. Prindi mundohet ta edukojë fëmijën e tij. Dikush e edukon me dhunë, por historia dhe jeta kanë treguar, se fëmija nuk edukohet me dhunë, pasi do të vijë një kohë që nuk do ta ketë afër prindin e tij për ta edukuar. Dikush mendon se për një edukim të mirë, fëmija duhet të lihet i lirë të bëjë çfarë të dojë, por edhe këta prindër e kanë provuar se ç'po heqin me fëmijët e tyre. Atëherë çfarë e rregullon fëmijën,

që edhe prindi të jetë i lumtur me atë fëmijë?! Të gjithë prindërit duhet të edukojnë ndërgjegjen e fëmijës, t'i mësojnë të jenë të ndërgjegjshëm se diçka e caktuar është gabim dhe nuk duhet bërë. Nuk duhet t'i themi fëmijës: “Mos e bëj këtë, se nuk i pëlqen babit apo mamit”, sepse kur të mos i ketë prindërit, ai do t'i bëjë ato veprime që nuk duhen bërë. Mos i thuaj kurrë fëmijës tënd: “Mos e bëj këtë, se nuk i pëlqen shoqërisë”, sepse do të vijë një kohë që do të ndryshojë shoqëria, por edukojë fëmijën tënd duke i thënë: “Bëje këtë, se e pëlqen Allahu dhe mos e bëj këtë tjetrën se nuk e pëlqen Allahu”. Nëse e edukojmë fëmijën me këtë ndërgjegje, duke e ushqyer me besimin tek Allahu (xh.sh.), hidhe ku të duash këtë fëmijë dhe dije se ai nuk humbet kurrë, pasi Zoti e shikon atë në çdo vend. Kur njeriu njeh Zotin, ai e kontrollon veten, ndërgjegjen e tij.

Tregohet se kur Umeri (r.a.), u bë halifja (prijësi) i myslimanëve, dilte natën të shikonte se ç'bëjnë njerëzit. Një natë ai dëgjon një zë nënë, që i fliste fëmijës së saj duke i thënë: “Shtoji ujë qumështit, që të shesim më shumë nesër”. Vajza e saj i thotë: “O nënë, çfarë po bën kështu, kjo nuk është punë e mirë”. Nëna i thotë: “A mos ke frikë Umerin. Ai nuk na shikon tani, ai është në gjumë”. Mirëpo fëmija i thotë: “O nënë Zoti i Umerit dhe Zoti ynë nuk fle kurrë! Nëse Umeri nuk na sheh, dije se na sheh Zoti, prandaj mos e bëj këtë punë”. Kur Umeri (r.a.) e dëgjoji këtë, tha: “Falënderoj Zotin që ka bërë nga umeti i profetit (a.s.) fëmijë, që e

kanë frikë Zotin”. Ata fëmijë që edukohen me frikën ndaj Zotit, ata do të bëjnë përpara, ata do ta nxjerrin shoqërinë nga errësira në dritë.

E lus Zotin e gjithësisë me mëshirën e Tij të pafund, t'i mëshirojë fëmijët tanë, t'i forcojë zemrat tona të dobëta. O Zot, na e trego rrugën e drejtë ashtu siç është ajo e na jep forcë ta ndjekim atë, na e trego rrugën e keqe ashtu siç është ajo e na jep forcë të largohemi prej saj. O Zot mos na lër në dorë të vetes tonë as sa hap e mbyll sytë. Zoti i pastroftë zemrat tona dhe ndërgjegjet tona. Zoti na mundësoftë ta jetojmë jetën si myslimanë, ta japim shpirtin si besimtarë e të na ringjallë bashkë me Profetin (a.s.).

Amin!..



Kur priset ndërgjegjja, njeriu bie më poshtë se kafshët. Kjo krijesë kaq e nderuar bie poshtë kafshëve dhe kafshët janë të nderuara në krahasim me njeriun, që nuk ka ndërgjegje të pastër.



Zhvillimi i aftësisë së perceptimit TË RREZIKUT *tek fëmijët*

As. doç. dr. Engin Eker

Fëmijët dhe rreziqet që mund t'i kanosen atyre zënë një vend shumë të madh në mendjen e prindërve. Rritja e fëmijës përmban në vete shumë qëllime, disa prej tyre janë: vazhdimi i racës njerëzore, dëshira për ta shikuar të ardhmen me siguri, dëshira për të lënë pas diçka të mirë prej vetes...

Të gjithë këtyre motivacioneve duhet t'i shtojmë një pikë shumë praktike: një prej qëllimeve të rritjes së fëmijës është dëshira për t'i përgatitur fëmijët për botën reale. Sa më mirë që të kalojë periudha e përgatitjes aq më të lehtë do ta ketë fëmija që të përshtatet me botën e jashtme.

Bota e jashtme i afrohet fëmijëve tanë së bashku me zbulime të reja dhe me objekte e njerëz të panjohur. Nëse thellohemi në lidhje me marrëdhëniet që krijon fëmija me botën e jashtme, mund të themi se lidhja nënë-fëmijë është e para dhe më e rëndësishmja prej tyre. Gjatë seancave të ushqyerjes fëmija fillon të njohë trupin, aromën dhe interesin e nënës. Të gjitha këto studime bëhen në një mjedis të sigurtë dhe fëmija me anë të nënës së vet, fillon që të njohë botën e jashtme. Një nënë e paprekur nga fatkeqësi të jashtme, si për shembull tërmeti, nuk ka asnjë pengesë për t'ia kaluar

fëmijës së vet të gjithë energjinë e brendshme që ka brenda vetes. Në fund të fundit, teksa fëmija zbulon nënën, edhe kjo e fundit zbulon fëmijën së bashku me sjelljet e tij, limitet emocionale dhe gjestet e ndryshme...

Ky është një vallëzim i shenjtë mes nënës dhe fëmijës që me kalimin e kohës do të gjejë ritmin e vet perfekt.

Viti i parë pas lidhjes është shumë i rëndësishëm, sepse nëna dhe fëmija duhet të mësojnë si të kërcejnë pa i prekur këmbët njëri-tjetrit dhe pa e humbur sensin e muzikës. Ky kërcim do u mësojë besimin, dashurinë dhe respektin për njëri-tjetrin.

Nëse duam që fëmija të ketë interes dhe dëshirë për të njohur botën e jashtme, duhet t'i japim prova se atë e presin gjëra që ia vlejnë të zbulohen. Nëse fëmija ka një marrëdhënie pozitive me nënën e vet do të mendojë se bota që fshihet pas saj, është diçka e bukur dhe tërheqëse.

Ashtu si qartësohet edhe nga një prej themelueseve të psikanalizës, Margaret Mahler (Mahler, M.S & La Perriere, K. (1965) *Mother – child interaction during separation- individuation*. *Psychoanal Q.* 34: 483-498) fëmija i moshës një vjeçare që deri atë herë ka qënë në një botë të mbrojtur dhe të lumtur, fiton ndërgjegje në momentin kur merr sigurinë për t'u ndarë nga nëna dhe interesin që ka pasur ndaj saj, ia drejton botës së jashtme. Në këtë pikë, ka shumë rëndësi që fëmija ta dijë se nëna nuk e ka braktisur atë dhe se është pranë tij për ta mbrojtur kur ka nevojë. Fakti që nëna e do dhe e mbron fëmijën kur ai është duke zbuluar objektet e panjohura që e rrethojnë, do ta forcojë ndjenjën e tij të zbulimit. Gjithsesi, të mos harrojmë se duhet t'i lëmë fëmijët të lirë për t'u përballuar me problemet që kanë. Kjo e ndihmon atë që të krijojë një karakter të shëndoshë.

Individi, i cili, që i vogël e ka gjetur vetë se çfarë të bëjë në një moment të caktuar, rrit probabilitetin për t'u përballur me sukses me vështirësitë e jetës si i rritur.

Në klinikë punojmë me fëmijë që nuk e pranuar asnjëherë dyshimin ose që nuk janë mësuar të kenë besim tek vetja. Shumë fëmijë që para çdo situatë të panjohur heqin dorë me frikën “unë nuk e bëj dot këtë gjë!”, nuk e dinë se njeriu mëson duke bërë gabime.

Nëse duhet të kthehemi tek tema e shkrimit

tonë, “perceptimi i rrezikut”, do të shohim se kjo është një prej gjërave që i bllokton fëmijës dëshirën për të zbuluar botën. Prindërit që dëshirojnë t'i rrisin fëmijët në një botë ëndrrash, që nuk durojnë dot tek i shohin fëmijët duke vuajtur dhe që nuk dëshirojnë që fëmija të ketë as vështirësinë më të vogël; e marrin në siguri të gjithë shtëpinë.

Nëse kemi garancinë se fëmija jonë kur të rritet do të jetojë në një jetë ëndrrash, do të ishte e kuptueshme kjo sjellje, por e dimë mirë që një gjë e tillë nuk është aspak e mundur. Fëmijë që rriten pa qenë gati për realitetin e botës së jashtme nuk kanë shumë shanse për të qenë të suksesshëm në botën reale. Këto fëmijë që janë mësuar të kenë mbështetje të plotë nga të njerëzit e familjes, e presin këtë mbështetje edhe nga njerëzit e tjerë dhe kjo bëhet pengesë për njohjen e kapacitetit të tyre të vërtetë.

Kemi disa lloje të marrëdhënieve që krijojnë fëmija me nënën. Nëna e pasqyron botën e jashtme si të mbushur me vështirësi e probleme të pakapërcyeshme e të frikshme; në këtë mënyrë fëmija është tepër i trembur për të njohur botën e jashtme dhe tërhiqet nga zbulimi duke u ndjerë i dobët si moralisht ashtu edhe fizikisht. Nganjëherë, nënat nuk kanë dëshirë ta pranojnë se fëmijët tashmë nuk ia ndejnë dhe aq shumë nevojën. Për këtë arsye, ndalojnë dëshirën zbuluese të fëmijës dhe për asnjë moment, nuk e lejojnë fëmijën që të largohet. Ndërkohë fëmijët largohen nga zbulimet për hir të ndihmës që i jep nëna duke e filluar jetën pa asnjë eksperiencë. Mënyra më e mirë për t'i mësuar fëmijët me përballimin e vështirësive të jetës është duke i mësuar ato se pengesat nuk janë të pakalueshme. Në këtë temë atyre mund t'i jepen shumë këshilla praktike.

Prindi duhet të kalojë përtej shpjegimit teorik të termit “rrezik” duke i folur fëmijës për gjërat e rrezikshme me të cilat është përballur më përpara dhe si i ka kaluar ato. Në vend që t'i tregoni merakun që keni për të, tregoni që doni vetëm sigurinë e tij; në vend që ta qortoni, tregoni se çfarë mund t'i ndodhë nëse nuk është i kujdesshëm.

Eksperiencia me disa rreziqe të vogla (jo të tepërta) mund të jetë të dobishme për fëmijën tuaj. Në këtë mënyrë ai do të shikojë se cilat janë aspektet negative të jetës. Në vend që ta frikësoni fëmijën me botën e jashtme, tregoni se cilat janë anët pozitive dhe negative të saj. Këto do të kenë shumë dobi për fëmijën i cili do të mund të kuptojë se çfarë e pret dhe si duhet të silltet.



A duhet të punojë GRUAJA?

— Fatma Nur Xhihan —

Fakti që gratë, të cilat përbëjnë pothuajse gjysmën e shoqërisë, janë joaktive, nuk marrin pjesë në asnjë mënyrë në jetën e punës, sigurisht që nuk duhet të mendohet dhe nuk është menduar... Gjatë gjithë historisë gratë kanë punuar në punë të vështira krahu dhe akoma vazhdojnë të punojnë në shtëpi, fusha dhe në një mijë e një punë të tjera. Atëherë, si duhet ta drejtojmë pyetjen? “A duhet të punojnë gratë në kushte të barabarta me burrat, në lloj-lloj punësh të cilat i duan ose nuk i duan dhe në mënyrë të veçantë jashtë shtëpisë?”

TË PUNUARIT E GRUAS JASHTË AMBIENTIT TË SHTËPISË

Po, në fakt kjo është pyetja që bëhet këto dyqind vitet e fundit. Çështja, përveç “punësimit të gruas” është “punësimi i gruas jashtë shtëpisë”. Pse kërkojnë gratë të punojnë jashtë shtëpisë? Mos vallë ngaqë kanë mbaruar punët e shtëpisë? Apo i lënë punët e shtëpisë dhe kërkojnë të punojnë në punë të tjera të pastra jashtë shtëpisë? Kush do t'i bëjë punët e tjera të shtëpisë, ndërkohë që gruaja punon jashtë? Nëse duhet me patjetër të punojë, çfarë e pengon të punojë në shtëpi në vend që të punojë jashtë?

Pyetjet janë të shumta... Njëra më e rëndësishme se tjetra... Para se të kalojmë te dispozitat e Islamit mbi gruan dhe punën së saj, duhet të shohim shkurtimisht punën e gruas në shoqërinë perëndimore, e cila është origjina e botës moderne

të ditëve të sotme.

GRUAJA PERËNDIMORE NË MESJETË

Sipas librit të shenjtë që është falsifikuar, thuhet se gruaja ka bashkëpunuar me djallin, pastaj ka mashtruar Hz. Ademin dhe është bërë shkak që njerëzimi të zbresë nga Parajsa në tokë. Prandaj Zoti e ka ndëshkuar gjininë femërore me “shtatzëni” dhe “menstruacione”. Për këtë arsye, priftërinjtë e konsiderojnë qëndrimin larg femrave si shkak për t'u afruar te Allahu dhe për këtë arsye e kanë ndaluar martesën.

Menjëherë duhet ta bëjmë të qartë se Islami e ka ndaluar këtë këndvështrim ndaj gruas. Sipas Kuranit Famëlartë, Hz. Ademi dhe Hz. Havaja i janë afruar së bashku pemës së ndaluar dhe po së bashku e kanë kryer këtë mëkat. Prandaj ky mëkat nuk është një mëkat që ka kaluar nga babai te i biri apo nga nëna te e bija dhe nuk ka ndëshkim. Çdo njeri lind nga nëna e tij krejt i pastër dhe vjen në jetë me një natyrshmëri pa mëkate. Besimi në krishterim se Hz. Isai me flijimin e tij u mundua të shpëtonte njerëzimin dhe priftërinjtë që me ujin e pagëzimit kërkojnë të pastrojnë “mëkatën që trashëgohet nga Hz Ademi dhe që vjen që nga lindja”, është mohuar plotësisht në Islam.

Në Evropë gjatë mesjetës gruaja quhej “element fitneje (përçarjeje)”, “ndërmjetës i djallit”, “e mallkuar”; prandaj nuk ishte e përshtatshme që ajo të hynte në kishë apo sinagogë. Shpeshherë gratë

magjistare ndëshkoheshin duke u djegur në vende të hapura, në mënyrë që të pastrohen nga xhindët dhe djajtë që kanë brenda.

Gruaja, në shtëpi është nëna e fëmijëve dhe në arë është ndihmësja e burrit. Ndërsa për gratë të cilave u ka vdekur bashkëshorti dhe janë të detyruara të fitojnë dhe të rrisin fëmijët e tyre, “punësimi” është i kufizuar. Për fat të keq, për shkak të nevojave, pas një kohe detyrohen ta kthejnë në kapital gjënë e tyre me të shtrenjtë, trupin. Ndërsa, kur mbaron rinia dhe bukuria, ngel e mjeruar dhe e pikëlluar.

Kjo gjendje vazhdon kështu deri në shekullin e njëzet pas dy periudhave të njëpasnjëshme, “Epo-ka e Industrializimit” dhe “Luftërat Botërore”. Në kohën e industrisë mashkulli perëndimor zbuloi “punëtorin e lirë”: Gruan dhe fëmijën... Duke u dhënë këtyre të fundit gjysmën e parave, madje edhe më pak se gjysmën që do t’i jepte një burri, ua ka vënë mbi shpatulla përgjatë shekujve të gjithë barrën e industrisë së perëndimit modern.

Madje nuk bëjmë fjalë për punën e skllëvërve me të cilën mundoheshin të mbushnin barkun dhe aty ku vdisnin shtroheshin asfalte e rrugë... Sepse skllëvërit nuk quheshin as “njerëz”.

GRUAJA NË ISLAM

Gjendja e gruas në shoqërinë e xhahilijetit (injo-rancës) nuk ndryshonte nga ajo e “ehli kitabit”, pra çifutëve dhe të krishterëve. Në ato kohë ajo ishte një krijesë që shitej e blihej si plaçkë, nënçmohej, madje edhe vritej pa shkak. Nëna ndoshta edhe mund të respektohej pak, por gratë që mbanin statusin “bashkëshorte” ose “vajzë” nuk e meritonin në asnjë mënyrë respektin.

Islami erdhi në një kohë ku shoqëria turpërohej nga vajzat. Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, vajzës së tij të parë i vuri emrin Zejnep, që do të thotë “stolia e babait”. Ashtu siç festohej dhe pritej kurban kur lindte një djalë, edhe Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, festonte, priste kurban dhe gëzonte me ta kur njoftohej për lindjen e një vajze.

Ndërkohë që arabët kërkonin pretekst për të zhdukur vajzat e tyre, Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ndihej krenar me vajzat e tij. Ai (s.a.s.), kurrë nuk mendoi t’i varroste ato të gjalla dhe kur i zbritën me anë të Xhebrailit (a.s.), parimet e Islamit, e çrrënjosi këtë zakon gjakatar të xhahilijetit.

Islami i dha gruas një pozitë në të cilën zotëron-te një identitet dhe respekt të plotë ligjor. Gruaja tashmë zotëronte reputacion dhe kishte të drejtën e “zgjedhjes” dhe “kundërshtimit” kur bëhej fjalë për martesë. U lejua që të martohej me dikë që e kërkonte brenda masave ligjore. Pasuria që posedonte para dhe pas martesës u kalua plotësisht

mbi të. U hoq detyrimi i fitimit të të ardhurave të familjes nga ana e gruas së martuar edhe sikur bashkëshorti i saj të ishte nevojtar. Gruaja u lejua që, nëse dëshironte dhe nëse kushtet ishin të përshtatshme, të bënte tregti duke shfrytëzuar pasurinë e saj për ta shtuar atë. Gjithashtu iu dha e drejta për të pasur pjesë nga trashëgimia.

Edhe pse janë hedhur shumë shpifje dhe akuza deri më sot se “gratë në Islam marrin pjesë nga trashëgimia sa gjysma e pjesës që marrin burrat”, kjo buron nga mosnjohja e plotë e çështjes. Duke u mbështetur te rëndësia e saj, këtu e shohim të nevojshme të hapim një parantezë.

SI E TRAJTON ISLAMI PJESËN E GRUAS NË TRASHËGIMI?

Ndërsa Kurani Fisnik bën të ditur dispozitat e trashëgimisë, i cakton gruas një pjesë sa gjysma e asaj që merr burri. Kjo gjendje mbështetet në një ekuilibër të mrekullueshëm mes drejtësisë hyjnore dhe të drejtave/detyrave njerëzore. Në këtë mënyrë:

Sipas Islamit, gruaja zotëron çdo gjë që ka sjellë nga shtëpia e babait dhe nuk është e detyruar ta ndajë atë me bashkëshortin e saj. Në të njëjtën mënyrë, çdo dhuratë që i është bërë para ose gjatë martesës, i takon asaj. Për më tepër, gruas i është dhënë një garanci me “mehr” masën e të cilit e cakton ajo vetë dhe që për të përbën “një sigurim shoqëror”.

Pas martesës gruaja është e qetësuar, pasi të gjitha nevojat e saj duke filluar nga ushqimi, strehimi, veshja etj., në masë normale përballohen nga bashkëshorti. Sikur gruaja të jetë trilionere me pasurinë e saj personale dhe bashkëshorti i saj të punojë me pagë minimale të ditëve të sotme, ai burrë është i detyruar t’ia plotësojë të gjitha nevojat gruas në rrugë hallall. Gruaja nuk është e detyruar të paguajë nga pasuria e saj për mbështetje familjare apo për të lehtësuar barrën e burrit, vetëm nëse ajo dëshiron ta bëjë këtë për virtytin dhe lumturinë e familjes...

Përveç kësaj, gruas i janë dhënë shumë të drejta edhe në punët brenda shtëpisë. Të kujtojmë njërën nga këto, dispozitat islamike të së cilës nuk janë shumë të njohura. Për shembull, nëse një grua nuk dëshiron ta ushqejë me gji fëmijën që ka lindur, sipas ligjit islam, babai i fëmijës është i detyruar të gjejë nënë qumështi për të. Siç shihet edhe në këtë shembull, Islami pothuajse i ka dhënë femrës



një “pozitë të veçantë” dhe i ka falur të gjithë lirinë ekonomike duke i hequr nga supet çdo lloj barre materialo-shpirtërore që mund ta mundojnë atë.

Nëse një gruaje i vdes bashkëshorti, krahas trashëgimisë që do të marrë nga ai, nevojat e saj minimale janë të detyruar t’ia plotësojnë njerëzit e saj më të afërt si babai, gjyshi, vëllai, xhaxhai, daja etj. Nëse ajo nuk ka asnjë të afërm që ta mbikëqyrë, shteti islam është përgjegjës për plotësimin e çdo lloj nevoje të asaj gruaje dhe familjes së saj.

Gruas, e cila është marrë nën një mbrojtje kaq të fortë, të cilës i është dhënë mundësia për ta përdorur dhe për ta shtuar pasurinë e saj si të dëshirojë, e cila merr mehrin, paratë e jetesës e të ardhurat e tjera nga burri dhe së cilës i janë siguruar nevojat e tjera duke u marrë nën mbrojtjen e të afërmeve pas vdekjes së burrit, sikur t > i jepej e plotë edhe pjesa e trashëgimisë, atëherë situata do të kthehej kundra mëshkujve dhe do të prishte ekuilibrin.

Sepse, siç e shpjegoam edhe më lart burri, përveç shpenzimeve të martesës (dhurata, gosti, mëhër etj.), është përgjegjës edhe për përbalimin e të gjitha shpenzimeve të bashkëshortes dhe fëmijëve dhe këtë furnizim duhet ta bëjë në rrugë hallall. Përveç kësaj, ai duhet t’ua plotësojë nevojat edhe nënës, motrës ose ndonjë prej të afërmeve që ka mbetur vetëm.

Një përgjegjësi të tillë burri mund ta përballojë me dy burime financiare: me paratë që fiton nga puna e krahut dhe me pjesën që i caktohet nga trashëgimia... Ja pra kjo është logjika e trashëgimisë në Islam.

SIPAS ISLAMIT, A DUHET TË PUNOJË GRUAJA?

Në fakt, në pjesën e mëparshme shprehëm se të gjitha nevojat e gruas duhet të përballohen nga bashkëshorti. Prandaj nuk mund të mendohet që burri ta detyrojë bashkëshorten e tij të punojë për të fituar të ardhurat e familjes apo për të mbledhur më shumë para. Së pari, kjo është detyrë e burrit. Po nëse gruaje dëshiron të punojë, çfarë duhet të bëjë?

Faktikisht kjo gjendje shfaq ndryshime nga një person te tjetri, nga një familje te një tjetër. Prandaj është e vështirë të thuash për secilën grua “duhet të punojë” ose “nuk duhet të punojë”. Në këtë çështje shumë kriterë si: edukimi, statusi shoqëror, aftësitë, nevojat, struktura e familjes, fëmijët, kriteret e vendit të punës, kushtet e orarit të punës, ambienti shoqëror etj. bëhen shkak për ndryshime të rëndësishme.

Por në linja të përgjithshme mund të vizatojmë një tablo të tillë: Nëse një nënë ka fëmijë të cilët kanë nevojë për përkujdesje dhe nuk ka ndonjë njeri tjetër që mund të kujdeset për ta, detyra e saj e parë është kujdesi për fëmijët dhe

shtëpinë, sepse Allahu Teala nuk e ka bërë atë përgjegjëse për fitimin e të ardhurave familjare, por për rritjen dhe edukimin e fëmijëve. Por, nëse nuk ka fëmijë apo ka ndonjë të afërm të besueshëm që mund të kujdeset mirë për fëmijët që ka, duke marrë edhe aprovimin e bashkëshortit, mund të punojë në punë “të ligjshme” dhe që i përshtaten natyrshmërisë së saj.

PUNËT E LIGJSHME DHE TË PËRSHTATSHME PËR NATYRSHMËRINË E GRUAS


Në të vërtetë, ky titull është një shprehje me përmbajtje shumë të gjerë. Natyrshmëria e gruas nuk është e njëjtë me atë të burrit. Burrat janë krijuar të punojnë më shumë në punët jashtë shtëpisë. Nëse gruaje punon në punë të rënda, që kanë shumë stres, në kushte të lodhshme orari, me kalimin e kohës kjo bëhet shkak për shqetësime të mëdha te ajo. Për shembull të mendojmë gratë që punojnë në fabrikën e qymyrit ose ato që bëjnë rrugë të gjata dhe të lodhshme me kamionë. A është e përshtatshme për këtë natyrshmëria (krijimi) e gruas?

Ata që thonë se “gratë dhe burrat janë të barabartë”, duhet të dinë se edhe në olimpiada gratë dhe burrat garojnë në korsi të ndryshme. A nuk e shpreh qartë ndryshimin e natyrshmërisë së tyre ky shembull kaq i thjeshtë? Atëherë punët që nuk bien në kundërshtim me natyrshmërinë e gruas, janë punë të cilat pothuajse mund t’i përcaktojë çdo njeri normal. Për shembull infermiere, mësuese, doktoreshë etj...

Në fakt, për popullin mysliman është “farz kifaje” që të edukojë doktoresha për të mjekuar gratë e tyre dhe dijetare për të mësuar vajzat që arrijnë moshën e pjekurisë. Pra, ky është një obligim që u është ngarkuar të gjithë myslimanëve. Nëse një shoqëri myslimane nuk zotëron aq “gra të edukuara” sa për të realizuar këtë farz, atëherë shkallëshkallë të gjithë janë përgjegjës për këtë.

Është mirë që të flasim edhe dy fjalë për punën ligjorë. Sipas Islamit, çdo punë që mund të behët qoftë nga burri apo nga gruaje, së pari duhet të jetë “hallall”. Nuk ka ndryshim mes burrit apo gruas nëse ata punojnë në punë ku ekziston harami (pija alkoolike, bixhozi, prostitucioni, kamata, fajdeja etj.), kjo nga ana e të dyve është haram. Nëse nuk ka mundur të gjejë ndonjë mundësi tjetër punësimi, mund të punojë në këto punë sa për të “mos ngelur i uritur” me kusht që ndërkohë të vazhdojë të kërkojë për një punë “hallall”. Ndërkohë që ne duhet t’i largohemi edhe dyshimit, nuk është e përshtatshme që ta nxijmë zemrën tonë në fusha ku ekziston harami.

Përveç kësaj, të punuarit në vende ku gjenden “burra e gra së bashku” është e papërshtatshme



si për gratë edhe për burrat. Burrat që i kritikojnë bashkëshortet e tyre në çështjen e të punuarit në një ambient me burra të tjerë, sa Islame është që ata të punojnë bashkë me sekretaren në të njëjtën dhomë? Mos vallë janë hallall për burrat gjërat që për gratë janë haram?

PUNA DHE JETA MODERNE

Në fakt shkak kryesor që e detyron të punojë gruan e jetës moderne të ditëve të sotme, është “rritja e dhëmbëve të çarkut ekonomik”. Për ata nuk ka ndonjë kundërshtim nëse ky çark mban të shtrënguar familjen, bashkëshortët, fëmijët dhe shoqërinë. Ata e shohim çështjen me në qendër “ekonominë” dhe synojnë të arrijnë “sa më shumë prodhim dhe të ketë sa më shumë konsumim”.

Tregtimi i gruas nëpër “reklama”, duke filluar nga gjërat më të lira e deri te ato më të shtrenjta dhe të bërit e saj “një mjet argëtues që nxit”, është humbja më e madhe nga aspekti i personalitetit të saj. Ky është shfrytëzimi i ndjenjave dhe animeve të burrave si dhe nëpërkëmb identitetin shpirtëror të grave.

Në anën tjetër mënyra moderne e jetesës duke filluar me mendimin kryesor: “Në këto kohë nuk jetohet vetëm me një rrogë!” dhe me thënien: “Për të fituar lirinë, duhet të fitosh së pari lirinë ekonomike!”, po i hedh burrat dhe gratë në rrjetën e saj. Si mund të formohet dashuria, respekti dhe uniteti i pjesëtarëve të familjes, kur ata, për të punuar dhe fituar më shumë, pothuajse nuk e shohin aspak njëri-tjetrin?!

Çfarë kontributi mund të japë për ekonominë familjare, gruaja, e cila ia kushton veten karrierës dhe punës, ndërkohë që nuk tepron asgjë nga shpenzimet që bëhen për kopshtin, shërbimin automobilistik, kujdestaren, makijazhin, veshjet, grimin etj? Sa besnik mund t’i qëndrojë bashkëshortes së tij një burrë që punon në një ambient me gra të cilat ekspozohen me veshjet më tërheqëse?

Një grua që pothuajse harxhon të gjithë pasurinë për t’u zbukuruar dhe që shumicën e kohës ia kushton kësaj, sa kohë mund të ndajë për bashkëshortin e saj? Kur bashkëshortët kthehen të lodhur e të rraskapitur nga puna, si mund t’i shfaqin buzëqeshje dhe mirëkuptim njëri-tjetrit? Edhe sa kohë do të zgjasë pritja e fëmijëve që prindërit e tyre të ndajnë pak kohë për ta pasi kthehen nga puna?

Kush fiton dhe kush humb nga një mënyrë e tillë jetese? Ne, të gjithë siç jemi me ose pa vetëdije po zvarritemi në këtë mënyrë jetese. E çfarë ngel pas; një brez më i lumtur, një e ardhme më e qetë apo një ekonomi më produktive?

Nëse me të vërtetë të pasuruarit është e lidhur me këtë, a mund të krahasohet kjo pasuri me “vatrën e qetë dhe të lumtur familjare” që kemi humbur?

Rrepa

e kuqe

Rrepat e kuqe ndoshta nuk futen në listën e perimeve tuaja të preferuara, por kur bëhet fjalë për vlerat e tyre, rrepat renditen ndër perimet më të shëndetshme në botë.

Rrepat rriten tradicionalisht në Shqipëri, sidomos në zonën e Divjakës dhe rreth të gjithë Myzeqesë. Rrepat i gjeni në forma dhe ngjyra të ndryshme. Ato kategorizohen në varësi të periudhës së korrijës, verë, vjeshtë, dimër dhe pranverë.

Fermerët nga ana tjetër i klasifikojnë rrepat në varësi të formës, ngjyrës dhe masës, por rrepat e kuqe mbeten më të preferuarit dhe më të kërkuarit në treg.

Një proverb i vjetër kinez (Kina konsiderohet vendlindja e rrepave) thotë që nëse hani rrepa dhe pini çaj të nxehtë, mjekët jo vetëm që do të jenë “të uritur”, por edhe do t’ju përgjërohen për punë.

Rrepat mund t’i konsumoni të gjalla ose t’i kombini me një sërë perimesh të tjera dhe do të merrni shumë përfitime.

10 PËRFITIMET KRYESORE QË VIJNË NGA RREPA E KUQE

Luftojnë të ftohtin dhe kollën

Nëse je i predispozuar për t’u ftohur lehtë dhe nuk të largohet kolla, të fusësh rrepat në dietën tuaj është një ide shumë e mirë.

Kjo perime pastron fytyrën nga mukusi i krijuar dhe përmirëson imunitetin duke mbajtur larg infeksionet dhe viruset që shkaktojnë të ftohtin dhe kollën.

Rregullon tensionin e gjakut

Rrepat kanë vlera në rregullimin e tensionit të lartë të gjakut. Rrepat e kuqe kanë nivele të larta kaliumi dhe si rrjedhojë ndihmojnë në ekuilibrimin e kripës në trup. Në këtë mënyrë ato ulin tensionin e lartë të gjakut.

Ndihmon me rënien në peshë

Rrepat e kuqe kanë një nivel jashtëzakonisht të ulët kalorish. Së bashku me fibrat ato ofrojnë një ngopje afatgjatë.

Në 100 gramë rrepa të gjalla gjenden 16 kalori. Ndaj rrepat mund t’i shtoni pa frikë në dietën tuaj.



Me rrepat dukeni më të rinj

Rrepat kanë në përmbajtjen e tyre vitaminë C dhe antioksidantë. Si rrjedhojë ato parandalojnë dëmet e lëkurës të shkaktuara nga radikalet e lira.

Rrepat mund t’i përdorni shumë mirë duke i vendosur në fytyrë sepse do t’ua pastrojë atë.

Mban veshkat të shëndetshme

Vlerat natyrale të rrepave i bëjnë ato shumë të mira për mbajtjen e veshkave sa më të shëndetshme.

Duke eliminuar toksinat nga trupi, rrepat janë pastrues natyralë të organizmit.

Ndihmon me diabetin

Insulina është një hormon që prodhohet nga pankreasi. Ajo është përgjegjëse për përthithjen e glukozës.

Diabetikët e kanë të pamundur ose të përthithin insulinën që prodhon trupi i tyre ose të prodhojnë insulinë. Për këtë shkak, ata e kanë të pamundur të konsumojnë ushqime të ëmbla.

Rrepat janë të pasura me fibra dhe kanë një tregues të ulët të glicemisë. Diabetikët mund të shijojnë rrepat sepse këto perime nuk rrisin nivelet e sheqerit

Ndihmon me shërimin nga hepatiti

Rrepat janë të fuqishme për eliminimin e toksinave duke mbajtur mëlçinë dhe stomakun në gjendje të mirë.

Rrepat janë të mira edhe për të mbajtur nën kontroll sëmundjen e verdhëzës duke rregulluar sasinë e bilirubinës në organizëm dhe rritur furnizimin e trupit me oksigjen.

Një gjë e tillë ndihmon të mbajë nën kontroll shkatërrimin e qelizave të kuqe të gjakut.

Lufton konstipacionin

Shumë njerëz kanë vuajtur nga konstipacioni të paktën një herë në jetë. Është një situatë shumë e sikletshme.

Rrepat e kuqe janë të pasur me fibra që ndihmojnë të pastrojnë zorrën e trashë nga mbetjet ushqimore.

Ndihmon pacientët me azëm

Rrepat e kuqe janë shumë të mira për pacientët që vuajnë nga astma. Ato luftojnë alergjitë në sistemin respirator dhe e mbrojnë atë nga infeksionet.

Nisur edhe nga vetë ngjyra kuptohet që rrepa e kuqe është ushqimi bazë për anemikët. Këtyre të sëmurëve u këshillohet pirja çdo

ditë e 150 ml lëng të rrepës së kuqe, para buke, apo të konsumohet sa më shpesh domatja.

Nga ana tjetër këta pacientë kronikë, të çfarëdo grup moshe që të jenë, duhet të marrin çdo ditë 10-15 fruta të mandarinës për një kohë prej 20-25 ditë.

Injektimi i vitaminave, lëngjeve dhe sasive të gjakut nëpërmjet frutave dhe perimeve, është rruga më e mirë për rritjen e nivelit të gjakut në organizëm dhe mbi të gjitha normalizimin e sistemit organik.



Hudhrrat e njoma

Hudhrrat e njoma paralajmërojnë ardhjen e pranverës. Nga marsi në maj, kjo është periudha e tyre.

E ndërsa shumë prej nesh stepen për konsumin, duke menduar aromën jo fort të këndshme, studiuesit i rekomandojnë për shkak të vetive që hudhrrat kanë për organizmin tonë.

Nuk është e thënë të konsumohen vetëm të gjalla dhe të freskëta, përdorini në gatime, për të marrë të gjitha përfitimet që ato ofrojnë.

Hudhrrat e njoma shqiptare kanë një veçori shumë të rëndësishme.

Ato vijojnë të jenë e njëjta farë tradicionale si ajo e kohëve të shkuara dhe ruajnë të njëjtën shije dhe vlera.

Mbi të gjitha janë produkte të tokës dhe zhvillimi i tyre nuk është i ndikuar nga asnjë stimulant apo substancë tjetër duke i bërë hudhrrat e njoma shqiptare një nga perimet më të pastra dhe të sigurta.

ÇFARË PËRMBAN HUDHRA E NJOMË?

Hudhra e njomë, ashtu si hudhra e thatë përdoret për të kuruar gripin e thjeshtë e deri për parandalimin e sëmundjeve të rënda.

Përdoret për të kuruar probleme që lidhen me sistemin e gjakut dhe zemrës, përfshirë koleste-

rolin e lartë, parandalimin e atakut të zemrës dhe sëmundjeve koronare.


Shumë e përdorin për të parandaluar problemet me zhvillimin e qelizave të dëmshme të mushkërive, të prostatës, të gjirit e të stomakut.

Një lëndë përbërëse e hudhrës shërben si lëndë kuruese për sëmundjet e zemrës dhe e mbron atë.

Hudhra ndikon edhe në përmirësimin e parametrave lipidë të gjakut, forcon potencialet antioksidante dhe shkakton ulje të tensionit. Në fjalë të tjera hudhra ndikon në uljen e kolesterolit dhe kurimin e tensionit të lartë.

Një studim lidh hudhrën me uljen e rrezikut të lindjes së parakohshme, si pasojë e lëndëve antimikrobiale dhe prebiotike që ajo përmban.

Studime të tjera tregojnë se hudhra përmban një lëndë që mbron mëlçinë nga dëmtimet që shkaktohen nga përdorimi i alko-





LIBRAT KLASIKË NË VERSIONIN VIRTUAL

Librat klasikë për fëmijë po përditësohen për shekullin e 21-të, pasi studiuesit britanikë kanë filluar testimin e një projekti që do të sillte versione tre dimensionale të tregimeve për fëmijë në platformat e lojërave elektronike.

Kjo është pjesë e një projekti të studiuesve britanikë për të sjellë librat klasikë për fëmijë në platforma virtuale.

James Butler në Universitetin Lancaster thotë:

“Kjo është përpjekja jonë novatore për t’ia parqitur të gjithë këtë letërsi fantastike botërore një audience të re. Mendojmë të përdornim një nga burimet më të njohura të programeve kompjuterike për fëmijët, - Minecraft – për t’i sjellë në jetë këto tregime”.

Duke përdorur programet e lojërave elektronike, studiuesit ndërthurin fantazinë dhe realitetin, duke sjellë në jetë literaturën botërore të imagjinatës.

Në botën reale mund të identifikosh vetëm rreth 10-20 përqind të teksteve letrare pasi shumë prej tyre ndodhin në mjedise të ndryshme që nuk i korrespondojnë botës reale. Kështu që projekti e zgjeron shumë konceptin e hartës letrare. Ai po zhvillon një metodë tërësisht të re për të krijuar harta dhe vizualizime nga vetë teksti.

Ekspertët shpresojnë se ky projekt do të bëjë që gjenerata e re të dashurojë novelat klasike.

Për të shmangur idenë e versionit të lojës, si një version të keq të librit, ata po përpiqen të bëjnë në projektin tyre një lidhje të tekstit me imazhin. Shumë elementë edukativë që do të përfshihen në këto lojëra fillojnë me një tekst, dhe më pas kalohet në mjedisin inkurajues, ambientin e lojërave, duke u kthyer tek teksti dhe duke i lidhur këto dy elementë së bashku në mënyrë të natyrshme.

ZBULOHET BAKTERI QË ASGJËSON PLASTIKËN

Shkencëtarët kanë zbuluar një enzimë natyrale që asgjëson plastikën, një ndër materialet më ndotëse të planetit pasi nuk shpërbëhet lehtë. Enzima prodhohet nga një bakter që eksperimentet e fundit e kanë zhvilluar edhe në laborator, duke i dhënë shpresë industrisë së riciklimit.

Me plastikën, shkencëtarët arriti të zhvillonte atë që u konsiderua si materiali i mrekullueshëm; tani një

enzimë natyrore e përmirësuar mund të ndihmojë pastrimin e ndotjes së njerit prej llojeve më të vështira të saj.

Polietilen tereftalate, apo ndryshe PET, një lloj plastike e fortë e përdorur zakonisht për prodhimin e shisheve, kërkon vite të tëra që të shpërbehet në ambient.

Por një enzimë, e modifikuar aksidentalisht në



laborator, mund ta shpërbejë këtë material brenda disa ditësh.

Një zhvillim i tillë premtan të revolucionarizojë procesin e riciklimit dhe të lejojë një ripërdorim më efikas të plastikës në të ardhmen. Enzima që ha plastikën është zbuluar fillimisht pak vite më parë në një qendër riciklimi në Japoni, shkruan TCH.

Tani, hulumtuesit e Universitetit Britanik të Portsmouthit, krijuan një model 3D të saj të definicionit të lartë, duke përdorur rreze të fuqishme X dhe sapo e kuptuan strukturën e enzimës, vunë re se mund t'ia përmirësonin performancën duke rregulluar vetëm disa mbetje në sipërfaqe.

Në këtë mënyrë krijuan një enzime të re akoma edhe më efikase në shkatërrimin e plastikës PET.

Rezultatet janë mahnitëse, megjithatë edhe sfidat që presin aplikimin e tyre në botën reale nuk janë të vogla.

Zhvillimi i një teknike për prodhimin e enzimës me çmim të ulët do të jetë një pengesë kryesore; një tjetër do të jetë shfrytëzimi i fuqisë së tij në një shkallë industriale.

Sipas një studimi trevjeçar të botuar në revistën Raportet Shkencore muajin e kaluar, një grumbull gjigant mbeturinash në Oqeanin Paqësor, i njohur si fasha e plehrave të paqësorit, po rritet me shpejtësi sa pritej dhe tani është tre herë më e madhe se Franca, e më shumë se dyfishi i madhësisë së Teksasit.

PËRKUJDESJA E NËNAVE MODIFIKON ADN-NË!

Përkujdesja e nënave mund të modifikojë ADN-në, sipas një eksperimenti të zhvilluar mbi kaviet ku tregohet se në trurin e këlyshëve që lihen pas dore nga nënat grumbullohet një numër më i lartë çiftesh gjenesh “balerinë” në gjendje të riprodhohen dhe të lëvizin nga njëra pikë në tjetrën e gjenomit.

Ky zbulim mund të ndihmojë që të kuptohen tek njeriu probleme të lidhura me depresionin dhe skizofreninë.

I publikuar në revistën shkencore “Science”, ky rezultat vjen falë një kërkimi të koordinuar nga Tracy Bedrosian, e Insitutit amerikan për Studime Biologjike.


“Pas zbulimit të fundit ku vërtetohet se ndotja ndikon në ADN, ky eksperiment është një konfirmim i


ri, ku tregohet se si një pjesë e kodit gjenetik është shumë më i ndjeshëm ndaj influencave të mjedisit nga se mendohej”, deklaroi gjenetisti Giuseppe Novelli, rektor i universitetit të Romës.

Për të zbuluar impaktin që ka përkujdesja e nënave me këto ndryshime, u zhvilluar një eksperiment tek minjtë.

Duke analizua ADN-në të një pjese të trurit, hipokampit, e përfshirë në emocionet dhe që anomali të e së cilës janë të lidhura me çrregullime psikiatrike, u vu re se në ADN-në e të vegjëlve të përkëdhelur kishte më pak sekuenca gjenetike të ndryshuara.

Ndërsa tek këlyshët e lënë pas dore kishte më shumë, ndoshta sepse këta janë më të stresuar dhe kjo ndikon më shumë në replikimin e gjenve.





“O besimtarë!
Binduni Allahut
dhe të Dërguarit
kur ju thërret
drejt asaj që ju jep jetë!
Ta dini se Allahu
ndërhyn midis njeriut
dhe zemrës së tij
dhe se tek Ai
do të mbliidheni
të gjithë!”

(Enfal, 24)